

LE MONDE. *shqip* diplomatie

Koment

Që tani!

Nga Serge Halimi / Faqe 9

100 LEKË, 1 EURO / MUJORE / 24 FAQE

Nr. 792 / Viti i 67 i botimit / Prill 2020

MËSIMET NGA KONTROLLI I PANDEMISË NË SHQIPËRI DHE EUROPËN JUGLINDORE

Koha për rihapje

Çfarë e dallon Europën Juglindore nga Perëndimi, madje edhe nga Gjermania e konsideruar një histori suksesi? Debati për vaksinën e vjetër të tuberkulozit dhe niveli i riskut sot nga Covid-19

NGA ALBAN YLLI

Shqipëria është në javën e shtatë të dokumentimit të pandemisë nga Covid 19, e cila me shumë gjasë u importua nga Italia e Veriut në dy javët e fundit të shkurtit. Të dhënat dëshmojnë se përhapja e infeksionit është frenuar në mënyrë efektive; kurba epidemike është e sheshtë, numri i rasteve në nevojë për kujdes nuk e kërcënoi sistemin shëndetësor dhe mortaliteti është mbajtur në nivele të ulëta. Janë regjistruar zyrtarisht vetëm 26 vdekje nga Covid 19 në Shqipëri dhe niveli nuk është vetëm shumë më i ulët se në vendet e Europës Perëndimore, por edhe se në disa vende të Europës Juglindore përfshirë, Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Rumaninë apo edhe Turqinë



më në Lindje. Edhe ritmet e shtimit të rasteve të reja ngelen më të ulëta se në disa nga këto vende. Prej një jave, numri i rasteve të shëruara e ka kaluar numrin e rasteve aktive të konfirmuara dhe kjo priret vazhdon. Megjithatë pandemia ka prekur në përmasa të ndryshme shumicën e qyteteve të Shqipërisë, ka ende një numër rajonesh pa asnjë rast të konfirmuar. Gjithashtu, vatrat e infeksionit të identifikuar kohët e fundit në Shkodër dhe Krujë duket të jenë mbajtur ende përgjithësisht të izoluara. Ka një dallim të fortë mes treguesve të pandemisë në vendet

e Europës Juglindore dhe atyre të vendeve të Europës Perëndimore. Risku për t'u infektuar, i bazuar në numrin e rasteve të diagnostikuara në popullatë, ngelet përgjithësisht disa herë më i ulët, ndërsa risku për të vdekur nga Covid 19 mund të arrijë në dhjetra herë më i ulët.

Çfarë e dallon Shqipërinë nga Italia, Britania e Madhe, e pse jo, edhe nga Gjermania e konsideruar një histori suksesi, në kontrollin e kësaj pandemie? Përgjigja e kësaj pyetje duket se do të ngelet ende e debatueshme, por megjithatë disa

mësime mund të nxirren përmes një observimi sistematik të të gjithë faktorëve të cilët me gjasë ndikojnë. Korrelacioni gjeografik mund të japë një ndihmë për të identifikuar pranimë e faktorëve të ndryshëm dhe për të hedhur hipoteza bazuar mbi diferencat apo asociimet e vërejtura, gjithmonë pa vërtetuar dot shkakësinë.

Në këtë analizë kemi përfshirë Shqipërinë, vendet e Europës Juglindore (pa marrë përsipër të bëjmë një perkufizim politik të këtij termi) dhe vendet më... / Faqe 10

Vështrim

Nami

Nga Seb Bytyçi

/ Faqe 13

Ka disa ngjarje që shkaktojnë ndarjen e kohës në para dhe pas, si për shembull Lufta e Dytë Botërore ose kriza e naftës e viteve 1970. Kjo pandemi përbën një pikë kritike në kohë dhe shënon ndarjen e epokave para saj dhe pas saj. E veçanta e saj është se i ka prekur...

Opinion

Mos u trembni, kapitalizmi kaq i dashur do të fitojë

Nga Andi Kananaj

/ Faqe 8

Kalimi shumë i shpejtë nga bota kur dita nuk shtyhej, po vitet fluturonin, duket se i ka ardhur fundi. Tani për disa kohë, dita nuk do të shtyhet, dhe kaq. Ndoshta për pak kohë vitet do të kthehen...

Intervista

Artan Mustafa: Njëjtë, por ndryshe

Nga Shkodran Hoti

/ Faqe 6

Nga këndvështrimi i ekonomisë politike, programi i Qeverisë Kurti nuk sugjeronte zhvendosje thelbësore nga paradigma neo-liberale e instaluar menjëherë pas...

Kulturë

Humbja e korifejve dhe shoqëria e konsumit në kohë pandemie

Nga Ben Andoni

/ Faqe 23

Rikard Ljarja, aktori dhe regjisor i filmave klasikë shqiptarë, ka ndërruar jetë pak ditë më parë. Kortezi i tij përbëhej nga...

COVID-19... DHE JETA NDRYSHOI

Deri në fundin e radhës së botës...



Pandemia e Covid-19 e ka ndryshuar botën. Tani shëtitja me një mik është po aq e paimagjinueshme, sa respektimi i rregullave buxhetore evropiane: gjërat e përditshme bëhen të jashtëzakonshme; gjërat e paimagjinueshme bëhen të përditshme. Derisa disa shfrytëzojnë rastin për përfitime materiale, të tjerët pyesin: a e arsyeton shpëtimi i jetërave rrezikimin e tregtisë së lirë? Kur do të bëhen llogaritë, përgjigja do të jetë e rëndë.

NGA RENAUD LAMBERT DHE PIERRE RIMBERT

Arti i prestigjiorit është ta drejtë vëmendjen e publikut, në mënyrë që publiku të mos vërejë çka ndodh para syve të tij. Në zemër të epidemisë Covid-19, numri i magjisë ka marrë formën e një grafiku me

dy gunga, transmetuar në të gjitha televizionet botërore. Në abshisë vendoset koha; në ordinatë, numri i rasteve të rënda të sëmundjes. Një lakore e parë në formën e një majeje akute tregon ndikimin e epidemisë nëse nuk veprohet: thyhet

vija horizontale që tregon kapacitetet maksimale të pranimit nëpër spitale. Lakorja e dytë ilustron situatën kur masat e vetizolimit kufizojnë përhapjen e sëmundjes. Pak e gungëzuar, si një guaskë breshkeje, ajo rrëshqet nën prapen e

pashmangshëm. Ky grafik paraqitet në Uashington deri në Paris, në Seul, Romë apo Dublin, dhe tregon urgjencën: shkalla e infeksioneve duhet të përhapet në kohë, që të shmangët stërngarkimi i shërbimeve shëndetësore... / Faqe 4-5

NË EMËR TË PROGRESIVIZMIT

Kur qytetet e mëdha vendosin të ndahen

Në shumicën e vendeve perëndimore, qytetarët dhe menaxherët e zonave metropolitane nuk janë të kënaqur. Ithtarë të progresivizmit, të hapjes dhe të inovacionit, ata nuk e pëlqejnë rrugën e zgjedhur nga pjesa tjetër e vendit, nga qytetet e vogla dhe fshatrat ku po fuqizohet e djathta ekstreme dhe “popullizmi”. Andaj edhe kanë filluar të bashkohen për t’ju përgjigjur kësaj qasje.

NGA BENOIT BRÉVILLE

Për ta fituar postin e kryetarit të një qyteti të madh francez në vitin 2020, çdo kandidat serioz duhet të respektoj disa rregulla. Për shembull, duhet të angazhohet se do të mbijellë pemë. Në Paris, znj. Anne Hidalgo propozon të mbijellë 170.000 pemë brenda gjashtë vitesh, konkurenti i saj Cédric Villani i cili në korrik 2019 ka qenë animator i “Natës së pemëve” (“Nuit des arbres”) në Fondacionin Cartier, e mbështet një projekt të gjerë të shëtitoreve të mbjelura me pemë. Në Marseille, Martine Vassal, kandidatja e Republikanëve/Les Républicains (LR), propozon të mbillen po aq pemë sa lindin fëmijë, përafërsisht 70.000 nëse banorët e Marseille ruajnë nivelin e fekonditetit të mandatit të kaluar. Pra, kjo të thotë tri herë më shumë se propozimi i konkurrentes së saj socialiste, senatorja Samia Ghali. Në Lille, kandidatët garojnë për “pyje urbane” dhe “sheshe të gjelbërta”.

Por nuk mjafton dashuria për kopshari. Duhet premtuar gjithashtu ndërtime të gjelbërta, duhet inkurajuar përdorimin e bicikletave dhe carpoolingut, të mbështetet kultura, të favorizohet tranzicioni energjetik, të zhvillohet atraktiviteti i qytetit, si dhe të shërbehet ushqim bio në menzert shkollorë. Në programe politike duhet të futen fjalët si “inovacion”, “transparencë”, “demokraci pjesëmarrëse” dhe sa më shpesh mbiemri “i qëndrueshëm”: zhvillim i qëndrueshëm, qytet i qëndrueshëm, territor i qëndrueshëm, turizëm i qëndrueshëm, ndërtim i qëndrueshëm etj.

Të gjithë kandidatët përdorin fjalë të njëjta, formula të njëjta, ide të njëjta: si duket ata i përpilojnë programet e tyre duke e shfletuar katalogun e praktikave të mira i cili vlen për të gjithë qytetet, madje edhe për të gjitha shtetet, pasi që ofertat komunale ndryshojnë pak në Seattle, Montreal ose Berlin. Thuajse politikat lokale reduktohen në një seri reagimesh pragmatike, apo zgjidhje të arsyeshme për problemet konkrete.

“Derisa kombet flasin, qytetet veprojnë”, thoshte vazhdimisht z. Michael Bloomberg gjatë mandatit të tij si kryebashkiak i New-York-ut (2002-2013), si dhe kur e kryesonte Cities Climate Leadership Group (C40), një forum i fuqishëm që bashkon 94 qytetet më të mëdha të botës në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Tani, kjo formulë është përhapur mjaft. Shumë vendimmarrës urban mendojnë se shtetet, të përfshira në konflikte ideologjike, nuk mund të veprojnë në mënyrë efektive, e se atëherë duhet që qytetet të bashkohen për t’i kompensuar këto zbrazëtira. Ky parim paraqitet në mënyrë të qartë

në literaturën profesionale të urbanizmit dhe përbën bazamentin e “diplomacisë së qyteteve”. Kjo doktrinë i ka ngulitur rrënjët në binjakëzimet franko-gjermane të pajtimit pas Luftës së Dytë Botërore, por tanimë ajo frymëzon shumë koalicione, forume, rrjete qytetesh në tërë botën. Numri dhe ndikimi i tyre janë rritur vazhdimisht për tridhjetë vjet. Në vitin 1985 ishin 55 sosh, aktualisht numërojmë mbi 200 sosh¹: C40, por gjithashtu Eurocities, Konventa botërore e kryebashkiakëve për klimën dhe energjinë, Këshilli ndërkombëtar për iniciativat ekologjike lokale (Iclei), Qytetet dhe qeveritë lokale të bashkuara (CGLU), Rrjeti i qyteteve kreative të Organizatës së Kombëve të Bashkuar për arsim, shkencë dhe kulturë (Unesco), Mayors for Peace (“Kryebashkiakët për paqe”), Grupi Qytetet-Shëndet i Organizatës Botërore të Shëndetësisë ... “Përsa i përket pabarazisë, imigracionit, shëndetit, sigurisë, qeverisjes, të drejtave të njeriut dhe shumë çështjeve të tjera thelbësore, gjithnjë e më shumë qytete po kalojnë përtej qeverive të tyre kombëtare dhe po organizohen në mes vete për të gjetur zgjidhje”, thotë me ngazëllim Ivo Daalder, politologu dhe ish këshilltari i z.Barack Obama në Shtëpinë e Bardhë².

Këto grupime, që zakonisht pajtohen në mes veti, mbështeten nga Banka Botërore, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe nga shumë organizata të tjera shumëkombëshe. Ikea, Microsoft, Google, Velux si dhe Dell Technologies figuronin në mesin e sponsorëve në Kongresin e fundit botëror të kryebashkiakëve të C40. Këto të fundit përbëjnë një stafetë të fuqishme të besimit metropolitani i cili bashkon autoritetet lokale dhe kompanitë në kultin e inovacionit.. Kështu, sektorit privat aq shumë i pëlqen “diplomacia e qyteteve” sa që vet lanson grupime të tilla, siç janë City Protocol i gjigantit të teknologjisë Cisco apo “100 Resilient Cities Network” të Rockefeller Foundation.

Përveç që favorizojnë reciklimin e kapitalizmit të gjelbërt, rrjetet urbane ndërkombëtare luajnë një rol përcaktues në definimin e “praktikave të mira”, të cilat qarkullojnë pastaj prej qytetit në qytet. Në kuadër të aktiviteteve të tyre diplomatike, ekipet komunale marrin pjesë në kongrese, takime, ekspozita dhe zhvillojnë shumë vizita studimore. Sipas logjikës së showroomit, ato prezantojnë aktivitetet dhe përvojat e tyre, si dhe dëgjojnë homologët e tyre duke bërë të njëjtën gjë. Kështu çdo ekip mund të kthehet në vendin e vet me zgjidhje të gatshme. “Shfrytëzimi i praktikave të tjerëve iu mundëson akterëve të kombinojnë dy qëllime kundërtë: të bëjnë diçka



Edhe pse janë konkurren-te, metropolet megjithatë dijnë të bashkohen për t’i mbrojtur interesat dhe dijnë ta përdorin diplomacinë e qyteteve me qëllime lobimi

të re duke sjellur garanci se praktikat e përdorura kanë sjellë rezultate në vendet e tjera”, sqarojnë Alain Bourdin dhe Joël Idt³. C40 krenohet se, në mes të viteve 2012 dhe 2018, ka shtyrë mbi 14.000 aksione konkrete për të luftuar kundër ndryshimeve klimatike. Nën tutelën e C40, Changwon (Kore e Jugut), Tokio dhe New York kanë ndarë teknikat e tyre inovative të mbulesës së pullazëve për t’i pasqyruar rrezet e diellit dhe për t’i ftohur ndërtesat. Barcelona, Singapor, Aucklandi (Zelandë e Re) dhe Varshava kanë këmbyer njohurinë e tyre mbi elektrifikimin e autobusëve. Qytete shumë të avancuara në një fushë (Parisi për metro, Kopenhaga për biçikleta) kanë sjellur mbështetjen e tyre teknike për qytetet e tjera me më pak përvojë.

C40 organizon çdo vjet C40 Bloomberg Philanthropies Awards për t’i shpërblyer idetë më të mira. Në ceremoninë e vitit 2019 janë dalluar “korridoret e gjelbërta” të Medellinit (Kolombi), panelet diellore të Seulit, programi mbështetës për energjitë e gjelbërta të San Francisko-së, autobusët elektrik të Kantonit... “Këto projekte meritojnë të shqyrtohen nga kryebashkiakët dhe udhëheqësit e qyteteve në tërë botën”, deklaroi kryetarja e C40, znj.Hidalgo, gjatë ceremonisë së çmimeve. Shpërblime të tilla janë mjete të zgjedhura për qytetet që dëshirojnë të përforcojnë statusin e tyre ndërkombëtar. Nuk mungon oferta: çdo rrjet, çdo revistë, çdo nivel i qeverisjes përzgjedh shembujt më të mirë. Çdo vjet Komisioni Evropian shpërblen “kryeqytetin evropian” (i gjelbërt, i kulturës, i rinisë si dhe i inovacionit) dhe shpërndan Access City Awards (për të shpërblyer kujdesin ndaj personave të moshuar apo ndaj të

hendikepuarëve). Në Francë, ministria e ekonomisë jep labelin “French Tech”, për të krijuar “Tech Champions” që do të tërheqin investitorët e huaj.

Qytetet që shpërblehen me ndonjë çmim janë të sigurt se do të kremtohen në shtypin e specializuar. Disa herë fitojnë statutin e modelit: Emri i qytetit do të mbetet i asocuar me praktikat e vërtetshme, të imituara – apo më shpesh të kopjuara – gjithandej nëpër botë. Do të bëhen “trendsetting city”⁴, qytetet që definojnë trendin. Porto Alegre me buxhetin pjesëmarrës, Singapor me sistemin e tarifave urbane, Bilbao me strategjinë e regjenerimit ekonomik nga kultura (i famshmi “efekt Guggenheim”), Hamburgu me menaxhimin e riskut të përmblyetjeve, Seattle me fidanishten e start-upëve, Londra me menaxhimin e mega-ngjarjeve sportive, Vankuveri me modelin e zhvillimit të qëndrueshëm ...

Çdo metropol ëndërron të bëhet model, sepse siç e thekson Yves Viltard, njëri nga specialistët e rrallë francez të diplomacisë urbane, lufta ekonomike ndërmjet qyteteve të mëdha “shoqërohet me një garë përmes prodhimit të markës tërheqëse, të ‘brandingut’⁵”. Pjesëmarrja në forume si C40 është një mënyrë e shkëlqyeshme për ta përmirësuar imazhin dhe për ta rritur famën e markës, kusht *sine qua non* për të pasur sukses në konkurrencën urbane dhe për të tërhequr investitorë, ndërmarrje, punëtorë të diplomuar, studentë, ose për të qenë nikoqirë të ngjarjeve të mëdha që gjenerojnë të hyra ekonomike. “Janë pesëdhjetë, ndoshta njëqind qytete që e përbëjnë motorin intelektual, kulturor dhe ekonomik të botës”, ka përmbledhur Z. Rahm Emanuel, kryebashkiak i Çikago prej vitit 2011 deri në 2019. Të gjithë punojnë në lidhje me gjërat e njëjta, sepse i kemi mundësitë e njëjta. Duhet

t’i bëjmë qytetet tona më kompetitive. Punësimet dhe ndërmarrjet [që duam t’i tërheqim] nuk janë vetëm globale, ato janë edhe mobile⁶.”

Për t’iu lënë përshtypje investitorëve, ekipet komunale kërkojnë këshilla në kabinetet urbane, një sektor me zhvillim të hovshëm. Me anë të një fjalori të standardizuar, konsulentët iu ndihmojnë të plotësojnë dosje për aplikim me çmime dhe labela të ndryshme, si dhe formularë të komplikuar për subvencione pranë fondacioneve filantropike që financojnë projekte inovative urbane. Ata shpikin logo që bijnë në sy dhe slogane që mbahen në mend, sipas mundësisë në anglisht (“Only Lyon”, “So Toulouse”, “My Rodez”), të cilat do të figurojnë në të gjitha mjetet e komunikimit ose do të afishohen gjatë eventeve të mëdha. Gara urbane i fut qytetet në një logjikë të *benchmarking-ut*⁷, një “garë pa finish” ku secili mundohet të tregohet më inovator, më modern, më në trend, pavarësisht nga niveli (kombëtar, kontinental ose botëror) ku konkurron. Pra, Aix-en-Provence paraqitet te investitorët sikur të ishte San Francisko: “Qyteti i piktorit të famshëm Paul Cézanne ka ditur të përshtatet për të qenë sot i labelizuar French Tech dhe të ofrojë një ekosistem atraktiv për bartësit e projekteve dhe themeluesve të kompanive (...). Aix-en-Provence, qytet inteligjent, i konektuar, i kthyer me vendosmëri drejt inovacionit digjital dhe ndërkombëtar. Ky është një qytet modern, kosmopolit, kulturor, dinamik, i hapur ndaj botës”, pohon me krekosje një broshurë e departamentit “Atraktivitet dhe bashkëpunim ndërkombëtar” të këshillit komunal.

Edhe pse janë konkurren-te, metropolet megjithatë dijnë të bashkohen për t’i mbrojtur interesat dhe dijnë ta përdorin diplomacinë e qyteteve me qëllime lobimi. Misioni i rrjetit Eurocities është “t’i influencojë politikat evropiane për t’u siguruar se do të merret parasysh opinioni i qyteteve të mëdha gjatë përpilimit të politikave”. CGLU lavdërohet se ushtron “lobing politik” në Bruksel – si dhe në Bankën Botërore dhe në OKB – për të arritur në “krijimin e një fondi evropian për ‘diplomacinë e qyteteve’”. Iclei e përqendron presionin në Grupin e ekspertëve ndërqeveritar për zhvillimet klimatike (GIEC) për t’i shtyer ta theksojnë edhe më shumë pozitën qendrore që qytetet duhet ta kenë në luftën kundër ngrohjes klimatike. C40 ka krijuar në vitin 2017 shoqatën Urban20 që mundohet t’i bëjë presion ministrave pjesëmarrës në bisedimet e samiteve të G20⁸.

Anti-populizmi

Po formohet pra një qark vicioz. Duke i koncentruar pasuritë dhe aktivitetet me vlerë të shtuar të lartë në metropole, globalizimi ua ka rritur peshën ekonomike, politike dhe kulturore. Këto metropole, të përballura me probleme të njëjta, me popullsi të njëjtë të pasur dhe të diplomuar, kanë filluar të duken njësoj. Në New York dhe Pekin do të gjeni të njëjtët rrokaqiej, të njëjtat qendra tregtare të sanitizuara, të njëjtë “cluster kreativ”. Të bashkuar për të mbrojtur interesin e përbashkët, ato ndikojnë tani në qendrat vendimmarrëse, prej Bankës Botërore deri në Komisionin Evropian,

si dhe orientojnë kështu politikat publike në dobi të tyre, duke theksuar një model të zhvillimit hapësinor jo të barabartë, që lë anash fshatrat dhe komunat e vogla.

Ky hendek në mes territoreve, edhe pse ka ekzistuar më parë, rrallëherë ka qenë aq i thellë. Kur disa bëjnë ndërtesa me fasada bimorë dhe elektrizojnë autobusët, të tjerët kanë frikë se banezat e tyre do të mbeten të braktisura për shkak të mungesës së banorëve dhe menaxhojnë rrjete të autobusëve me orare jo të përshtatshme, të cilat nuk qarkullojnë në mbrëmje, as në festat

Në anën tjetër, territoret me më pak popullsi dhe më të varfëra, po vazhdojnë t’i vuajnë efektet e recesionit. Më pak banorë, më pak vende të punës, banesa më të lira, kjo do të thotë gjithashtu më pak të hyra për kolektivitetet lokale, gjë që ndikon në ofertën e shërbimeve publike, në mirëmbajtjen e infrastrukturave... Këto territore pra bëhen edhe më pak tërheqëse, popullata e tyre vazhdon të largohet...e kështu me radhë

Recep Tayyip Erdogan, ka rënë në durart e një partie opozitare laike dhe socialdemokrate. *“Është mobilizuar në mënyrë aktive koalicioni i qytetarëve të sekularizuar, të qendrave të biznesit, të rinisë, të grave dhe të minoriteteve. (...) Turq, kurdët, uzbekët ndajnë trotoaret me senegalezët, katarianët dhe sirianët. Banorët e Stambollit të gjen-eratës së shtatë jetojnë tani në qytet me emigrantët, me azilantët dhe me refugjatët. Këta qytetarë të shumtë që ndajnë hapësirën e njëjtë, madje jetën e njëjtë, janë të lidhur nga një urbanitet i përbashkët”*, shkruante me admirim *Washington Posti*, pronë e z.Jeff Bezos, patroni i Amazonit.

Ky vizion i hareshëm është përhapur gjerësisht gjatë dekadës së kaluar. *“Vlerat e New York, sikurse vlerat e qyteteve të tjera të mëdha botërore, janë vlera të optimizmit, të diversitetit dhe të qëndrueshmërisë. Në këto vlera do të duhej të aspironte secili prej nesh”*, thekson *The Guardian* (31 tetor 2016). Forumi Ekonomik Botëror i Davosit sheh te metropolet një *“antidot ndaj popullizmit”*: *“Shumica e qyteteve të botës ribëjnë politikën, ekonominë, aksionin ambientalist duke u nisur nga qytetarët. Ndërtojnë për shumicën një vizion pozitiv dhe gjithpërfshirës të së ardhmes, kurse udhëheqësit nacionalistë përhapin frikë, mbyllin kufijtë dhe ndërtojnë mure”*. Duke konstatuar sec *“popullata urbane dhe popullata rurale janë edhe më të ndara kur është fjala për vlerat dhe prioritetet”*, simposiumi i milionerëve fton metropolet të organizohen dhe ta forcojnë *“diplomacinë e tyre urbane”*¹¹. Ivo Daalder, ish këshilltar i z.Obama, madje propozon krijimin e *“mini-ambasadave”* që do të krijojeshin në vendet me interesa të rëndësishme, për t’i kapërcyer bllokimet e mundshme nga qeveritë. São Paulo, Londër dhe Toronto kanë provuar përvoja të tilla, por kanë ngjallur hidhërimin e qytetarëve të cilët i konsideronin si shpenzim i panevojshëm të parasë publike. *“Partneriteti publiko-privat mund të jetë një zgjidhje”*, propozon strategu.

Disa qytete kanë filluar të organizojnë kryqëzata kundër popullizmit. Në Evropë Lindore, kryebashkiakët e Pragës, Bratislavës, Varshavës dhe Budapestit kanë nënshkruar në dhjetor të vitit të kaluar një *“Pakt të qyteteve të lira”*. I sfidojnë qeveritë e tyre, të cilat i akuzojnë se përhapin *“llojin e nacionalizmit ksenofob që e ka zhjytur Evropën dy herë në luftë në shekullin e kaluar”*: *“Nuk kapemi për një koncept të prapambetur të nocioneve të sovranitetit dhe të identitetit, por i besojmë shoqërisë së hapur, të bazuar*

në vlerat e çmuara të përbashkëta të lirisë, dinjitetit njerëzor, demokracisë, qëndrueshmërisë, barazisë, shtetit të së drejtës, të drejtësisë sociale, tolerancës dhe diversitetit kulturor”, thojnë katër të zgjedhurit dhe inkurajojnë qytetet të *“bashkëpunojnë duke bashkuar burimet, si dhe duke shkëmbyer idetë”*.

Në SHBA gjithashtu, metropolet paraqiten si kundërshtarët e parë të Presidentit. Në janar 2017, sapo ishte vendosur z.Trump në Shtëpinë e Bardhë, kryebashkiakët e San Franciskos, Los Anxhelosit, Seattlit, Bostonit, New Yorkut, Uashingtonit, Detroitit si dhe të Çikagos lajmëruan se nuk do të aplikojnë dekretet e tij për forcimin e luftës kundër imigrimit klandestin. Kryebashkiaku i Bostonit denonconte legjislacionin *“destruktiv”* dhe *“antiamerikan”*, *“sulmin ndaj qytetarëve të Bostonit, fuqisë së Bostonit dhe vlerës së Bostonit”*. *“Qyteti jonë dhe vlerat tona nuk do të ndryshojnë me zgjedhje (...) Nuk jemi agjentë të qeverisë federale”*, theksonte homologu i tij i Uashingtonit¹². Pas disa muajve kur u vu përpara çështja e mjedisit, disa metropole deklaruan se ishin të

vendosura ta respektojnë marrëveshjen e Parisit për klimën, edhe pse z.Trump kishte vendosur të tërhiqej.

Në Mbretërinë e Bashkuar, Brexiti e ndezi situatën. Pas përfundimit të referendumit në qershor 2016, qarkulloi një peticion për ta kërkuar pavarësinë e Londrës. Për disa javë u mblodhën 180.000 nënshkrime. Edhe pse nuk kërkonte shkëputjen e kryeqytetit, kryetari, z.Sadiq Khan, kërkonte të shkëputej nga fati kombëtar. Katër ditë pas rezultateve, ai dhe znj.Hidalgo publikuan një letër të hapur në gazetat ‘Financial Times’ dhe ‘Le Parisien’: *“Qytetet tona janë hapësira ku të gjithë, nga kudo që vijnë, mund të ndjehen si në shtëpi. Si kryebashkiakë të Parisit dhe të Londrës, ne jemi të vendosur të bashkëpunojmë më shumë për të ndërtuar aleanca edhe më të forta midis qyteteve në Evropë dhe në mbarë botën. Së bashku, mund të jemi një kundërpeshë e fuqishme ndaj letargjisë së shtet-kombeve dhe ndaj ndikimit të lobistëve. Do ta krijojmë bashkërisht shekullin e ardhshëm”*.

Për t’i qetësuar turistët dhe investitorët, z.Khan filloi gjithashtu një fushatë komunikimi rreth hashtagut ‘#LondonIsOpen’ (‘Londra është e hapur’). I mbështetur nga Oda e Tregtisë dhe Industrisë, nga Korporata e qytetit të Londrës, nga shumë think tank dhe shumëkombëshe, ai po kërkon krijimin e një vize pune, që do të jetë e vlefshme vetëm në Londër, si dhe ekstrashterritorialitet të kryeqytetit në marrëdhëniet e tij me tregun e përbashkët. Asnjë nga këto kërkesa nuk u realizua, por ky kundërshtim i ashpër i mundësoi z.Khan ta fitojë një status ndërkombëtar të papritur për një krybashkiak: ai tani ndan estradën me ministrat e jashtëm dhe krerët e shteteve (kanadezin Justin Trudeau, argjentinasin Mauricio Macri, francezin Emmanuel Macron...).

Privilegjet

karikaturale mënyrën se si elitat urbane i perceptojnë bashkëqytetarët e tyre. Për metropolet dhe qytetet e mëdha, Barber bashkëngjet termet “hapur”, “kreativ”, “kosmopolit”, “mobil”, “ndyshueshëm”, “e ardhmja”, “inovacion”, “sekular”, “progresiv”, “liri”, “sofistikuar”, “biznis”. Për t’i kualifikuar fshatrat dhe amerikën rurale, ai përdor fjalët “mbyllur”, “konvencional”, “famulltar”, “palëvizshëm”, “stabil”, “kaluar”, “përsëritje”, “fetar”, “konservator”, “traditë”, “thjeshtësi”, “autonomi”.

Përtej klisheve, profesori i shkencave politike Lawrence R. Jacobs ka tentuar ta kuptojë këtë çarje duke anketuar në Minnesota ku ai ligjëron dhe ku z.Trump ka fituar gati në njëzet qarqe që patën votuar për z.Obama në vitin 2008 dhe në vitin 2012¹⁴. Si faktor ndarës, ai e vendos në rend të parë dallimin e madh në mes pagave në Minneapolis dhe në pjesën tjetër të Minnesota. Në vitin 2017, metropoli ka vendosur ta ngrit progresivisht pagën minimale në vlerën 15 dollarë për orë, një masë kjo e cila shpesh merret në qytetet e mëdha për t’i mundësuar punëtorëve të thjeshtë të paguajnë qiratë kur rriten çmimet e banesave. Tjetërkund në Minnesota, paga minimale arrin

vlerën 10 dollarë në kompanitë e mëdha dhe 8.15 dollarë në kompanitë e vogla, për ata qytetarë që kanë punë. Sipas punëtorëve që takoi hulumtuesi, një dallim i tillë është përjashtim. *“Gjithandej [në Minneapolis] ka vinça dhe panele ‘Kërkojmë punëtorë’ që paguhen së paku 15 dollar në orë”*, thotë një banor i një komune të vogël ku do të duhej të kishte nevojë për punime.

Jacobs thekson gjithashtu se diskursi, retorika dhe konceptet e përdorura nga kampi progresiv i Minneapolisit, të kalibruara për t’u pëlqyer klasave të larta urbane, nuk janë në fazë me qytetarët tjerë të shtetit. Ai e citon sidomos nocionin e “privilegjit të bardhë”, që përdoret shpesh në fakultetet e shkencave sociale dhe përdoret vazhdimisht - me vend e pa vend - nga të përzgjedhurit e Minneapolisit dhe nga aktivistët demokratë lokalë (pas të shtënave në një stacion policie, në lidhje me banorët që luftojnë për mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta...). Disa nga qarqet më të varfëra në Minesota kanë deri 95% popullsi të bardhë. Të dënuar me paga të ulëta dhe pasiguri, banorët e këtyre qarqeve nuk ndjehen aspak të privilegjuar, veçanërisht kur e shikojnë Minneapolisin. Më shumë se për “privilegje të bardhë”, ata preferojnë të flasin për “privilegje metropolitane” që asociohen në mënyrë indifferente me pakicat etnike dhe me punëtorët me jakë të bardhë, që qëndrojnë ulur në tavolinat e tyre për ta fituar jetesën¹⁵.

Qytetet e mëdha dhe vendimmarrësit e tyre vazhdojnë gjithnjë e më shumë të komunikojnë me homologët e tyre në të gjithë botën, por janë të ç’kyqur nga një pjesë e vendit të tyre. Diskursi i tyre njëtrajtësisht inovator, i hapur, i qëndrueshëm, kreativ dhe inteligjent vështirë e fsheh thithjen e pashembullt të pasurisë me të cilën operojnë. Çështja është se a janë ata më të kualifikuarit për ta propozuar një “antidot të popullizmit”?

1 Michele Acuto, «Give cities a seat at the top table», *Nature*, vol. 537, n° 7622, Londër, 28 shtator 2016.

2 Ivo Daalder, «Why cities need their own foreign policy», *Politico*, 6 qershor 2017, www.politico.com

3 Alain Bourdin et Joël Idt, *Urbanizmi i modeleve. Referenca, benchmarking dhe praktikat e mira*, Éditions de l’Aube, coll. «Bibliothèque des territoires», La Tour-d’Aigues, 2016.

4 Vincent Béal, «“Trendsetting cities”: le modèle ne kohën e politikave urbane neoliberal», *Métropolitiques*, 30 qershor 2014, www.metropolitiques.eu

5 Yves Viltard, «Diplomaci të qyteteve: kolektivitete territoriale dhe marrëdhënje ndërkombëtare», *Politique étrangère*, n° 3, Paris, vjeshtë 2010.

6 Cituar në Ronald Brownstein, «The growing gap between town and country», *The Atlantic*, Washington, DC, 22 shtator2016.

7 Lexo Isabelle Bruno dhe Emmanuel Didier, «Vlerësime, armë e shkatërrimit», *Le Monde diplomatique*, maj 2013.

8 Michele Acuto dhe Simon Curtis, «The foreign policy of cities», *The RUSI Journal*, vol. 163, n° 6, Londër, dhjetor 2018.

9 Cf. Roberto Stefan Foa et Jonathan Wiltom, «The West has a resentment epidemic», *Foreign Policy*, Washington, DC, 18 shtator2019 ; Thomas B. Edsall, «Reaching out the voters the left left behind», *The New York Times*, 13 april 2017.

10 David Adler dhe Ben Ansell, «Housing and populism», *West European Politics*, vol. 43, n° 2, Abingdon-on-Thames (Mbretëri e Bashkuar), qershor 2019.

11 Cf. Robert Muggah et Misha Glenn, «Populism is poison. Plural cities are the antidote», Forum ekonomik botëror, Davos, 4 janar 2017, www.weforum.org

12 Cituar në Nicolas Maisetti, «Le Retour des villes dissidentes», raport për ministrinë e tranzicionit ekologjik dhe solidar, Paris, tetor 2018.

13 Benjamin Barber, *If Mayors Ruled the World: Dysfunctional Nations, Rising Cities*, Yale University Press, New Haven, 2014.

14 Lawrence R. Jacobs, «Minnesota’s urban-rural divide is no lie», *Star Tribune*, Minneapolis, 26 korrik 2019.

15 Mbi rastin e Wisconsin, cf. Katherine J. Cramer, «For years, I’ve been watching anti-elite fury build in Wisconsin. Then came Trump», *Vox*, 16 novembre 2016, www.voxmedia.com

COVID-19... DHE JETA NDRYSHOI

Deri në fundin e radhës së botës...

Pandemia e Covid-19 e ka ndryshuar botën. Tani shëtitja me një mik është po aq e paimagjinueshme, sa respektimi i rregullave buxhetore evropiane: gjërat e përditshme bëhen të jashtëzakonshme; gjërat e paimagjinueshme bëhen të përditshme. Derisa disa shfrytëzojnë rastin për përfitime materiale, të tjerët pyesin: a e arsyeton shpëtimi i jetërave rrezikimin e tregtisë së lirë? Në repartet e emergjencës sikurse nëpër oborre qeveritare shtrohet një pyetje bezdisëse: sikur shëndetësia publike të mos ishte shkatërruar nga politikat shtrënguese, a do të kishin vdekur kaq shumë njerëz nga virusi? Kur do të bëhen llogaritë, përgjigjja do të jetë e rëndë.

NGA RENAUD LAMBERT DHE PIERRE RIMBERT

Arti i prestigjiatorit është ta drejtojë vëmendjen e publikut, në mënyrë që publiku të mos vërejë çka ndodh para syve të tij. Në zemër të epidemisë Covid-19, numri i magjisë ka marrë formën e një grafiku me dy gunga, transmetuar në të gjitha televizionet botërore. Në abshisë vendoset koha; në ordinatë, numri i rasteve të rënda të sëmundjes. Një lakore e parë në formën e një majeje akute tregon ndikimin e epidemisë nëse nuk veprohet: thyhet vija horizontale që tregon kapacitetet maksimale të pranimit nëpër spitale. Lakorja e dytë ilustron situatën kur masat e vetizolimit kufizojnë përhapjen e sëmundjes. Pak e gungëzuar, si një guaskë breshkeje, ajo rrëshqet nën pragun e pashmangshëm.

Ky grafik paraqitet në Uashington deri në Paris, në Seul, Romë apo Dublin, dhe tregon urgjencën: shkalla e infeksioneve duhet të përhapet në kohë, që të shmanget stërnarkimi i shërbimeve shëndetësore. Duke i potencuar dy gungëzimet, gazetarët shmangin një element të rëndësishëm: vijën e drejtë, diskrete, në mes të grafikut, që paraqet numrin e shtretërve në dispozicion ku do të shtrihen rastet e rënda. Ky «prag kritik» i paraqitur si vlerë që nuk i dihet burimi është rezultat i zgjedhjeve politike. Duhet të «rrafshohet gunga «sepse, për dekada me radhë, politikat shtrënguese kanë zvogëluar kapacitetet pranuese të shërbimeve shëndetësore. Në vitin 1980, në Francë kishte 11 shtretër spitalor (përfshirë të gjitha repartet) për 1.000 banorë. Tani janë vetëm 6. Në shtator, një ministere e shëndetësisë makroniste propozoi që këto shtretër të menaxhohen nga ‘bed managers’ («menaxhues të shtretërve»), përgjegjës për furnizimin e këtij burimi të rrallë.

Në Shtetet e Bashkuara ishin të regjistruar 7,9 shtretër për 1.000 banorë në vitin 1970, kurse në vitin 2016 vetëm 2,8 (1). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), në vitin 1980 Italia ka pasur 922 shtretër të rezervuar për «raste të rënda» për 100.000 banorë, kurse vetëm 275, tridhjetë vjet më vonë. Gjithandëj i

njëti diskurs: zvogëlimi i shpenzimeve. Spitali do të funksionojë si një fabrikë veturash, në stilin «fiks në kohë». Si rezultat, më 6 mars të këtij viti, kompania italiane e anestezi, analgjezisë, reanimacionit dhe terapisë intensive (‘Siaarti’) e krahasoi punën e mjekëve italian të emergjencës me «mjekësi të fatkeqësive». Dhe paralajmëroi: duke pasur parasysh «mungesën e burimeve», «do të duhet ndoshta të përcaktojmë moshën kufitare për qasje në kujdesin intensiv» (2). «Mjekësia e luftës»: një term tani i zakonshëm në rajonin Grand-Est të Francës. Kriza e koronavirusit është shkaktuar po aq nga rrezikshmëria e sëmundjes, sa nga përkeqësimi i organizuar i sistemit shëndetësor. Jehonë e përhershme e kalkulimeve, mediumet kryesore shmangin analizën kritike të këtyre opsioneve për të ftuar lexuesit dhe dëgjuesit në një debat marramendës filozofik: si të vendoset se kush duhet shpëtuar dhe kush të lihet të vdes? Kësaj radhe, megjithatë, do të jetë e vështirë të fshihet çështja politike prapa një dilemeje etike. Sepse epidemia e Covid-19 zbulon në sytë e të gjithëve një organizim ekonomik edhe më absurd, se që e kishim menduar të gjithë. Derisa aeroplanë të zbrazët të linjave ajrore vazhdonin të fluturonin për t’i ruajtur oraret e fluturimeve, një studiues shpjegoi se si burokracia liberale kishte dekurajuar kërkimet themelore mbi koronaviruset (3). Marshall Burke, profesor i shkencës së ekosistemëve në Universitetin Stanford, vuri në dukje paradoksin: për ta kuptuar çrregullimin duhet të mendojmë jashtë rregullave. «Nga ulja e ndotjes së ajrit për shkak të epidemisë së Covid-19, në Kinë kanë shpëtuar ndoshta njëzet herë më shumë njerëz sesa numri i të vdekurëve nga sëmundja. Nuk duhet të konkludojmë se pandemitë janë të dobishme, por të kuptojmë sa sistemet tona ekonomike janë të dëmshme për shëndetin. Edhe kur nuk ka koronavirus (4)». Ngjarja kryesore e këtij udhëtimi në ‘Absurdia’ nuk ka qenë rreziku i mungesës së barnave për shkak të veprimtarisë offshore të rrjeteve të prodhimit, as insistimi i



Në Evropën e shekullit XXI, epidemia e Covid-19 ka goditur shoqëritë e sekularizuara, të cilat që nga kriza financiare e vitit 2008 ndihen të prekura në shkallë të ndryshme nga ndjenja e “humbjes së kontrollit” ekologjik, politik, financiar, demografik, migrues, etj.

shpejt do t’i kishte mbytur institucionet që pranojnë pacientët më të prekur, pasi që format kritike të Covid-19 kërkojnë para së gjithash ventilim mekanik, një veprim i kushtueshëm në kohë, por më pak fitimprurës në rubrikat tarifore sesa shumë kontrolli mjekësor të shtyera për shkak të epidemisë...

Për një kohë, dukej se muret e hapësirës sociale u rrëzuan nga mikrobi që shkaktoi masat më të rënda të vetizolimit të imagjinueshme në kohë paqeje. A nuk u kërcënuan papritmas njësoj bankierët e Wall Street dhe punëtorët kinezë? Por paraja u rikthye shpejtë në pozicionin e saj. Nga njëra anë, të vetizoluarit nëpër villa, që punojnë online, duke prekur ujin e pishinës me këmbë; nga ana tjetër, ata që zakonisht vërehen shumë pak, personeli mjekësor, mirëmbajtësit, arkëtarët e supermarketeve dhe punëtorët e logjistikës. Ata dallohen tani për herë të parë, sepse i nënshtrohen një rreziku nga i cili kursehen më të pasurit. Punonjës të tjerë që punojnë nga shtëpia, në banesa të papërshtatshme, ku dëgjohet zhurma e fëmijëve; njerëz të pastrehë që kishin dashur të kenë një shtëpi për t’u strehuar.

NUK KA RRUGËDALJE PA QASJE KOLEKTIVE, TË KOORDINUAR DHE TË GJERË

Në “tipologjinë e sjelljes kolektive në kohë të murtajës” midis shekujve XIV dhe XVIII, historiani konservator Jean Delumeau nënvizon këtë dukuri: “Kur shfaqet rreziku i kontaminimit, fillimisht provojmë ta injorojmë (5)”. Shkrimtari gjerman Heinrich Heine vëren se pas njoftimit zyrtar të epidemisë së kolerës në Paris në vitin 1832, “parisienët bënin shumë qejf nëpër bulevarde ‘sepse’ ishte ditë me diell dhe moti i bukur” (6). Pastaj të pasurit ikën në fshat.

Pastaj qeveria e vendosi qytetin në karantinë. Dhe, papritmas, shpjegon Delumeau, “ndryshoi rendi i zakonshëm familjar. Pasiguria nuk shfaqej vetëm nga prania e sëmundjes, por edhe nga shkatërrimi i elementeve që ndërtonin mjedisin e përditshëm. Gjithçka është ndryshe». Banorët e ngujuar në Wuhan, Romë, Madrid dhe Paris e përjetojnë atë në një shkallë të paparë.

Murtajat e mëdha të Mesjetës dhe Rilindjes shpesh interpretoheshin si një shenjë e Gjykimit të Fundit, një shenjë e tërbimit të një Zoti hakmarrës ndaj botës në ditët e fundit të saj. Atëherë secili kthehej herë kah qielli për të kërkuar ndihmën e Zotit, herë kah fqinjët për të kërkuar fajtorë - hebrejtë dhe gratë, të cilëve u referohet gomari që akuzohet në fabulën “Les animaux malades de la peste” (Kafshët e sëmura nga murtaja) të Jean de La Fontaine. Në Evropën e shekullit XXI, epidemia e Covid-19 ka goditur shoqëritë e sekularizuara, të cilat që nga kriza financiare e vitit 2008 ndihen të prekura në shkallë të ndryshme nga ndjenja e “humbjes së kontrollit” ekologjik, politik, financiar, demografik, migrues, etj. Në këtë atmosferë të “fundit të botës”, ku përzihen imazhe të Notre-Dame de Paris duke u djegur dhe debate mbi kolapsin e ardhshëm, vëmendja drejtohet kah pushteti publik: Shteti, burim i rëndimit të problemit përmes kokëfortësisë së tij për të shkatërruar sistemin shëndetësor, por i cili është e vetmja instancë që mund të urdhërojë dhe të koordinojë një përgjigje ndaj epidemisë. Por deri në ç’masë? Gjatë muajit shkurt, mbyllja gjatë disa javëve e pesëdhjetë e gjashtë milion banorëve të Hubei në Kinë, ndalimi i detyruar i punës në fabrika, thirrjet për rend nëpër qytete përmes droneve të pajisur me kamera dhe megafonë, provokuan në Evropë komente komike, apo kritika mbi kontrollin e hekurt të Partisë Komuniste.

“Asnjë mësim nuk mund të nxirret nga përvoja kineze për kohëzgjatjen e mundshme të epidemisë,” shkruan revista *L'Express*, më 5 mars. Atje u ngadalësua epidemia falë masave drastike të izolimit, ndoshta të pazbatueshme në demokracitë tona”. Mjerisht, përballë viruseve të pandjeshme ndaj superioritetit të vlerave “tona”, duhet të pranojmë t’i vëjmë në plan të parë vendimet e centralizuara dhe liberalizmin ekonomik në plan të dytë. Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së, z.Tedros Adhanom Ghebreyesus thekson se “mund të shtyhet epidemia, por vetëm në bazë të një qasjeje kolektive, të koordinuar dhe të gjerë, e cila përfshin tërë makinerinë (7)”. Kolektiv, koordinim, shtet: e kundërta e ekonomisë së tregut. Brenda disa ditëve u shfaq ana e kundërt e kornizës interpretuese të rendit shoqëror: “Gjithçka është ndryshe”. Nocionet e sovranitetit, të kufijve, të limiteve dhe madje të shpenzimeve publike, për gjysmë-shekulli ishin të asociuara në diskursin publik me “popullizmin nacional” ose me Korenë e Veriut. Papritmas, ato shndërrohen në zgjidhje në një botë e cila deri tani ishte e rregulluar nga kulti i flukseve dhe rigorozitetit buxhetor. Avangarda arbitrare, e nxitur nga paniku, zbulon tani atë që dëshiron të injoronte. “A mund të themi gjithashtu se në fakt kjo krizë na fton të rimendojmë fusha të tëra të globalizmit: varësinë tonë ndaj Kinës,

tregtisë së lirë dhe aeroplanëve?”, thotë gazetari Nicolas Demorand në Radio France Inter, më 9 Mars, në emisionin e tij ku qenë të ftuar vite më radhë mbrojtësit e proteksionizmit, si Daniel Cohen.

“PROBLEMI ME EKSPERTËT ËSHTË SE NUK JANË TË VETËDIJSHËM SA GJËRA INJOROJNË”

Arsyeja e tregut ka rikonfiguruar sigurisht perceptimet pasi që shpërthimi i vetëm i një pandemie vdekjeprurëse ka bërë të dëgjohet më në fund fuqia e truizrave të shprehura nga profesionistët mjekësor për dekada: “Po, duhet të kemi një strukturë spitalore publike e cila do të ketë vazhdimisht shtretër në dispozicion”, konkludojnë mjekët André Grimaldi, Anne Gervais Hasenknopf dhe Olivier Milleron. Koronavirusi i ri na rikujton gjëra evidente: zjarrëfikësit nuk paguhen vetëm për të shuar zjarre, ne duam që ata të jenë të pranishëm dhe të gatshëm në kazemat e tyre, madje edhe kur ata vetëm i pastrojnë kamionët duke e pritur sirenën (8). Të parashikohet ajo që ndodh pa paralajmërim (zjarri, sëmundja, kataklizmi, kriza financiare): kështu është përjetësuar dhe rinovuar kapitalizmi në mes të krizës të vitit 1929 dhe përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, duke e përfshirë këtë

Garantuesit e status quo-së të cilët mbështeten në situatat e pashpresa për ta zgjeruar kontrollin e tregut përfitojnë zakonisht nga goditjet më brutale. Ky kapitalizëm i katastrofës, i studiuar pak para recesionit të madh të vitit 2008 nga autorja Naomi Klein, përçmon varfërimin e burimeve natyrore dhe të institucioneve të mbrojtjes sociale, të cilat mund ta zbusin krizën

kërkesë popullore në institucionet e tij, shpesh kundër vullnetit të tij. Të planifikosh të paparashikueshmen kërkonte shkëputjen nga racionaliteti i tregut, i cili rregullon çmimin sipas ofertës dhe kërkesës, përçmon të papriturën dhe modelon të ardhmen, duke përdorur ekuacione, ku ndërmarrjet nuk merren parasysh.

Ish-komisioneri financiar dhe statisticienti Nassim Nicholas Taleb vërejtë këtë verbëri të ekonomisë standarde, e sjellur në pikën e saj më të lartë në dhomat e tregtisë. Në një libër të botuar disa muaj para krizës së vitit 2008, ai theksonte në lidhje me menaxherët e shitjeve afatshkurtra: “Problemi me ekspertët është që nuk janë të vetëdijshëm sa gjëra injorojnë”(9). Sipas tij, është absurde të neglizhosh të papriturën në një botë të shënuar nga shtimi i ngjarjeve të papritura, të ashtuquajtura «mjellmat e zeza». Në fund të marsit

2020, kushdo i vetizoluar që dëgjoi heshtjen e qytetit ka mundur të meditojë mbi këmbënguljen e shtetit për t’u zhveshur jo vetëm nga shtretërit e reanimacionit, por edhe nga instrumentet e tij të planifikimit, tani të monopolizuar nga disa kompani multinacionale të sigurimeve dhe risigurimeve (10).

A mund ta kthejmë këtë kurs gjatë pauzës së shkaktuar nga pandemia? Përfshirja e elementit të rastit dhe të papritur në menaxhimin e punëve publike, analiza përtej llogaritjes kosto-përfitim, implementimi i planifikimit ekologjik do ta nënkuptonin socializimin e shumicës së shërbimeve të domosdoshëm për jetën e shoqërive moderne- shërbimet e pastrimit, shëndetësisë deri te rrjetet digjitale: një ndryshim që ndodh rrallë në kohëra të zakonshme. Vështirimi i një historiani sugjeron që diskutimet e zakonshme politike nuk përfshijnë ndryshimet e regjimit, ndryshimet e trajektoreve apo të të menduarit të jetës kolektive dhe të barazisë. «Historikisht, shkruan historiani austriak Walter Scheidel, profesor në Stanford, ristrukturimet më të mëdha kanë rezultuar nga goditjet më të rënda. Katër lloje të shkëputjeve të dhunshme kanë arritur kështu t’i zbusin pabarazitë: lufta kur përfshin mobilizim masiv, revolucionet, falimentimet shtetërore dhe pandemitë vdekjeprurëse» (11). A kemi arritur në këtë pikë? Nga ana tjetër, sistemi ekonomik ka treguar gjatë historisë së tij një aftësi të jashtëzakonshme për të thithur goditjet gjithnjë e më të shpeshta që krijohen nga irracionaliteti i tij. Kështu, garantuesit e status quo-së të cilët mbështeten në situatat e pashpresa për ta zgjeruar kontrollin e tregut përfitojnë zakonisht nga goditjet më brutale. Ky kapitalizëm i katastrofës, i studiuar pak para recesionit të madh të vitit 2008 nga autorja Naomi Klein, përçmon varfërimin e burimeve natyrore dhe të institucioneve të mbrojtjes sociale, të cilat mund ta zbusin krizën. Në një elan optimizmi, kjo eseiste kanadeze thoshte: «Nuk reagojmë gjithmonë ndaj tronditjeve duke regresuar. Në kohë krize, ndonjëherë rritemi – shpejtë.»

Presidenti francez Emmanuel Macron deshi ta jepte një përshtypje të tillë më 12 mars 2020, kur shprehi dëshirën e tij për ta «rishqyrtuar

modelin e zhvillimit në të cilin është angazhuar bota jonë për dekada dhe që zbulon haptazi gabimet e tij, si dhe për t’i analizuar pikat e dobëta të demokracive tona. Kjo pandemi tani ka treguar se shteti ynë i mirëqenies me kujdes shëndetësor falas pa marrë parasysh të ardhurat, karrierën apo profesionin, nuk nënkupton kosto apo shpenzime, por është pasuri e çmuar, aset i domosdoshëm kur fati godet. Kjo pandemi tregon se ka mallra dhe shërbime që duhet të vendosen jashtë ligjëve të tregut. Në fakt është çmenduri t’i delegohet dikujt tjetër ushqimi jonë, mbrojtja jonë, aftësia jonë për t’u kujdesur për mjedisin tonë vital. Duhet ta rimarrim kontrollin.» Tri ditë më vonë, Macron shtyu reformën e pensioneve, reformën për shtesat e të papunëve dhe pastaj dekretoi zbatimin e masave të konsideruara deri më tani të pamundura – kufizimin e shkarkimeve nga puna dhe heqjen dorë nga kufizimet buxhetore. Rrethanat do ta theksojnë këtë ndryshim: me rënien e vlerave të tregut të bursës, obsesioni presidencial për t’i drejtuar kursimet dhe pensionet e kuadrove në tregjet e aksioneve duket si një lëvizje gjeniale vizionare. Sidoqoftë, pezullimi i kodit të punës, kufizimi i lirive publike, financimi i kompanive si dhe për këto kompani mosdetyrimi i kontributeve sociale mbi të cilat mbështetet sistemi shëndetësor nuk shënojnë një thyerje rrënjësore me politikat e mëparshme. Ky transfer masiv i parave publike në sektorin privat na rikujton vitin 2008 kur bankat u shpëtuan nga shteti. Rezultati mori formën e masave shtrënguese të imponuara për punonjësit dhe shërbimet publike. Më pak shtretër? Po: duhej ndihmuar bankat. Kjo është arsyeja pse epifania e kreut të shtetit evokon reagimin e Nicolas Sarkozy një ditë në shtator 2008, menjëherë pas rënies së Lehman Brothers. Para mbështetësve të tij pa fjalë, Presidenti i Republikës kishte njoftuar në mënyrë solemne: “Kapitalizmi financiar kishte imponuar logjikën e tij në tërë ekonomi dhe kishte kontribuar në ç’rregullimin e saj. Një kuptim mbi globalizmin merr fund me rënien e këtij kapitalizmi (...) Ideja që tregjet kanë gjithmonë të drejtë ishte një ide e çmendur (12). Por, kur kaloi stuhia, ai u kthye në rrjedhën e çmendurisë së zakonshme.



(1) Burimi: Organizata e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OCDE).
(2) «Raccomandazioni di etica clinica per l'ammissione a trattamenti intensivi e per la loro sospensione», Siaarti, Romë, 6 mars 2020.
(3) Bruno Canard, «J'ai pensé que nous avions momentanément perdu la partie», déclaration du 5 mars 2020, mund të lexohet në <https://academia.hypotheses.org>
(4) Twitter, 9 mars 2020.
(5) Jean Delumeau, La Peur en Occident, XIVe -XVIIIe siècle, Fayard, Paris, 1978.
(6) Heinrich Heine, De la France, Gallimard, coll. «Tel», Paris, 1994 (1re éd.:1833).
(7) The New York Times, 9 mars 2020.
(8) Le Monde, 11 mars 2020.
(9) Nassim Nicholas Taleb, The Black Swan. The Impact of the Highly Improbable, Random House, New York, 2007.
(10) Razmig Keucheyan, La nature est un champ de bataille. Essai d'écologie politique, La Découverte, Paris, 2014. (11) Walter Scheidel, The Great Leveler.

ARTAN MUSTAFA, LIGJËRUES I POLITIKËS SOCIALE DHE SOCIOLOGJISË POLITIKE

Njëjtë, por ndryshe

Qeveria Kurti nuk u shkëput nga paradigma neoliberale. Si qeverisje e vazhdimësisë, ajo do të konsolidohet si populiste e djathtë.

INTERVISTOI: SHKODRAN HOTI

- Kuvendi i Kosovës e ka shkarkuar Qeverinë Kurti më 22 mars. Duke iu referuar programit të saj, Ju e keni cilësuar si qeveri të vazhdimësisë. Si e shpjegoni këtë qëndrim, duke marrë parasysh se kjo qeveri perceptohet nga jo pak njerëz, si qeveri e shkëputjes dhe progresive?

Artan Mustafa: Nga këndvështrimi i ekonomisë politike, programi i Qeverisë Kurti nuk sugjeronte zhvendosje thelbësore nga paradigma neoliberale e instaluar menjëherë pas luftës nga organizatat ndërkombëtare, veçanërisht nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar përmes Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Me gjuhë neutrale në program përmendeshin, për shembull, reforma në sistemin pensional, në politikat e punës e të taksave, benefitet për fëmijë etj., por mungonin detajet për kahjen dhe dizajnin e këtyre reformave. Gjithashtu, programi sugjeronte mirëmbajtjen (pra jo reformën) e disa prej skemave më të problematizuara të transfereve të financuara nga qeveria si ajo për veteranët e luftës dhe vazhdimësinë (pra jo ndryshimin) në mënyrën si qeveria e koncepton

ndihmën sociale - si mbrojtje nga varfëria ekstreme në konsum, e cila është qasje që i takon historisë së largët dhe jo të tashmes në Evropë. Që nga kritika ndaj Lëvizjes Vetëvendosje në lidhje me programin e qeverisë, lidhshipi i saj është arsyetuar publikisht se programin e ka shkruar më shumë Lidhja Demokratike e Kosovës. Edhe ky pohim vetëm shton në argumentin se pritej më shumë vazhdimësi sesa zhvendosje: nëse LDK e ka shkruar programin, me siguri prapa gjuhës neutrale të përmendur më lart nuk mund të pritej një agjendë tjetër thelbësisht e ndryshme nga ajo që kjo parti ka ndjekur gjatë tërë pasluftës. Bisedimet për formimin e Qeverisë dhe programin qeverisës patën zgjatuar katër muaj: duke pasur parasysh stilin dhe strategjinë e VV-së, një partie të pakompromis në qasjen e vet, ky fleksibilitet i saj i treguar në hartimin e programit qeveritar është jokonsistencë e radhës në artikullimet e saj publike. Asgjë në program nuk sugjeronte një sofistikim përmbajtësor të marrëdhënies shtet-treg, me qëllim që ndërhyrja e shtetit në ekonomi të funksiononte drejt barazisë sociale.

Dogmatizmi konservator

- Si e vlerësoni Pakon Emergjente Fiskale të nxjerrë nga qeveria?

Artan Mustafa: Ministri i Financave dhe Transfereve jep përshtypjen se ka ekspertizë në fushën e politikës fiskale, jep përshtypjen se ka vetëbesim të lartë në veprimet e tij, dhe konsultoi disa nga aktet socialë para se të vepronte, që janë të gjitha cilësi të mirëseardhura. Megjithatë, gjykuar mbi versionin e parë të 15 masave ekonomike, duket se masat qeveritare dhe veprimet e ministrit ndikohen nga shkolla konservative neo-liberale ekonomike dhe kanë dështuar të marrin parasysh perspektiva dhe zëra të tjerë relevantë. Ministri (për shembull në intervistën më datën 8 prill 2020 në emisionin “Desku” të KohaVisionit dhe në konferencën për shtyp më datën 14 prill 2020) është deklaruar se Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe institucione

tjera të ngjashme kanë vlerësuar shumë pozitivisht masat e qeverisë në krahasim me rajonin, se prandaj janë të gatshme të lëshojnë kredi për Kosovën, duke përdorur këtë vlerësim për t’i diskualifikuar kritikën dhe alternativat e opozitës. Fillimisht, është paradoksale që një ministri kyçe e drejtuar nga VV-ja, parti që provokoi mocionin e qeverisë duke mos bashkëpunuar me Qeverinë e SHBA-së për dialogun, përdor mbështetjen e këtyre organizatave ose të “konsensusit të Washingtonit” si kriter të vetëvlerësimit. Por më e rëndësishmja është të kuptohet përse këto organizata, në veçanti FMN, patën këtë opinion mbështetës ndaj masave të qeverisë? Një arsye e rëndësishme qëndron te logjika e masave të qeverisë të cilat, ashtu sikurse edhe programi qeveritar, ndjekin me rigorozitet logjikën e politikës së mbrojtjes sociale të instaluar pas luftës nga po këto organizata ndërkombëtare. Kjo politikë ofron një



“Është paradoksale që një ministri kyçe e drejtuar nga VV-ja, parti që provokoi mocionin e qeverisë duke mos bashkëpunuar me Qeverinë e SHBA-së për dialogun, përdor mbështetjen e këtyre organizatave ose të “konsensusit të Washingtonit” si kriter të vetëvlerësimit. Por më e rëndësishmja është të kuptohet përse këto organizata, në veçanti FMN, patën këtë opinion mbështetës ndaj masave të qeverisë?”

prag të ulët të mbështetjes (*social floor*) publike, të koncentruar në mbrojtje të popullatës nga varfëria ekstreme, ndërsa pret që shumica e mirëqenies të krijohet në treg. Ky model i mbrojtjes sociale kudo që aplikohet njihet për vendosje të shpeshtë testeve të nevojës (*means testing*) dhe kriterëve të ndërlikuar të cilat efektivisht çojnë në shpenzime të përgjithshme të vogla dhe janë më së paku efektive në luftimin e varfërisë në krahasim me strategjitë tjera për reduktimin e varfërisë dhe pabarazisë. Kështu do të ndodhë edhe me qasjen dorësh-trënguar të Qeverisë Kurti: kriteret e shumta (p.sh. mbulimi i rrogës së punëtorit me pagë minimale që nuk është përditësuar nga viti 2011 me kushtin ndër të tjera që punëdhënësi të dëshmojë që është dëmtuar nga masat kundër Covid-19, e drejta në kompensim të punëtorit të larguar me kushtin që të dëshmohet se është larguar shkaku i pandemisë dhe ish-punëdhënësi të mbushë një formular në Agjencinë Tatimore të Kosovës, e drejta e të papunëve për kompensim nëse jetojnë në familje pa të ardhura nga puna dhe nëse janë të lajmëruar në Agjencinë e Punësimit, obligimet tjera që të shtohen dokumente të ndryshme etj., etj.) dhe shumat e vogla, do të rezultojnë me numër të vogël të përfituesve në fund, shumë të vogël të shpenzimit të përgjithshëm, si dhe nuk do ta parandalojnë thellimin e varfërisë. Gjithashtu, masat e qeverisë për ndihmesë në likuiditetin biznesesh indikojnë (nëse përpjesëtojmë buxhetin e ndarë dhe shumën për sa bizneset mund të aplikojnë) se ajo pret të ndihmojë diku 1.500 biznese, mirëpo gjendja ka ndikuar shumë më tepër sosh – çka mund të ketë pasojë në largimin nga puna të shumë më tepër punëtorëve formalë e joformalë. Për pasojë, një qeveri e ardhur me premtime ndër të tjera edhe progresive, me masat e saj, nuk do të favorizojë sa ka mundur interesat e 50% më të varfër të popullatës pa rrezikuar qëndrueshmërinë financiare. Në përgjithësi masat e qeverisë janë qasje dogmatike të qeverive shumë konservatore, janë shumë pak dekomodifikuese dhe e trajtojnë gjendjen e sotme si të ishte gati se normale. Përkundrazi, vendet që aplikojnë “*social floor*” të ulët, që ndjekin modelin liberal të shtetit të mirëqenies, të gjitha kanë marrë masat më radikale të mbrojtjes gjatë pandemisë pikërisht duke e ditur që pragu i zakonshëm është shumë i ulët, si p.sh. Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara, Hong Kong-u, Zelanda e Re etj. Përveç kësaj, shpesh mungojnë shumë informata të nevojshme për

aplikantët, masat e qeverisë nuk janë gjithëpërfshirëse ngase nuk kanë trajtuar tema tjera si p.sh. sjelljet e diskutueshme në sigurimet private në treg, nuk është dëgjuar sa duhet opozita, nuk jepen informacione më të detajuara në lidhje me kreditë ndërkombëtare, etj.

- Keni ngritur alarmin për anashkalimin e sektorit privat në kohën e pandemisë. Cili është shqetësimi Juaj? Keni sugjeruar që Qeveria e Kosovës duhet ta ofrojë “Pagën e Jetesës” për të gjitha familjet njësoj, madje duke u futur edhe në borxh. Këtë e keni quajtur madje oksigjenoterapi për ekonominë?

Artan Mustafa: Gjatë dy dekadave të kaluara, Qeveria e Kosovës nuk ka qenë realisht shumë e interesuar për atë se çfarë ndodh në tregun e punës për shkak se buxheti i shtetit mbushet deri në 85% nga taksat në konsum (TVSH, akcizë, shërbime qeveritare etj.). Ky interesim i vogël qeveritar (që dëshmohet edhe me numrin e vogël të inspektorëve të punës dhe rishikimin e rrallë të ligjeve të punës) për të luftuar informalitetin dhe mungesa e sigurimeve cilësore sociale publike (që do të shërbenin si insentiva racionale për deklarim për punëtorët), janë disa nga faktorët që shpjegojnë përse kemi ekonomi të lartë joformale e që llogaritet se përfshin diku 150.000 punëtorë (ose 35% e punëtorëve sipas Bankës Botërore). Me masën e 15-të (nëse përpjesëtohet buxheti i përgjithshëm me shumën e ndarë), Qeveria indikon se ajo mendon që informaliteti është rreth 11.500 punëtorë – që është qartësisht nënçmim i realitetit. Ekonomia joformale dhe punëtorët me aftësi të vogla të punës, pra pjesa më e pafuqishme e punëtorëve që mund të rrezikohen nga kriza me largim nga puna, do ta ndjejë më së shumti shtrëngimin ekonomik. Tani, duke qenë se edhe Qeveria është përgjegjëse për informalitetin, nuk mund t’i dënojë familjet përkatëse. Shuma e vogël (130 Euro nga masa e 15) dhe kriteret, paqartësitë administrative të zbatimit të masës dhe mungesa e njohurisë (literacy) të publikut, do të dekurajojnë ose parandalojnë shumë njerëz të marrin beneficinet. Në deklaratimet publike, ministri përmend rregullisht qëllimin se masat ofrojnë mbulim për varfërinë ekstreme. Në Evropë gati se gjithkund varfëria ndjek dallimet relacionale në të hyra dhe jo mbulimin e konsumit minimal për jetesë, që përkthehet në benefite substancialisht më gjenëroze. Prandaj “Paga e Jetesës” do të ofronte mbrojtje më gjeneroze

dhe më adekuate së paku gjatë kësaj kohe për familjet me më së shumti nevojë për të dhe do të ishte shumë më thjeshtë e aplikueshme dhe më lehtë e menaxhueshme. Masat e këtilla dorështrënguar të qeverisë duken joproporcionale edhe për shkakun se pagat e sektorit publik - që financohen relacionalisht më shumë nga taksat e të varfërve e që këtë rast përbën atë që njihet si “ridistribuium pervers” – nuk preken në asnjë mënyrë pavarësisht se aktiviteti në punë është pezulluar ose reduktuar.

- Janë shumëzuar zërat që po i kritikojnë politikat qeveritare të përkufizuara në masat e izolimit kundër Covid-19, duke theksuar se po “harrohet” ekonomia. Sa qëndron kjo dhe çfarë masash duhen ndërmarrë në kuptim të barazpeshës në mes shëndetit dhe ekonomisë?

Artan Mustafa: Aftësia e Qeverisë Kurti për veprim gjatë pandemisë është kufizuar ligjërisht në dy dimensionë kryesore. Së pari, Qeveria ka hezitur të mbështes masat e jashtëzakonshme duke u frikësuar se do të ketë si pasojë më pak përgjegjësi në menaxhimin e krizës. Së dyti, masat ekonomike emergjente të Qeverisë mund të kërkojnë hapje rrugë përmes Parlamentit, çfarë është vështirësuar për shkak të mocionit. Të dy këto rrethana kufizojnë mundësitë e qeverisë që të merret me menaxhimin e suksesshëm të krizës dhe ato edhe një herë ngrisin nevojën e ndonjë marrëveshje ose hapje rrugë për dalje nga kriza. Qeveria Kurti ka pasur legjitimitetin qytetar të fituar me vota, mirëpo është duke mbërritur kufijtë e rrezikimit të mirëqenies qytetare dhe sigurisë publike në këtë kohë.

Në lidhje me masat ekonomike të paskrizës, nuk shoh që kjo do të jetë përgjegjësi e Qeverisë së sotme Kurti. Por, gjithësesi ato masa do të duhej të konsultonin në mënyrë më gjithëpërfshirëse më shumë akterë vendorë dhe t'i përshtaten më mirë dhe pa dogmatizëm nevojave të Kosovës. Nga

këndvështrimi i politikës sociale, masat e zgjeruara të politikës së aktivizimit (si p.sh. punët ose projektet publike, insentivat përmes taksave, trajnimet drejt angazhimit në projekte të financura nga donatorët etj.) duhet të jenë pjesë shumë e rëndësishme e strategjisë për dalje nga kriza ekonomike. Në kuptimin më afatgjatë, pjesë e rëndësishme duhet të jetë edhe fillimi i vendosjes së sigurimeve sociale. Për shembull, Qeveria veprimi në mënyrën e duhur duke shpallur ankand të letrave me vlerë në pritje të blerjes (30 milionë) së tyre nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës derisa fondi provon ta kufizojë rrezikshmërinë e investimeve nga luhatja në tregjet financiare perëndimore. Por, ky rrezik i vazhdueshëm nga luhatjet në treg, sidomos dështimet e tregut të kursimeve për të ofruar solidaritet dhe mbrojtje adekuate të të ardhurave në moshë, si dhe krahasimet me sistemet tjera pensionale kërkojnë dmosdoshmërisht pluralizimin dhe korrektimin institucional të sistemit tonë pensional sipas praktikave më të mira pas rënies së paradigmes së privatizimit të pastër pensional që nuk është pranuar as vetë në SHBA.

- Si e vlerësoni kërkesën e Qeverisë për solidaritet financiar nga diaspora?

Artan Mustafa: Mund të jetë që Qeveria kujdestare Kurti frikësohet se nuk do të jetë në gjendje të gjëjë rrugëdalje përmes Kuvendit dhe provon ta lehtësojë fushëveprimin e saj përmes mjeteve alternative. Por është mirë që Qeveria ka hapur llogari publike për aq sa është brenda ligjit: fondet do të jenë transparente dhe solidariteti anonim. Mirëpo, nuk mund të pritët mbështetje e diasporës sikurse gjatë viteve 90-të, për shkak se tani “distanca sociale” ndërmjet vendlindjes dhe diasporës është rritur, ngaqë kriza ekonomike në përfundim do ta prekë (sikur më 2008) shtresën më të ulët të punëtorëve ku shpesh bën pjesë diaspora jonë, dhe ngaqë zgjidhja duhet gjetur brenda mundësive të politikave të Kosovës.

Artan Mustafa: Orientimi i VV-së së kohës së themelimit më shumti mund të përshkruhet si etno-nacionalist: kombi, e mbi të gjitha etnia shqiptare, ishte në qendër të diskutit të saj, ndërsa faktorët e jashtëm gjykoheshin të panevojshëm në drejtën për të vetëvendosur për shtetin qoftë edhe për bashkim me Shqipërinë. Prapa, këtij diskursi



“Qeveria Kurti ka pasur legjitimitetin qytetar të fituar me vota, mirëpo është duke mbërritur kufijtë e rrezikimit të mirëqenies qytetare dhe sigurisë publike në këtë kohë.”

në dukje ekstremist sidoqoftë ishte një grup i të rinjve i njohur në shoqërinë e përditshme të Prishtinës për civilitet. Më vonë, sidomos pas hapësirës që u krijua pasi Partia Demokratike e Kosovës braktisi qëndrimin e saj kuazi-të-majtë, shohim një ecje më të vendosur të VV-së majtas, por që tani gjithnjë e më shumë po shfaqet si populizëm i majtë ndoshta edhe pa dashjen e një pjese të madhe të strukturës së saj. Pas thyerjeve të vazhdueshme të brendshme, e sidomos thyerjeve të saj më 2017, VV gjithnjë e më shumë drejtohet joproporcionalisht nga një lider karizmatik, artikulon interesat e “popullit” të pastër e të mirë kundër “elitës” së korruptuar dhe “armiqve të popullit” me në krye kryearmikun - Presidentin aktual, sfidon autoritetin e institucioneve të deleguara si Gjykata Kushtetuese, sfidon përfshirjen e qeverive të huaja perëndimore në politika e vendimarrje dhe koncentrohet në tema të gjëra “catch-all” si korrupsioni. Të gjitha këto janë tipare të populizmit. Këto pak ditë në qeveri dhe diskursi i saj në vitet e fundit që nuk pasur në qendër pabarazinë ekonomike treguan që pjesa e majtë programore është më shumë shtesë, që dështoi të

theksohet, ndoshta edhe për shkak të mangësive kuadroviqe që ka VV. Mangësitë në kuadrin e përgatitjes së politikës cilësore u shpërfaqën brutalisht edhe me qasjen e VV-së ndaj dialogut me Serbinë ku edhe si parti e parë (pra jo vetëm si një nga partitë opozitare ose një lëvizje e vogël, kuazi-studentore e dikurshme) VV nuk prezantoi asnjëherë alternativë realiste e kredibile në kontekst multilateral.

Në Lidhjen Demokratike të Kosovës sot mund të vërehen tri rryma: një rrymë edhe më e thjeshtë populiste e drejtuar nga kandidatja për Kryeministre Vjosa Osmani e cila poashtu flet kryesisht për “kryearmikun e popullit”, një rrymë korporatiste që mundohet të imitojë Partinë Kristian-Demokrate të Gjermanisë e ndjekur nga kryetari Isa Mustafa, dhe një rrymë që ndoshta është më e përhapura brenda elitës së saj të re e cila del nga një shkollë ekonomike dhe ndjek konservatizmin klasik radikal pro-tregut.

Gjykuar nga konteksti ideologjik i partive në koalicionin qeverisës, disa nga veprimet populiste mediatike të qeverisë, përbërjes dhe programit të kabinetit qeverisës, kemi shumë arsye të besojmë se kjo qeveri do të konsolidohet si populiste e djathtë, pra do të shihnim më shumë veprime populiste brenda një vazhdimësie më të gjërë të ekonomisë politike neoliberale. Është e qartë që brenda VV-së ka veprimtarë që artikulojnë social-demokracinë, mirëpo këta zëra nuk kanë ardhur në shprehje në qeveri sa zyrtarët e saj me orientim dogmatik konservator dhe figurat e diskursi populist. Megjithatë, përtej manifestimeve dhe krizës aktuale politike e cila shpresojmë se nuk denigron përtej kuadrin ligjor, këto konflikte dhe zëra mund të rriten në cilësi dhe të shtyjnë përpara demokratizimin në të ardhmen.

- Cilat janë prioritetet në fushën e politikave publike dhe sociale, të cilat qeveria do të duhej të mos i anashkalonte?

Artan Mustafa: Në dhjetë vitet e ardhshme, që mund të jenë dhjetë vitet e para pas pranimit të vendit në Kombet e Bashkuara, për bindjen time, Kosovës i duhet të koncentrohet në zhvillim të qëndrueshëm, pra në konsolidim të brendshëm, dhe në futjen e diplomacisë së saj në shërbim të këtij interesi, duke tërhequr mbështetje dhe përvoja sa më të mëdha nga jashtë. Abc-ja e këtij zhvillimi të qëndrueshëm lyp një kontratë sociale që koncentrohet në rritjen e shkallës së punësimit së paku deri në 60% dhe rritjen e institucionizimit e solidaritetit shoqëror. Kjo kërkon rritje ekonomike, inovacion dhe përdorim radikal të masave të aktivizimit në punësim, shtrirje dhe forcim të të drejtave në punë, themelim dhe konsolidim të sigurimeve shoqërore, zgjerim dhe konsolidim të kujdesit social publik (arsim, shëndetësi, kujdes për fëmijë, kujdes për personat në nevojë), reformë të taksave me qëllim të rritjes së progresivitetit dhe të inkasimeve që mblidhen nga taksat në të hyra, taksat në pronë dhe trashëgimi, dhe përdorim të politikave të banimit për të ulur varfërinë dhe për të rritur përfshirjen afatgjatë sociale. Kjo qasje do të rrisë demokracinë në ekonomi, do të rrisë interesin racional për punësim formal, dhe do të forcojë barazinë sociale e qëndrueshmërinë financiare. Përveç zgjerimit radikal të kujdesit social publik, investimet shtetërore duhet të koncentrohen edhe në veprimtari të caktuara prodhuese (p.sh. që janë të komplikuar për tregun ose që ndërmerren për të krijuar punë publike) dhe në menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore ose ambientit tonë.

OPINION

Mos u trembni, kapitalizmi kaq i dashur do të fitojë

Jam i sigurt që Kapitalizmi do realizojë atë që thashethemet konspirative imagjinojnë. Gjermania dhe Franca do të blejnë “ekonominë” italiane dhe atë spanjolle, pikërisht siç ndodhi me Greqinë (Ju kujtohet Varufakis shpresoj). Askush s’do mërzhitet dhe nëse Kina urtë e butë, do mari copa nga tortat e shteteve të sëmura. Jo se është konspiracion, por se i tillë është ky sistem. Më i forti merr gjithçka.

NGA ANDI KANANAJ

Kalimi shumë i shpejtë nga bota kur dita nuk shtyhej, po vitet fluturonin, duket se i ka ardhur fundi. Tani për disa kohë, dita nuk do të shtyhet, dhe kaq. Ndoshta për pak kohë vitet do të kthehen mbrapsht, derisa të harrojmë të numërojmë, ose ngadalë të shpikim numra të rinj. Këto ditë mbushur vetëm më një lajm dhe shumë ankesa, duket se ka vend për të gjithë për ëndërruar. Komunistët duket se kanë shansin të ëndërrojnë sërish. Treni i botës duket se ka kuptuar se me shumë se radha për të blerë celularin e fundit, vlen radha në spital kur nje virus dal nga patatinat në Wahan, (ndoshta) ai që na tregoi se jemi delikat, se ngrohja globale nuk është barcoletë për paranojakë Oj-fsh. Se shpresa bomba atomike do dalë në kohë nga kapela magjike ose parukja mistike e Presidentit Trump e do na shpëtojë nga UFO apo meteorë, është letërsi Netflixi. Me pak fjale mjaftoka një mikrob, i vogël sa nje mikrob, i dalë nga shpretka e një lakuriqi nate cfarëdo, për të na hedhur tuç, pa filluar ende loja me shtete e aleanca. Kaq duhet të mjaftonte që bota të kuptonte se gjithçka po bëjmë është një gabim. Por, ndërkohë ka filluar ankthi tjetër, ai i ekonomisë.

EKONOMIA

Problemin e ikjes në pikatë të ekonomisë duket se e hedhin ekonomistët që abuzojnë më shumë me ekonominë. Duke marë flamurin e këtij shqetësimi, ekonomistët liberalë kanë vënë në lëvizje gjithë ushtrinë e pareve, që ankohet për paratë që po ikin pa kthim. Ata e dinë që nuk është problemi të ekonomia, ashtu si ishte deri më sot. Virusi që se shohim për fat të mirë na ka bërë të shohim të vërtetën me lupën më të madhe që ka njeriu, frikën.

Frika për jetën na ka mbyllur brenda bane-save, ku me alkohol e sapun po luftojmë për jetën. Me kaq kemi kuptuar që na duhet sapun, ujë, alkohol. Më pas kuptuam se na duhej të ushqeheshim. Duhet ushqimet patjetër. Po ku mbillen fasulet, nga vijnë pulat dhe pilafi?

Se dimë, se ekonomitë e botës janë zhytur në shërbime, sidomos ato të lluksit. Dimë, Iphone, Steve Jobs, dimë Microsoftin, Bill Gates, dime Facebookun, po s’dimë kush na jep bukën e përditshme; as nuk na shkon në mendje të interesohemi ku prodhohet mielli dhe si e ka emrin shitësi i dyqanit aty poshtë. Heronjtë tanë janë virtual, se jemi sajesa të botës së re.

Nëse do të bënim një eksperiment me veten, nëse bota do të shkojë vërtetë në zgrip nga mungesa e vaksinës që do na shpëtonë botën siç e njihnim, nëse kemi ushqim, sapun, ujë dhe alkohol, në fund të kësaj situatë do të jemi të gjithë mirë e bukur.



Qytetari evropian dhe kur ishte i majtë në thelb, di se ishte i privilegjuar, ndaj heshti kur bota mund të ndryshohej. Thellë brenda vetes e ka ndjerë se do vinte një dënim. Sot ironia është se vendet me ekonominë më të fortë, nuk po i mbrojnë dot qytetarët e tyre nga humbja e jetës.

Nëse nga shtëpitë do të dilnin, prodhuesit e shampanjës, makinave ferrari, celularëve të shtrenjtë, punonjësit e bursave, drejtorët e bankave, analistët e tv, bossi i Twitterit; e nëse do të shikonim Instagram 24 orë në ditë Kardashian me motrat yje, asnjë për be s’do dilte gjallë (dhe nuk do të ishte turpi i vetëprekjes).

Për hir të së vërtetës, ankthin për të dalë nga shtëpitë nuk e kanë fshatarët që mbjellin e mbarshojnë bagëti. Punëtorët e vërtetë. Ata dhe pa masa sigurie janë në një largësi sanitare që krijon çdokush atje ku jeta vazhdon. Qytetet e vogla dhe fshatrat ku njerëzit njihen me emër dhe jo me pasworde e kode rrjetesh josociale.

Megjithatë jam i bindur se të gjithë do detyrohemi të dalim nga shtëpitë tona. Fansat e Kapitalizmit kanë çdo mjet për të na bindur për të dalë për të punuar. Përndryshe zbulohet që jetojmë në një matrix të panevojshëm, ku paguajmë qimet e kokës për ta parë Cristiano Ronaldon dhe nuk paguajmë as dorëzat për mjekun pa emër, ai që do na luftojë për jetën tonë me Virusin elegant deri në tejdukshmëri. Duhet maska e sistemit, se përndryshe sistemi nuk ka fytyrë.

TË DREJTAT E NJERIUT

Mënyra sesi kapitalizmi megjithë kapital doli faqebardhë nga lufta e ftohtë, ishte se përveç garës ekonomike, i dha rëndësi sa për sy e faqe, të drejtave të njeriut. Një seri ligjesh kjo, që ka një rrugëtim të gjatë në historinë e njeriut, që nga habeas corpus, e deri në ditët tona; ku me pak mundim e logjikë kemi kuptuar se dhe e drejta e shprehjes, prona, apo dhe siguria që ligjet janë këto që janë, dhe s’mund të dënohesh pa arsye, janë thelbësore për njeriun. Por maska ka rënë pas virusit. Jeta e njeriut nuk është aq e rëndësishme sa të na cënojë ritmin e jetës. Duam të vrapojmë në metro dhe të festojmë egërsisht në Instagram. Duhet të dalim, fundja vetëm pleq po vdesin. Harrojmë se “pleqtë” janë ata që krijuan kushtet për ekonominë e sotme. Pse po e tradhëton veten ideja e vetme ekonomikisht funksionale, siç e quajnë profesorët e ekonomisë liberale. Pse prova e vetme që kapitalizmi ishte fitues në garën e çmendur që sa kaluam me luftën e ftohtë, nuk ishin sipas tyre armatimet, as spiunët, por pikërisht mirëqenia e qytetarëve perëndimorë. Si ka mundësi që pikërisht siguria që banesa jote s’do të prekej, mendimi yt publik do të respektohej tani po zëvendësohet me gijotina masive për njerëzit 70 vjeç e sipër. Pse dukej sikur pasja e internetit të shpejtë, është më domosdoshmëri se jeta e qytetarëve. Pse ky konsensus në masë? Apo me frikshëm besimi se gjithçka po luhet për të kursyer pensione? Dramë që ushqehet nga thashetheme të dëshpëruara. Po këtu jemi futur të zona gri e teorive të konspiracionit që ja vlejnë të jenë sektor më vete.

TEORITË E KONSPIRACIONIT

Dy janë arsyt sepse teoritë e konspiracionit po gjejnë gjithmonë e më shumë mbështetës në botën perëndimore. E para se e dinë që qeveritë e tyre do bënin pakt dhe me djallin për të ndejtur në pushtet sa më gjatë. Se sistemi ku jetojnë e ka humbur dëshirën për të luajtur demokracish. Dhe e dyta, se me kalimin e kohës është krijuar besimi që po ta kenë njohurinë sa më shumë njerëz, kjo do pengojë vendimarrësit anonimë që të vazhdonin përpara më planet ogurzeza. Ndoshta dhe një arsye e tretë, se këto teori shtojnë klikimet në faqet informative, por kjo është me pak e rëndësishmja.

Qytetarët, dhe ata perëndimorë, e dinë tanimë se ligji nuk është i barabartë për të gjithë. Dëshmitarë pasivë të trajtimit të emigrantëve, nuk

mund të hiqen si të paditur. Mjaft për ligjin e barabartë, për t’u kthyer i pabarabartë ishte dhe ngjyra e lekurës, ajo e pasaportës, firma e pantallonave e me radhë. Qytetarët e perëndimit janë të ndërgjegjshëm se qytetërimi i tyre është shumë shpesh një fasadë që në fillim shërbeu për ta vrarë “komunizmin” e më pas për justifikuar luftën për fitim me çdo mjet e pa kushte. Me makiazhin e perëndimit, me bukrinë e palateve, me ritmin në dukje rebel të muzikës rock, kapitalizmi u mbështoll e transformua si në përrallën e kësulkuqes, në fytyrën gjysheje, që pavarërisht veshëve të mëdhenj, nuk dëgjon-te dhimbjet e atyre që nuk ishin ujku në përrallë. Me fytyrën e gjyshes së dashur kapitalizmi eksportoi kapitalizëm në formën e petullave (kupto demokraci) kudo ku njerëzit e meritonin të ishin të mbytur me petulla dhe celularë.

Qytetari evropian dhe kur ishte i majtë në thelb, di se ishte i privilegjuar, ndaj heshti kur bota mund të ndryshohej. Thellë brenda vetes e ka ndjerë se do vinte një dënim. Sot ironia është se vendet me ekonominë më të fortë, nuk po i mbrojnë dot qytetarët e tyre nga humbja e jetës. Justifikimi është absurd, i rastësishëm dhe shkencërisht jo e qartë nëse do të jetë kështu. Po vdesin vetem “pleqtë”. Ata që patën jetën më të mirë në thelb.

Kapitalizmi do të mbijetojë, se kapitalizmi është si Sfinks dhe do rilind nga krizat e veta.

Jam i sigurt që Kapitalizmi do realizojë atë që thashethemet konspirative imagjinojnë. Gjermania dhe Franca do të blejnë “ekonominë” italiane dhe atë spanjolle, pikërisht siç ndodhi me Greqinë (Ju kujtohet Varufakis shpresoj). Askush s’do mërzhitet dhe nëse Kina urtë e butë, do mari copa nga tortat e shteteve të sëmura. Jo se është konspiracion, por se i tillë është ky sistem. Më i forti merr gjithçka.

Ekonomistët e djathtë që do kenë më shumë zë, për të justifikuar çdo dramë të re. Ata do kenë zë, se ishin të parët që na thanë se ekonomia e tharrësve të flokëve ra pikatë se berberët nuk dolën në punë. Ekonomistët liberalë do kenë më shumë zë, se do duhet të sulmojnë qeveritë e majta, që nuk qenë të afta të firmosur në masë genocidin senil, duke penguar tregtinë e shampanjës dhe maskave më gurë të çmuar.

Në fund, konspiracioni do shmangë fajtorët e vërtetë. Askush s’do merret me sistemin, por do fajësojë çifutët anonimë që drejtojnë botën dhe që s’dimë si t’i gjejmë; kështu që për qetësim do mallkojmë lakuriqin që nxori për pak kohë lakuriq sistemin që vret vërtetë.

KOMENT

Që tani!

Kriza e koronavirusit mund të përbëjë një ripërsëritje e përgjithshme që parashikon shpërbërjen e strehave të fundit të rezistencës ndaj kapitalizmit digjital dhe ardhjen e një shoqërie pa kontakte. Përpos... Nëse zërat, veprimet, partitë, popujt, shtetet e prishin këtë skenar të shkruar paraprakisht.

NGA SERGE HALIMI

A do të fillojë gjithçka përsëri si më parë sapo të tejkalohet kjo tragjedi? Në tridhjetë vitet e fundit, çdo krizë e ka ushqyer një pritje të paarsyeshme për një kthim te arsyeya, vetëdija dhe ndalesa. Besuam në izolimin dhe pastaj në kthimin e një dinamike socio-politike, ku secili do t'i kishte matur më në fund, rrugët pa krye dhe kërcënimet. Rrënia e brezës e vitit 1987 ndikoi në rritjen e privatizimeve. Krizat financiare të 1997 dhe 2007-2008 në shkundjen e globalizimit të lumtur. Por, kjo nuk ndodhi.

Sulmet e 11 shtatorit 2001 provokuan mendime kritike mbi krenarinë amerikane dhe pyetje të shkreta të tipit: "Pse na urrejnë?". Kjo nuk zgjati po ashtu. Sepse, edhe kur shpie në drejtimin e duhur, lëvizja e ideve nuk është kurrë e mjaftueshme për t'i prishur ligësitë. Duarte duhen përfshirë gjithnjë.

Dhe atëherë është më mirë të mos varesh nga duart e qeveritarëve përgjegjës për fatkeqësinë, edhe nëse këta piromanë dijnë të simulojnë, të ndezin zjarrin, të pretendojnë se kanë ndryshuar. Sidomos kur jeta e tyre është në rrezik, sikurse tonat.

Shumica prej nesh nuk kanë përjetuar luftë të drejtpërdrejtë, grushtshet ushtarak ose orë policore. Sidoqoftë, në fund të marsit, gati tre miliardë banorë ishin izoluar tashmë, shpesh në kushte të rënda; shumica e tyre nuk ishin shkrimtarë që vëzhgonin lulët rreth shtëpisë së tyre për relaksim në fundjavë. Çfarëdo që do të ndodhë në javët e ardhshme, kriza e koronavirusit është ankthi i parë global i jetës sonë. Ajo nuk harrohet. Politikanët detyrohen ta marrin parasysh. Të paktën pjesërisht.

Prandaj, Bashkimi Evropian sapo ka njoftuar «pezullimin e përgjithshëm» të rregullave të tij buxhetore; Presidenti Emmanuel Macron shtyn një reformë pensionale që ka penalizuar punonjësit e spitalit; Kongresi i Shteteve të Bashkuara ndanë një çek prej 1.200 dollarësh për shumicën e amerikanëve. Por dikur, pak më shumë se dhjetë vjet më parë, për ta shpëtuar sistemin e tyre në ankth, liberalët kishin pranuar një rritje spektakolare të borxhit, një ribalanc buxhetor, shtetëzimin e bankave, restaurimin e pjesshëm të kontrollit të kapitalit. Pastaj, shtrëngesat

(austeriteti) i lejoi ta rimerrnin atë që e kishin lëshuar në një gjendje të shpëtimt. E të bëjnë edhe disa hapa 'përparues': punëtorët do të punonin më shumë dhe më gjatë në kushte të pasigurisë së shtuar; «investitorët» dhe rentierët do të paguanin më pak tatime.

Grekët paguajtën çmimin më të madh të kësaj përmbysje kur spitalët e tyre publike, në ankth financiar dhe pa ilaçe, u përballën me kthimin e sëmundjeve për të cilat mendohej se ishin zhdukur.

Kështu, ajo që fillimisht dukej si një rrugë mëndafshi mund të shpie në një «strategji shoku». Më 2001, një orë pas sulmit kundër Qendrës Botërore të Tregtisë, këshilltarja e një ministre britanike ia kishte dërguar këtë mesazh zyrtarëve në ministrinë e saj: «Kjo është një ditë shumë e mirë për t'i sjellur dhe vendosur më lehtësisht të gjitha masat që duhet t'i ndërmarrim.» Ajo nuk mendonte domosdoshmërisht për kufizimet e vazhdueshme që do të vendoseshin mbi liritë publike, me pretekstin e luftës kundër terrorizmit, aq më pak luftën në Irak dhe fatkeqësitë e panumërta që do të shkaktonin ky vendim anglo-amerikan.

Por njëzet vjet më vonë, nuk është e nevojshme të jesh poet apo profet për ta imagjinuar «strategjinë e shokut» që po merr formë me masat: «Qëndroni në shtëpi» dhe «distancohuni». I tërë shoqërizimi jonë rrezikon të destabilizohet nga digjitalizimi i përshpejtuar i shoqërive tona. Urgjenca shëndetësore do ta bëjë atë edhe më të ngutshme, apo plotësisht të vjetëruar. Pikëpyetja është nëse është ende e mundur të jetosh pa Internet. Gjithkush tashmë duhet të ketë dokumente identiteti me vete. Së shpejti, një telefon celular jo vetëm që do të jetë i dobishëm, por do të kërkohet për qëllime kontrolli. Dhe, meqë monedhat dhe kartëmonedhat janë një burim i mundshëm i kontaminimit, kartat bankare të cilat janë bërë një garanci e shëndetit publik, do të lejojnë që secila blerje të regjistrohet dhe të arkivohet. «Kredia sociale» e stilit kinez ose «kapitalizmi mbikëqyrës», tërheqja historike në të drejtën e patjetërsueshme për të mos lënë gjurmë kur nuk thyejmë asnjë ligj, përbrendësohet në mendjet tona dhe në jetën tonë, pa hasur ndonjë reagim tjetër se një mahnitje e papjekur.



Secili e di tashmë koston e të besuarit në zinxhirët e furnizimit të shtrira në të gjithë botën dhe të veprosh pa rezerva me kujdesin për të furnizuar një vend në shqetësim me miliona maska shëndetësore dhe farmaceutike, nga të cilat varet jeta e pacientëve, stafit spitalor, arkëtarëve etj.

Qysh para koronavirusit ishte bërë e pamundur të udhëtosh me tren pa e zbuluar statusin tënd civil; pa e përdorur llogarinë tënde bankare në internet, që nënkupton zbulimin e numrit tënd të telefonit tuaj celular. Udhëtimi garantonte që po xhirohesh. Me krizën shëndetësore, ndërmerret një hap i ri. Në Paris, dronët vëzhgojnë zonat e ndaluara; në Korenë e Jugut, sensorët paralajmërojnë autoritetet kur temperatura e një banori paraqet një rrezik për komunitetin; në Poloni, banorët

duhet të zgjedhin midis vendosjes së një aplikacionit të vërtetimit të izolimit në celularët e tyre dhe vizitave të shumta të policisë në shtëpitë e tyre. Në kohë katastrofe, masa të tilla vëzhgimi janë të mirëpritura. Por, ato mbijetojnë edhe pas urgjencave.

Trazirat ekonomike që po marrin formë konsolidojnë gjithashtu një univers ku liritë po ngushtohen. Për të shmangur kontaminimin, miliona biznese ushqimore, kafiteri, kine-ma, librari janë mbyllur në të gjithë botën. Ato nuk kanë shërbime të sjelljes së produkteve në shtëpi dhe nuk kanë shansin të shesin produkte virtualisht. Pas krizës, sa prej tyre do të rihapen dhe në çfarë gjendje? Por, nga ana tjetër, biznesi do të jetë më i ndritshëm për gjigandët e shpërndarjes, si Amazon i cili po përgatitet të krijojë qindra mijëra vende pune për shoferë etj, apo edhe për Walmart i cili paralajmëron rekrutimin shtesë të 150.000 «bashkëpunëtorëve». Dhe kush më mirë se ata i njohin shijet dhe përzgjedhjet tona? Në këtë kuptim, kriza e koronavirusit mund të përbëjë një ripërsëritje e përgjithshme që parashikon shpërbërjen e strehave të fundit të rezistencës ndaj kapitalizmit digjital dhe ardhjen e një shoqërie pa kontakte.

Përpos... Nëse zërat, veprimet, partitë, popujt, shtetet e prishin këtë skenar të shkruar paraprakisht. E zakonisht është të dëgjosh: «Politika nuk është punë e imja». Deri në ditën kur të gjithë e kuptojnë se ishin përzgjedhjet politike që i detyruan mjekët të përzgjedhnin pacientët që do të përpiqen të shpëtojnë dhe ata që duhet flijuar. Ja pra, këtu është pika. Çështja është edhe më e vërtetë në vendet e Evropës Qendrore, Ballkanit dhe Afrikës, të cilët për vite me radhë kanë parë punonjësit e tyre mjekësor të emigrojnë në rajone më pak të kërcënuar ose me punë më fitimprurëse. Përsëri, këto nuk ishin përzgjedhje të diktuar nga ligjet e

natyrës. Sot, pa dyshim, ne i kuptojmë më mirë. Izolimi në shtëpi është gjithashtu një kohë kur të gjithë ndalen dhe mendojnë...

Me shqetësimin për të vepruar. Që tani. Sepse, ndryshe nga ajo që sugjeroi Presidenti francez, nuk është më çështje e «të menduarit mbi modelin e zhvillimit në të cilin është përfshirë bota jonë». Përgjigja dihet: duhet ta ndryshojmë. Që tani. Dhe meqenëse «delegimi i mbrojtjes sonë tek të tjerët është marrëzi», atëherë le të ndalemi të jemi të varur nga varësitë strategjike për ta ruajtur një «treg të lirë dhe të ç'rregulluar». Macron paralajmëroi «vendime shkëputjeje». Por ai nuk do t'i marrë kurrë ato vendime që imponohen. Jo vetëm pezullim i përkohshëm, por kundërshtim përfundimtar i traktateve evropiane dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë, që flijuan sovranitetet kombëtare dhe ngriten konkurrencën në vlerë absolute. Që tani.

Secili e di tashmë koston e të besuarit në zinxhirët e furnizimit të shtrira në të gjithë botën dhe të veprosh pa rezerva me kujdesin për të furnizuar një vend në shqetësim me miliona maska shëndetësore dhe farmaceutike, nga të cilat varet jeta e pacientëve, stafit spitalor, arkëtarëve etj.

Të gjithë gjithashtu e dinë se çfarë i kushtojnë planetit shpyllëzimet, delokalizimet, grumbullimi i mbeturinave, lëvizjet e përhershme. Çdo vit, Parisi mirëpret tridhjetë e tetë milion turistë, më shumë se shtatëmbëdhjetë herë nga numri i banorëve të tij dhe komuna është e kënaqur...

Tashmë, proteksionizmi, ekologjia, drejtësia sociale dhe shëndeti janë të ndërlidhura. Ato përbëjnë elementët kryesorë të një koalicioni politik anti-kapitalist mjaft të fuqishëm për të imponuar, Që tani, një program shkëputjeje.

MËSIMET NGA KONTROLLI I PANDEMISË NË SHQIPËRI DHE EUROPËN JUGLINDORE

Koha për rihapje

Çfarë e dallon Europën Juglindore nga Perëndimi, madje edhe nga Gjermania e konsideruar një histori suksesi? Debatimi për vaksinën e vjetër të tuberkulozit dhe niveli i riskut sot nga Covid-19

NGA ALBAN YLLI

Shqipëria është në javën e shtatë të dokumentimit të pandemisë nga Covid 19, e cila me shumë gjasë u importua nga Italia e Veriut në dy javët e fundit të shkurtit. Të dhënat dëshmojnë se përhapja e infeksionit është frenuar në mënyrë efektive; kurba epidemike është e sheshtë, numri i rasteve në nevojë për kujdes nuk e kërcënoi sistemin shëndetësor dhe mortaliteti është mbajtur në nivele të ulëta. Janë regjistruar zyrtarisht vetëm 26 vdekje nga Covid 19 në Shqipëri dhe niveli nuk është vetëm shumë më i ulët se në vendet e Europës Perëndimore, por edhe se në disa vende të Europës Juglindore përfshirë, Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Rumaninë apo edhe Turqinë më në Lindje. Edhe ritmet e shtimit të rasteve të reja ngelen më të ulëta se në disa nga këto vende. Prej një jave, numri i rasteve të shëruara e ka kaluar numrin e rasteve aktive të konfirmuara dhe kjo prirje vazhdon. Megjithatë pandemia ka prekur në përmasa të ndryshme shumicën e qyteteve të Shqipërisë, ka ende

një numër rajonesh pa asnjë rast të konfirmuar. Gjithashtu, vatrat e infeksionit të identifikuar kohët e fundit në Shkodër dhe Krujë duket të jenë mbajtur ende përgjithësisht të izoluara.

VEÇORITË E SHQIPERISË DHE VENDEVE TË TJERA TË EUROPËS JUGLINDORE

Ka një dallim të fortë mes treguesve të pandemisë në vendet e Europës Juglindore dhe atyre të vendeve të Europës Perëndimore. Risku për t'u infektuar, i bazuar në numrin e rasteve të diagnostikuara në popullatë, ngelet përgjithësisht disa herë më i ulët, ndërsa risku për të vdekur nga Covid 19 mund të arrijë në dhjetra herë më i ulët.

Çfarë e dallon Shqipërinë nga Italia, Britania e Madhe, e pse jo, edhe



nga Gjermania e konsideruar një histori suksesi, në kontrollin e kësaj pandemie? Përgjigja e kësaj pyetje duket se do të ngelet ende e debatueshme, por megjithatë disa mësimet mund të nxirren përmes një observimi

sistematik të të gjithë faktorëve të cilët me gjasë ndikojnë. Korrelacioni gjeografik mund të japë një ndihmë për të identifikuar pranimin e faktorëve të ndryshëm dhe për të hedhur hipoteza bazuar mbi diferencat apo

asociimet e vërejtura, gjithmonë pa vërtetuar dot shkakësinë.

Në këtë analizë kemi përfshirë Shqipërinë, vendet e Europës Juglindore (pa marrë për sipër të bëjmë një perkufizim politik të këtij termi) dhe vendet më përfaqësuese të pandemisë në Europën Perëndimore (sërish perkufizimin politik të këtij termi e kemi konsideruar si të mirëqenë). Kemi parë gjithashtu edhe parametrat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si vendi me numrin më të madh të rasteve dhe vdekjeve nga Covid 19 sot në botë.

Në vendet e Europës Perëndimore dhe SHBA rastet e para të konfirmuara i përkasin të gjitha janarit. Nuk mund ta dijmë me saktësi se çfarë ka ndodhur me qarkullimin e fshehtë të virusit përmes personave asimptomatikë apo me simptoma të lehta, por mund të vlerësojmë se ky qarkullim kish krijuar ndërkohë një rezervuar të madh infektimi, kur brenda pak ditëve në gjysmën e dytë të shkurtit, në Lombardi u identifikuan menjëherë qindra raste. Asnjë vend në Perëndim nuk ndërmori masa drastike në nivel kombëtar brenda Shkurtit. Vetëm në 11 Mars, pas dështimit të karantinës së pjesshme të disa qytezave në Veri, dhe pas rreth 40 ditëve nga 'rastet 0', Italia aplikoi masat e para drastike në shkallë të gjerë. Britania e Madhe priti edhe dy javë të tjera, ndërsa SHBA edhe rreth 1 muaj. Megjithatë, është e vështirë të gjykohej sot, nëse masat drastike do të mund të merreshin më parë, kur ende nuk kishte kërcënim të dukshëm e të dokumentuar qartë për shoqëritë perëndimore.

Nga tabela më poshtë vërehet se në të gjitha vendet e Europës Juglindore rastet e para të konfirmuara i përkasin fundit të shkurtit dhe fillimit të marsit, pra me disa javë distancë krahasuar me Europën Perëndimore. Virusi, i ashtuquajtur SARS-Cov2, ka pasur më pak kohë për të qarkulluar

Tabela 1 - Dallimet mes vendeve të Europës Juglindore dhe Europës Perëndimore. Niveli i riskut dhe faktorët e mundshëm me ndikim

Vendet	Pasojat ne shendet nga Covid 19		Faktoret me ndikim			
	Raste/1 milion	Vdekje/1 milion	Rasti i pare	Jetegjatesia mesatare	Vaksinimi me BCG	Dendesia e popullsisë
Shqipëria	203	9	8-Mar	79	Po	103
Kosova	332	9	13-Mar	72	Po	166
Mali i Zi	498	8	16-Mar	77	Po	45
Maqedonia e Veriut	588	26	25-Feb	76	Po	81
Bosnja Hercegovina	399	15	4-Mar	79	Po	64
Serbia	759	14	5-Mar	77	Po	99
Turqia	1,079	25	9-Mar	79	Po	108
Greqia	215	11	25-Feb	83	Po	79
Bullgaria	139	6	6-Mar	76	Po	63
Rumania	465	25	25-Feb	77	Po	81
Kroacia	458	11	24-Feb	79	Po	73
Slovenia	642	37	3-Mar	82	Me pare	103
Spanja	4,282	446	30-Jan	84	Me pare	92
Italia	2,997	399	29-Jan	84	Jo	201
Franca	2,380	310	23-Jan	83	Me pare	118
Britania e Madhe	1,838	243	31-Jan	82	Me pare	280
Gjermania	1,755	58	26-Jan	82	Me pare	235
SHBA	2,396	128	20-Jan	79	Jo	35
Bota	320	21.9	10-Jan	73		

Tabela 2 - Një model i përparimit të kujdesshëm në fazat e rihapjes dhe mekanizmi i monitorimit

Risk i ulët	Risk i mesëm	Risk i lartë
- Nën 15 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për ulje, për dy javet e fundit Dhe/ose - Më pak se 100 pacientë të shtruar me covid-19 gjithsej Dhe/ose - Më pak se 10 pacientë në reanimacion gjithsej	15-30 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për rritje, për dy javet e fundit Dhe/ose 100 – 200 pacientë të shtruar me covid-19 gjithsej Dhe/ose 10 - 20 pacientë në reanimacion gjithsej	- Mbi 30 raste të reja të diagnostikuara në ditë (e llogaritur mbi mesataren javore) me prirje për rritje, për dy javet e fundit Dhe/ose - Mbi 200 pacientë të shtruar me covid 19 gjithsej Dhe/ose - Mbi 20 pacientë në reanimacion gjithsej
Vijohet me fazat e strategjisë së rihapjes	Frenohet përparimi në fazën e dytë të rihapjes	Kthehemi menjëherë te masat drastike

në mënyrë të fshehtë dhe për ta krijuar një rezervuar të madh. Gjithashtu vendimmarrja lidhur me kufizimin e lirive të lëvizjes është bërë më e lehtë për autoritetet ndërkohë që masmediat po pasqyrojnë potencialin shkatërrues të pandemisë në Itali. A është e mundur që ky të jetë shpjegimi i vetëm? Duket se jo.

Kroacia dhe Greqia i kanë regjistruar rastet e tyre të para me herët se Turqia apo Sllovenia, e megjithatë kanë mbajtur parametra më të ulët të mortalitetit. Nga ana tjetër Portugalia (nuk është paraqitur në tabelë) e ka regjistruar rastin e parë në 2 Mars e megjithatë e ka nivelin e mortalitetit (72/1 milion) 2.5 herë më të lartë se Maqedonia e Veriut. Koha e ndërhyrjes dhe intensiteti i masave është i rëndësishëm, por me siguri janë në lojë edhe faktorë të tjerë.

Risku për të vdekur nga Covid 19 rritet me shpejtësi në të moshuarit për të arritur kulmin tek personat mbi 80 vjeç. Proporcioni i të moshuarve mbi 65 vjeç dhe sidomos mbi 80 vjeç në një popullatë duhet të luajë një rol të rëndësishëm në pasojat e pandemisë.

Tabela dëshmon se vendet e Europës Juglindore kanë një moshë mesatare përgjithësisht më të ulët se vendet e Europës Perëndimore (por jo SHBA). Në Itali, Spanjë, Francë dhe Britaninë e Madhe (por jo në Gjermani) një proporcion i madh i vdekjeve ka ndodhur në institucionet rezidenciale (azilet). Kjo dukuri nuk është vërejtur në Shqipëri e vende të tjera të Europës Juglindore. Megjithatë, ndërsa jetëgjatësia mesatare është shumë e lartë në Greqi e Slloveni, kjo nuk duket të ketë sjellë një risk dukshëm më të lartë për të vdekur nga Covid 19 në këto vende.

Programet e vaksinimit të bazur në bacilin e Calmette Guerin (BCG), vaksinën e vjetër kundër tuberkulozit, janë bërë javët e fundit pjesë e debatit shkencor mbi faktorët me ndikim në përhapjen e pandemisë dhe kontrollin e pasojave të saj. Në Europën Juglindore kjo vaksinë është pjesë e programeve kombëtare të vaksinimit të detyrueshëm. Në Itali e SHBA nuk ka qenë ndonjëherë pjesë e programit të vaksinimit, ndërkohë që në shumicën e Europës Perëndimore ka qenë përdorur në forma të kufizuara dhe kategori të caktuara me risk. Sërish është vështirë të arrihet në një konkluzion për lidhjen e vaksinës BCG përderisa të moshuarit e Francës, Spanjës e Britanisë e kanë kryer këtë vaksinë në fëmijërinë e tyre. Gjithashtu, Sicilia, Sardenja dhe provinca të tjera në jug të Italisë e kanë nivelin e mortalitetit shumë më të ulët se provincat në veri, atje ku filloi pandemia, pavarësisht statusit të ngjashëm imunitar.

Për të kuptuar më shumë rreth rolit të kësaj vaccine, do të duhet të presim rezultatet e dy eksperimenteve klinike që janë ende në proces në Holandë e Gjermani. Së fundi, mund të thuhet se programet e shëndetit publik dhe vaksinimit të vendeve të Europës Juglindore, krahasimisht më tradicionale se ato të Europës Perëndimore, do të meritojnë më tepër vëmendje dhe respekt pas pandemisë.

Çdo vendim mbi heqjen e disa kufizimeve duhet të ndiqet nga rreth dy javë monitorim. Një sistem alarmi duhet të aplikohet në mënyrë që ‘normalizimi’ të frenohet nëse treguesit epidemiologjikë kalojnë disa kufij të caktuar. Skema e paraqitur më poshtë është një model i sistemit të ‘frenimit’ që do të mund të lejonte një përparim të sigurtë të shoqërisë drejt normalizimit. Është gjithsesi e nevojshme që ky model të shoqërohet edhe nga tregues të tjerë të lidhur me monitorimin e vatrave, rasteve te dyshuara dhe prirjeve rajonale.

Dendësia e popullsisë (rezidentë / km²) dhe shkalla e urbanizimit është një faktor tjetër i përfshirë në këtë korrelacion gjeografik dhe që mund të jetë përgjegjës për një pjesë të intensitetit të qarkullimit të virusit dhe riskut më të lartë në disa popullata. Por edhe siç duket nga tabela, kjo analizë duhet të vlejë për zonat me dendësi të lartë urbane brenda një vendi, më shumë sesa në krahasimin mes vendeve të ndryshme.

KOHA DHE INTENSITETI I MASAVE TË MARRA

Masat efektive mbi distancimin social, të ndërmarra në kohën e duhur, duket se janë arsyeja kryesore e kontrollit më të mirë të pandemisë. Faktorët e tjerë të diskutuar këtu (apo edhe faktorë të tjerë që nuk janë përfshirë në këtë analizë) kanë pasur patjetër një rol në diferencat e mëdha Lindje-Perëndim, por përgjithësisht ato nuk janë nën kontrollin tonë. Për këtë arsye do të ishte me vlerë një kronologji e shkurtër mbi masat në Shqipëri dhe kohën kur ato janë marrë, në raport me qarkullimin e Covid 19 në vend. Kjo mund të shërbente për analiza apo debate të tjera në të ardhmen mbi ngjashmërinë apo dallimet mes vendeve të ndryshme, lidhur me vendimmarrjen në shëndet publik dhe politikën në përgjithësi.

Shqipëria ka trashëguar strukturë përgjithësisht të forta të shëndetit publik, ndërkohë që një ligj i ri i kontrollit të sëmundjeve infektive u miratua nga parlamenti vetëm 4 vite më parë.

Situata në Lombardi në fund të shkurtit u vëzhgua me shumë kujdes nga kjo anë e Adriatikut dhe u nxorën mësimet mbi rrezikun që krijonte Covid 19 dhe nevojën e masave të forta e të shpejta. Me konfirmimin e dy rasteve të para të dielën e 8 Marsit, qeveria reagoi shpejt në vendimmarrje; në 9 Mars u mbyllën të gjitha shkollat në të gjithë territorin e vendit. Brenda dy ditëve të gjitha fluturimet nga Italia u pezulluan dhe në 14-15 Mars të gjithë kufijtë u mbyllën. Vetë-karantinimi u kërkua për të gjithë ata që kishin hyrë në javën e parë të marsit.

Disa shërbime dhe aktivitete u mbyllën që në datën 10 Mars. Në 15 Mars me një vendim të qeverisë, rreth 50 kategori biznesesh dhe

aktivitetesh të tjera u mbyllën apo pezulluan.

Nga 12 Marsi deri në 18 Mars, gjithë lëvizjet jo të domosdoshme mes qyteteve u kufizuan apo u ndaluan plotësisht. Në javën e dytë të marsit qeveria dekretoi kufizimet e para lidhur me lëvizjen nga shtëpia. Nga java e tretë e marsit të gjitha aktivitetet jetike u kufizuan në fashën orare 05:00-13:00. Në pjesën më të madhe të fundjavave u vendos shtetërrethim i plotë dhe strikt.

Nuk ka dokumente të qarta për këtë, por besohet se masat drastike janë zbatuar me korrektësi nga shumica dërrmuese e publikut. Gjithashtu, të katërt komunitetet fetare mbështetën masat e marra nga autoritet dhe pezulluan ceremonitë, apo i kryen ato pa pjesëmarrje të besimtarëve.

Edhe në shërbimet shëndetësore nga 15 marsi u aplikuan masa të rrepta për të minimizuar kontaktet me personelin shëndetësor; ndalim i vizitave nga familjarë, përdorim i telefonit për kërkimin e ndihmës mjekësore etj. Kirurgjitë e planifikuara u shtynë dhe spitalet private u përfshinë në rregullat e emergjencës. Nga 10 Marsi, rregulla strikte u vendosën në institucionet rezidenciale për shmangien e kontaktit me të moshuarit atje.

Në 24 Mars qeveria e ngriti nivelin e emergjencës në nivelin më të lartë të mundshëm, atë të fatkeqësisë natyrore.

Për të mos u harruar se në Shqipëri emergjenca e Covid 19 u mbivendos me emergjencën e tërmetit të nëntorit i cili la pa strehë pothuaj 20 mijë qytetarë.

RUAJTJA E PËRFITIMEVE NË FAZËN E ‘NORMALIZIMIT’

Vërtet shëndeti publik mund të brohorasë për sukses për atë çka është arritur, por ekonomia në vend, rajon e në mbarë botën ka marrë një goditje të fortë. Qeveria ka pranuar një humbje prej rreth gjysmë miliard euro nga beteja me pandeminë. Duket se është koha për një hapje të kujdesshme. Është e nevojshme një strategji e cila do të drejtonte vendin drejt normalizimit në disa faza. Kjo strategji duhet të sigurojë që hapat në javët e muajt në

vijim janë graduale, të kujdesshëm, të shoqëruar me masa të tjera dhe monitorim intensive, ndërkohë që sistemi shëndetësor vijon të mbështetet.

Çdo vendim mbi heqjen e disa kufizimeve duhet të ndiqet nga rreth dy javë monitorim. Një sistem alarmi duhet të aplikohet në mënyrë që ‘normalizimi’ të frenohet nëse treguesit epidemiologjikë kalojnë disa kufij të caktuar. Skema e paraqitur më poshtë është një model i sistemit të ‘frenimit’ që do të mund të lejonte një përparim të sigurtë të shoqërisë drejt normalizimit. Është gjithsesi e nevojshme që ky model të shoqërohet edhe nga tregues të tjerë të lidhur me monitorimin e vatrave, rasteve te dyshuara dhe prirjeve rajonale.

NJË MODEL I PËRPARIMIT TË KUJDESSHËM NË FAZAT E RIHAPJES DHE MEKANIZMI I MONITORIMIT

Normalizimi gradual duhet të shoqërohet me masa të veçanta sanitare për t’u zbatuar nga bizneset, shërbimet, tregtia, transporti, arsimi dhe aktivitetet e tjera të lejuara. Janë propozuar ndërkohë një numër protokolleesh për grupe të veçanta aktiviteteesh me synim ruajtjen e distancimit fizik dhe minimizimin e riskut të infektimit. (Tabela 2)

Risku shëndetësor do të duhet ende të dominojë mbi arsyen ekonomike. Aktivitetet dhe bizneset me riskun më të ulët të shëndetit publik do të duhet të normalizohen të parat.

Sistemi shëndetësor duhet të vijojë të përgatitet për të gjithë skenarët e mundshëm. Kapacitetet e shëndetit publik dhe epidemiologjisë për gjurmim dhe testim duhet të vijnë në forcën.

Kategoritë më vulnerable dhe grupet e popullatës në risk duhet të vijnë në mbrohen në mënyrë të kujdesshme gjatë gjithë fazave të normalizimit. Masat për mbrojtjen e të moshuarve duhet të mbahen në fuqi si lidhur me institucionet rezidenciale ashtu edhe me rekomandimet e qëndrimit në shtëpi.

(Autori është Pedagog në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë dhe Shef Departamenti në Institutin e Shëndetit Publik)

KUR GJERMANIA KËRKONTE TA KTHENTE SHKËLQIMIN E SAJ

Marrëdhëniet e çuditshme gjermano-izraelite

Pas Luftës së Dytë Botërore, Gjermania Perëndimore që ishte duke u rindërtuar u përpoq të pastrohej nga e kaluara duke e mbështetur ndërtimin e shtetit të Izraelit. Kështu, Boni zyrtar luajti një rol po aq të rëndësishëm sa edhe të panjohur në Lindjen e Afërt. Por, gjatë viteve 1950 dhe 1960, kjo diplomaci në kërkim të mëshirës, nuk pati gjithmonë sukses, në maskimin e shprehjes së një prejardhje të vjetër të gatshme për t'u rishfaqur.

NGA DANIEL MARWECKI*



Në muajin prill të vitit 2018, Parlamenti gjerman u mbledh për ta përkujtuar përvjetorin e shtatëdhjetë të krijimit të shtetit hebre. Gjatë diskutimeve, z.Martin Schulz, duke folur në emër të Partisë Socialdemokrate (SPD) deklaroi: «Duke e mbrojtur Izraelin, ne po mbrohem nga demonët e së kaluarës.1» Zëdhënësi i partisë ekologjike të qendrës së majtë me një fjali e kapi gjithashtu kuintesencën e debatit: «Izraeli ka po aq të drejtë për të ekzistuar sa ne, as më pak dhe as më shumë.»

Kur klasa politike gjermane flet për Izraelin, ajo flet kryesisht për vete. Duke u bazuar në faktin se lidhjet e Gjermanisë me Izraelin formojnë elementin mbi të cilin Gjermania post-naziste bazon identitetin e saj progresiv. Qëndrimi i gjermanëve ndaj Izraelit na mëson shumë më tepër për disponimin e tyre sesa për marrëdhëniet bilaterale, për historinë e këtyre marrëdhënieve dhe përmbytjen e tyre të vërtetë.

Republika Federale e Gjermanisë dhe shteti i Izraelit: dy vende që u krijuan në vazhden e Luftës së Dytë Botërore dhe pas gjenocidit të hebrenjve. Përafërimi i tyre ndodhi me marrëveshjen e riparimeve izraelito-gjermane, të nënshkruar më 10 shtator 1952. Si të shpjegohet kjo lëvizje vetëm disa vjet pasi që Rajhu i Tretë me mbështetjen e një pjese të madhe të popullatës pothuajse shfarosi popullin hebre?

Është e vështirë ta besosh retorikën zyrtare gjermane, e cila insiston në

bazën “morale” të marrëdhënieve me Izraelin. Historianët kanë treguar me shumë raste se në atë kohë ish-zyrtarë nazistë ende mbanin detyra të larta në Gjermaninë e mposhtur, ndërsa shoqëria në përgjithësi përballej me mohimin e barbarisë të cilën e kishte shkaktuar pak kohë më parë.

Ndoshta Konrad Adenauer, kancelari i parë pas luftës dhe simboli i “rilindjes” së vendit të tij, na ndihmon të kuptojmë. Në vitin 1966, dy vjet pas largimit nga pushteti, ai ishte intervistuar në televizionin gjerman në një orë më shumë shikueshmëri. Në atë rast ai shpjegoi se në politikën e tij të dëmshpërblimeve “shlyerja ose riparimi [i krimeve gjermane kundër hebrenjve] ishte kushti sine qua non për ta rifituar statusin ndërkombëtar të vendit”. Pastaj shtoi: “Ende sot, pushteti hebraik nuk duhet të nënvlerësohet, veçanërisht në Amerikë.”

Sipas Adenauerit, dëmshpërblimet kishin të bëjnë më pak me çështje morale sesa me nevojën e kthimit të shkëlqimit të Gjermanisë. Arsyetimi i tij i dytë befason edhe më shumë. Kur thotë “pushteti hebraik”, duke shtuar madje edhe një shprehje demaskuese “ende sot”, Adenauer në fakt përdor një rënd nga temat e antisemitizmit. Politika e tij ndaj Izraelit mbështetej në këto dy shtylla: dëshira për ta rehabilituar Gjermaninë dhe vlerësimi i ekzagjeruar i ndikimit hebraik në opinionin perëndimor.

mirë: prodhimi në sektorët e eksportit u forcua nga riparimet, duke nxitur “mrekullinë ekonomike”.

“Normalizimi” i cili para së gjithash ishte ekonomik, shpejt u përhap në fushën ushtarake. Pas krizës së kanalit të Suezit në vitin 1956 dhe deri në luftën vendimtare të vitit 1967 (lufta gjashtë ditore), Gjermania, së bashku me Francën, u bën mbështetësit kryesor të ushtrisë izraelite. Arkitekti i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit ushtarak me këto dy vende, udhëheqësi izraelit Shimon Peres e përmbledhi mirë situatën: “Shtetet e Bashkuara po na japin para, por jo armë. Franca na dha armë, por jo para. Gjermania e konsideroi si një rast për ta kthyer faqen e regjimit nazist duke na dhënë armë, pa kërkuar asgjë mbrapa.”

Sipas arkivave të Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme, ndihma ushtarake për Izraelin filloi në vitin 1957. Atëherë, ndihma përbëhej kryesisht nga dërgesa me armë të lehta, anije patrullimi dhe programe trajnimi. Kontrata e parë e madhe e armatimit daton nga viti 1962, kur Gjermania furnizoi artileri të rëndë, aeroplana, helikoptera, anija dhe nëndetëse. Në vitin 1964, Uashingtoni e urdhëroi Bonin t'i shtonte në këtë listë 150 tanke Patton në emër të amerikanëve. Për t'u paraqitur si ndërmjetësues neutral në konfliktin arabo-izraelit dhe për të mos ngjallur zemërimin e nacionalistëve arabë, Shtetet e Bashkuara preferuan të mos e armatosin drejtpërdrejt Izraelin,

së paku deri në vitin 1967.

Mbështetja gjermane është jetike. Qysh në vitin 1965, kur sapo i kishte marrë funksionet në ambasadën izraelite në Bon, Asher Ben-Nathan, titullari i parë i këtij funksioni, i tha kancelarit Ludwig Erhard se një konflikt në Lindjen e Mesme “nuk do të zgjasë më shumë se disa ditë. Prandaj Izraeli [duhej] të ishte vazhdimisht në gatishmëri. Ndihma e Gjermanisë [kishte bërë] jashtëzakonisht shumë për zhvillimin e vendit dhe mbështetja e saj ushtarake [ishte] gjithashtu përcaktuese për sigurinë e tij.”

Ky pohim u konfirmua dy vjet më vonë. Lufta arabo-izraelite e vitit 1967 zgjati vetëm gjashtë ditë dhe mbështetja ushtarake gjermane kishte ndikuar në këtë situatë. Dyzet e tetë orë pas përfundimit të konfliktit, ambasadori gjerman në Izrael dërgoi një telegram në Bon, të shkurtër, por kuptimplotë: “Sipas një oficeri të shtabit kryesor, tanket moderne me mburojë të blinduar të përforcuar që u kemi dhënë dëshmuar meritat e tyre në mënyrën më të mirë.”

Vetë rrjedha e kësaj lufte ilustron rëndësinë e përbashkët të Francës dhe Gjermanisë për Izraelin në atë kohë. Derisa aeroplanët ushtarak Mirages français marrin përsipër fushatën ajrore, tanket gjermane dominojnë në luftime tokësore në Egjipt. Përfaqësuesit e shteteve arabe kishin dëgjuar për kontributin e Republikës Federale në përpjekjet e luftës izraelite për të cilin ankoheshin shpesh.

ngjashëm shpërtheu gjatë mbulimit të luftës së vitit 1967 në shtypin gjerman, në veçanti ai i grupit Springer. Fitorja e Izraelit u përshëndet si një “fitore rrufeje” duke u duartrokitur nga gjenerali izraelit Moshe Dayan si një trashëgimtar i denjë i gjeneralit të Wehrmacht-it Erwin Rommel, ndërsa ushtritë e mposhtura arabe ishin objekt i një përcjimit që ngjasonte me triumfalizmin e egër gjerman të një epokeje të kaluar.

Kurioziteti i fundit në këto marrëdhënie bilaterale të çuditshme: opinionet e Rolf Pauls, ambasadori i parë gjerman në Izrael dhe ish-gjenerali i Wehrmacht-it i shpërblyer me ‘kryqin e hekurt’. Në shënimet e tij personale, homologët izraelitë rregullisht asociohen me para dhe pushtet. Në vitin 1965 madje indinjohej nga fakti që izraelitët “flasin për moralitet, por mendojnë vetëm për para”. I bindur se “ndikimi i Izraelit dhe i hebrenjve [ishte] vendimtar në qendrat e mëdha botërore ku formohet opinioni publik”, Pauls konsideron se Gjermania nuk është në gjendje ta ndërpresë furnizimin në Tel Aviv, përndryshe “hebrenjtë [do t'i lëshojnë] qentë, nga Jeruzalemi deri në Londër, përmes New Yorkut”.

Politika izraelite e Republikës Federale është sot temë e debateve, të cilat e prekin moralin për nga natyra. Kështu kritikët parapëlqejnë të tregojnë se Gjermania më shumë po merret me sigurinë e Izraelit sesa me fatin e atyre që u dëbuan nga tokat e tyre me krijimin e këtij shteti. Kjo kritikë megjithatë neglizhon një aspekt themelor: në realitet, ndryshimi i gjermanëve në dobi të Izraelit nuk ka pasur asnjëherë lidhje me moralin.

Në periudhën e pasluftës, ndërsa riparimet dhe armatimet e Gjermanisë e ndihmuan ndërtimin e shtetit izraelit, natyrisht Gjermania ishte e vetëdijshme për ekzistencën e refugjatëve palestinezë. Por në një kohë kur lëvizjet e popullatave ishin të zakonshme në botën e kolonizuar sikurse në Evropë, të paktë ishin zërat për njohjen e mjerimit të një populli i cili nuk kishte mundësi të ndikonte në dëgjimin e zërit të tij.

Brenda qeverisë gjermane, diskutimet në lidhje me ndihmën humanitare për refugjatët palestinezë insistonin në domosdoshmërinë për shtytjen e vullnetit të mirë për shtetet arabe - të cilat dyshonin me të drejtë se Gjermania i kishte siguruar Izraelit shumë më shumë mbështetje sesa e pranonte. Sidoqoftë, udhëheqësit gjermanë vepronin në atë mënyrë që ndihma e tyre humanitare të mos i çonte në një pozitë të “përgjegjësisë indirekte”. Gjermania sot inkurajon vetëvendosjen e popullit palestinez duke e mbrojtur një zgjidhje shtetërore që do të përfshinte Bregun Perëndimor, Gazën dhe Jeruzalemin Lindor, por marrëdhëniet e saj me Izraelin mbeten parësore.

Një pikë e parë kthese në marrëdhëniet midis Gjermanisë dhe Izraelit ka ndodhur pas luftës së vitit 1967, kur u vendos aleanca amerikano-izraelite, duke i lënë Republikës Federale të Gjermanisë vetëm një rol dytësor. Këto lidhje bilaterale më pas evoluuan sipas lëvizjeve të luftës së ftohtë, të integritit evropian dhe të konfliktit izraelito-palestinez, kurse rënia e Murit dhe ribashkimi gjerman përfundimisht iu dha një ndryshim më radikal.

Në emër të amerikanëve

Kaq për motivet gjermane. Por pse shteti i udhëhequr nga David Ben-Gurion, i themeluar menjëherë pas tmerreve të zgjidhjes përfundimtare, e pranoi dorën e përgjakur që ia shtrinte Gjermania perëndimore që sapo e kishte filluar procesin e denazistifikimit? Kur u krijua Izraeli, të mbijetuarit e shfarosjes përfaqësonin një të tretën e popullsisë së Izraelit. Të paktë ishin izraelitët që nuk kishin të vdekur në familjet e tyre ose te të afërmit e tyre. Vendi pothuajse ishte ndërtuar nga refugjatët të traumatizuar të ardhur nga Evropa. Afrimi me Gjermaninë kishte vetëm një arsye: plotësimi i nevojave materiale. Pas luftës së pavarësisë, e shënuar nga eksodi i detyruar i shumicës së popullsisë palestineze, shteti i ri u gjend në një pozitë të brishtë në Lindjen e Afërt. Për më tepër, ai ishte shterrur, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Marrëveshja e vitit 1952 ka qenë traktati i parë i madh për organizimin e pagesës së dëmshpërblimeve gjermane. Megjithatë vendosi bazat e kompensimit individual, i cili do të implemtohej më vonë, kishte të bëjë më saktësisht me dëmshpërblimet që ua kishin borxh shtetit të Izraelit. Republika Federale u angazhua të paguante 3.45 miliardë markash gjermane, me vlerën rreth 7 miliardë euro sot. Dy të tretat e kësaj shume ishin alokuar në formën e mallrave (lëndë e parë, makineri, anije, etj.). Një e treta e shumës totale u përdor për të blerë naftë bruto nga kompanitë britanike. Marrëveshja shënoi kështu fillimin e një programi të industrializimit, furnizimi me karburant i të cilit ishte i garantuar.

Nahum Goldmann, kryetar i atëherëshëm i Kongresit Botëror të Hebrenjve dhe kryenegociator për palën izraelite, e quajti marrëveshjen “një shpëtim në rregull”. Gjermania shpëtoi me pak shpenzime, pasi që shpenzimet vjetore të parashikuara nga traktati kurrë nuk e tejkaluan 0.2% të produktit të brendshëm bruto të saj. Akoma më

Mutacion i çuditshëm

Një tjetër komponentë kruciale e ndihmës gjermane merr formën e një kredie prej 644.8 milion DM. I emëruar me kodin “Operation Business Friend”, ky transakcion kryhet në mënyrë sekrete, sikurse dërgesat e armëve. Në vitin 1965, kur sapo ishin krijuar marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve, kredia u shndërrua në ndihmë zyrtare për zhvillim. Dhjetëra vite më vonë z. Hans Rühle - një ekspert i përhapjes bërthamore i cili kishte pasur poste të larta në Ministrinë gjermane të Mbrojtjes dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) - duke u shprehur në vitin 2015 në faqet e gazetës konservatore pro-izraelite Die Welt pretendoi se paratë u përdorën për ta financuar programin bërthamor izraelit. Duke e pasur parasysh rolin që luajti Republika Federale në konsolidimin e shtetit të Izraelit, teoria është e besueshme, por vështirë mund të verifikohet.

Historia është e çuditshme: marrëdhëniet gjermano-izraelite kanë evoluuar shumë më shpejt sesa procesi i

përballjes së Gjermanisë me të kaluarën e vet. Nga kjo situatë lindi një transformim i çuditshëm i antisemitizmit të llojit të vjetër, të ngulitur në sfondin e marrëdhënieve me Izraelin. Mjafton një shembull i vetëm për t'u bindur. Në vitin 1961 Gerhard von Preuschen, kreu i delegacionit gjerman të vëzhguesve në gjyqin e Adolf Eichmann, konkludoi raportin e tij përfundimtar duke lavdëruar “rininë izraelite, e cila dukshëm ndryshon nga gjeneratat e mëparshme. Këta të rinj - fëmijët e emigrantëve hebrenj gjermanë - pothuajse nuk kanë asnjë nga tiparet që zakonisht lidhen me hebrenjtë. Të gjatë, kryesisht bjond me sy të kaltërt, me fytyra me vija të rregullta, të pavarur dhe të lirë në lëvizjet e tyre, mishërojnë një formë të hebraizmit deri më tani të panjohur”.

Kjo deklaratë mahnitëse nga racizmi i pranuar dhe të stilizuar në mënyrë elegante pasqyrore një perceptim disi egocentrik të Izraelit: Shteti hebre bëhej racë ariane. Ky lloj paradoksi përshkruan historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve. Një narcisizëm i

* Mësimdhënës-hulumtues në School of Oriental and African Studies (Londër) dhe në Universitetin e Leeds. Autor i Germany and Israel: Whitewashing and Statebuilding, që do të publikohet te Hurst, Londër, më 30 prill 2020.

¹ Ky citat dhe të tjerët në vazhdim janë marrë nga punimi i autorit Germany and Israel: Whitewashing and Statebuilding, i cili do të publikohet te Hurst, Londër, më 30 prill 2020.

VËSHTRIM

Nami

Nami mendohet si fundi i botës, por mundet të jetë edhe fundi i një sistemi social, ekonomik e politik. Pandemia e shkaktuar nga COVID-19, mund të jetë nami proverbial. Pandemia e koronavirusit ka pauzuar jetën publike dhe ka i shkaktuar pengesa të mëdha ekonomisë globale, ku vetë globalizimi ka marrë një goditje të rëndë. Të gjitha fushat e jetës janë prekur dhe shumë nga to do të ndryshojnë nga kjo përvojë.

NGA SEB BYTYÇI

Ka disa ngjarje që shkaktajnë ndarjen e kohës në para dhe pas, si për shembull Lufta e Dytë Botërore ose kriza e naftës e viteve 1970. Kjo pandemi përbën një pikë kritike në kohë dhe shënon ndarjen e epokave para saj dhe pas saj. E veçanta e saj është se i ka prekur gati të gjitha shtetet e botës, edhe pse vdekshmëria nga virusi Covid-19 nuk është aq e lartë. Kjo përhapje e gjërë ka bërë që ekonomia globale të ndikohet si nuk ishte ndikuar nga pandemia tjera. Në përpjekje për ta parandaluar përhapjen e virusit, shumica e qeverive kanë marrë masa të izolimit social që kërkon mosshkruarjen në punë në shumë sektorë ekonomikë, gjë që ka pasë efekt në jetën sociale, politike e ekonomike.

Ekonomikisht, ajo ka ndikuar në rënien e aktivitetit ekonomik dhe humbjen e vendeve të punës. Për shkak të ndikimit në ekonomi, pandemia ka detyruar qeveritë e ndryshme të intervenojnë për ta parandaluar kolapsin. Për t'u siguruar që këto dëme nuk janë permanente, shumë qeveri kanë marrë masa për ta mbajtur gjallë ekonominë. Disa nga masat janë ulja e ratave të interesit, ndihma për firma, por edhe pagesa të pagave për individë të punësuar në firma dhe të vetëpunësuar. Po ashtu masat tjera përfshijnë pezullimin e pagesave të kredive si dhe qirave e faturave të ujit e energjisë.

Këto politika qeveritare përbëjnë një thyerje me të kaluarën. E përbashkëta e tyre është se janë në kundërshtim me konsensusin neoliberal që kërkon turrje të shtetit. Në të njëjtën kohë pandemia ka theksuar rolin e madh që e kanë shërbimet publike në ekonomi dhe në funksionimin e shoqërisë, duke ofruar dëshmi kundër pikëpamjeve neoliberale që i japin rëndësi sektorit financiar dhe korporatave si atëherë kyç në shoqëri.

NEOLIBERALIZMI
DHE PANDEMIA:
SHKAQET DHE
PASOJAT

Për më tepër, tashmë ka indikacione se neoliberalizmi ka ndihmuar në shkaktimin e pandemisë dhe në të njëjtën kohë ka vështirësuar ballafaqimin me të. Tashmë ka dëshmi se shpyllëzimi i shkaktuar nga globalizimi ka shkaktuar rritjen e numrit të pandemive, duke shkatërruar vatrat e viruseve nëpër zona pyjore të largëta. Në anën

(Autori është Profesor i asoc. në Programin Ndërkombëtar për Politikë dhe Ekonomi të Universitetit të Londrës)

tjetër po vërehet se vatrat kryesore të neoliberalizmit, SHBA dhe Britania e Madhe, kanë pasë më së shumti vështirësi në luftimin e pandemisë në krahasim me shtetet tjera të zhvilluara. Kjo lidhet me disa faktorë, së pari me privatizimin e shëndetit public dhe së dyti me jostabilitetin politik të viteve të fundit. Vetë ky jostabilitet i "viteve të Brexitit e Trampit", mund të thuhet se është shkaktuar nga politikat neoliberale që kanë dobësuar industrinë vendore në këto dy shtete, duke krijuar sektorë të popullsisë të përjashtuar nga përfitimet e globalizimit, të cilët u rebeluan politikisht.

Kjo krizë mund të jetë fundi i neoliberalizmit, sepse janë tri goditje kryesore që ka marrë neoliberalizmi. E para ndalimi i tregtisë globale, e dyta masat pro-shtetërore dhe e treta vënia në pah e rëndësisë së shërbimeve publike. Këto janë arsytet pse kjo pandemi do të duhej të përbëjë fundin e epokës së neoliberalizmit.

Por duhet të kemi kujdes në shpresën tone, sepse kjo gjë nuk është e garantuar se do të ndodhë. Shohim se vetë pandemia i ka përkeqësuar disa nga pasojat e neoliberalizmit si pabarazia, e cila veçsa rritet në kriza të tilla. Pandemia nuk i ka prekur të gjitha shtresat njëjtë dhe shtresat e mesme e të varfëra do të pësojnë më shumë. Prandaj, kjo pandemi ka rrezik që do të shfrytëzohet për të forcuar edhe mëtej neoliberalizmin përmes zbatimit të kapitalizmit të katastrofës, ashtu siç shfrytëzohet për ta forcuar autoritarizmin.

Një fenomen i shkaktuar nga pandemia është demaskimi i disa gjërave dhe përshpejtimi i proceseve historike, ndoshta poetikisht, ndërkohë që na detyron të mbajmë maska. Fola më lartë për demaskimin e ideve ekonomike që bëjnë thirrje për privatizimin e gjithçkaje. Në politikë, ka demaskuar tendencat autoritare. Ngjashëm me konceptin e kapitalizmit të katastrofës, ku katatrofat përdoren për të instaluar politika të cilat nuk do të kishin përkrahje ndryshe, si psh privatizimi i shërbimeve publike, tashmë po qartësohet koncepti i autoritarizmit të katastrofës. Pandemia po përdoret për të instaluar autoritarizëm dhe shtypur demokracinë, përmes mjeteve siç janë masat ndaluese e vëzhguese si dhe gjendja e jashtëzakonshme. Poashtu, ka demaskuar ngadalësinë e funksionimit të Bashkimit Evropian, i cili do të duhet të merr mësimë serioze nga kjo krizë. Në të njëjtën kohë, po përshpejtohen proceset e kalimit të shërbimeve në internet dhe kthimit të manufakturës në përditë, sidomos me printimin 3D.



NË ASPEKTIN
GLOBAL, PANDEMIA
PO E GODIT FORTË
QASJEN NEOLIBERALE
NË EKONOMI,
EDHE BRENDA
VENDIT DUHET TË
INSTALOHET NJË
QASJE E RE KU
REALIZOHET ROLI
ADEKUAT I SHTETIT
NË EKONOMI. PAKOT
FINANCIARE PËR
ZBUTJEN E KRIZËS
JANË HISTORIKE.
ATO MUND TA
KENË RËNDËSINË E
NEW DEAL DHE TË
JENË SHANS PËR
INSTALIMIN E SHTETIT
ZHVILLIMOR.

BOTA E RE

Pasojat ekonomike të pandemisë mund të jenë shumë të rënda. Rreziku është i madh që të thellohet hendeku mes të pasurve dhe të varfërve. Qeveritë duhet të ndërmarrin masa për të zbutur efektet e saj.

Pandemia i bën urgjente disa politika që do të duhej të ndërmirreshin për zhvillim. Ashtu siç në aspektin global pandemia po e godit fortë qasjen neoliberale në ekonomi, edhe brenda vendit duhet të instalohet një qasje e re ku realizohet roli adekuat i shtetit në ekonomi. Pakot financiare për zbutjen e krizës janë historike. Ato mund ta kenë rëndësinë e New Deal dhe të jenë shans për instalimin e shtetit zhvillimor. Do të duhej ndjekur parimet e përgjithshme në vijim për të pasë efekt më të madh.

Të krijohet një fond i veçantë që do të ishte si embrion i fondit zhvillimor/bankës zhvillimore. Të shfrytëzohet pako që të tërhiqen edhe fonde tjera - përmes nxitjes së ndihmave nga jashtë, kredive komerciale ose investimeve tjera nga diaspora ose nga vendi. Të ketë zgjerim në sektorë të rinjë dhe në prodhim/eksport - sidomos në sektorin e gjelbër dhe ITK. Të zbatohet pako në përpunje me strategjinë dalëse nga gjendja emergjente

- për shembull të lejohen fillimisht hapja e ndërmarrjeve në industri strategjike: prodhuese, ITK. Ndihma të realizohet me fokus te punëtorët së pari dhe pastaj te makineria. Pako të jetë integrale - të dizajnohet duke pasë parasysh politikat publike në fushat tjera si shëndetësia. Të bëhet përfshirja e komunave, nxitja e tyre të zbatojnë politika të ngjashme në nivel komunal. Të testohen politika që do të bëheshin të përhershme - për shembull të ardhurat themelore universale dhe ndihmat e papunësisë. Të sigurohet transparenca, llogaridhënia dhe meritokracia në dizajnimin dhe implementimin e pakos.

Për të qenë më efektive pako duhet të ketë tri lloje të ndihmës: grante, hua dhe blerje. Përveç këtyre të ketë lehtësime fiskale dhe lehtësime tjera për industritë strategjike. Rezultat i pakos të jetë një gjendje ku ka zgjerim të prodhimit dhe eksportit, ngritje në vargun e vlerës, opcion publik në industri kyçe dhe tjera, si dhe forcim të pozitës së punëtorëve përmes kooperativizimit dhe sindikatave

Ndihmat dhe grantet të shpërndahen në bazë të priorizimit ku kanë prioritet industritë strategjike. Sa i përket blerjeve, shteti duhet të blejë aksione kontrolluese në të paktën një ndërmarrje nëpër industritë strategjike dhe tjera si për shembull në ITK, energji, farmaceutikë, mjekësi, kimikale, ushqimore, bujqësore, supermarkete, tekstil, prodhimtari makinerish/pjesëve/veglave, ndërtim rrugor e banesor, transport mallrash e njëtrëzish, arsim privat si dhe industri tjera.

Për ta integruar pakon me fushat si shëndetësia, politikat ushqimore, transporti e politikat lokale duhet të ndërmirren hapat në vijim. Të krijohet paketa me produkte kryesore ushqimore dhe higjienike dhe t'u shpërndahen qytetarëve. Aty do të përfshiheshin edhe fara që qytetarët do të mund t'i mbillnin në kopshtet e tyre, në shërbim të sigurisë ushqimore kombëtare. Këto duhet të jenë prodhime vendore për ta parandaluar kolapsin e industrisë vendore. Po ashtu, duhet të ofrohet transporti falas për punëtorët e sektorëve strategjik. Duhet të transferohen të ardhura themelore, një shumë e caktuar për secilin individ, që ua mundëson familjeve ta përballojnë krizën.

Sa i përket tatimeve këtu janë një sërë politikash që mund të ndërmirren. Gjëja e parë që duhet të bëhet është dallimi mes firmave që merren me prodhim dhe eksport të manufakturës dhe firmave tjera. Meqenëse prodhimi dhe eksporti i manufakturës deri më tash është dëshmuar të jetë strategjia që garanton zhvillimin, firmat që merren me këto aktivitete duhet të ndihmohen në çdo mënyrë. Kjo përfshin edhe lehtësimet e ndryshme tatimore që mund të bëhen përmes ligjit mbi tatimin e të ardhurave të korporatave dhe ligjeve tjera. Një politikë shumë e rëndësishme që duhet të futet brenda ligjit është përgjysmimi i normave tatimore për këto firma. Fatkeqësisht, aktualisht nuk ka ndonjë trajtim i veçantë i këtij lloji të firmave. Gjithashtu, tatimi i sheshtë duhet të braktiset dhe duhet të ketë shkallëzim të tatimit (të paktën në tri shkallë) ngjashëm me tatimin mbi të ardhurat personale. Nëse shteti i mbulon shpenzimet e transportit për eksportin e manufakturës deri në një largësi të caktuar kjo do të ndikonte shumë në zhvillimin e sektorit prodhues.

Sa i përket zhvillimit njerëzor të bëhet diskriminim ndaj aktiviteteve që rezultojnë në pasojat negative te popullsia. Të shpenzimet e lejueshme të mos përfshihen shpenzimet e reklamimit për promovimin e duhanit, alkoolit, pijeve të gazuara dhe produkteve me përmbytje të lartë të sheqerit dhe yndyrës. Përmes një politike të tillë fiskale shteti do të parandalonte sëmundje të shumta dhe shpenzimet për shërimin e tyre. Për më tepër, një popullsi e shëndoshë ndihmon në shumë në zhvillim. Duhet të shfrytëzohen efektet e pandemisë që i detyroi njerëzit të rrinë në shtëpi e në shumë rastë t'i kthehen tokës. Duhet të nxiten aktivitetet që ndihmojnë në mirëqenien e qytetarëve dhe në të njëjtën kohë i pavarësojnë njerëzit nga varësia nga ekonomia globale si për shembull rritja e ushqimit të tyre.

Pasojat e pandemisë janë të ndryshme dhe duhet të nxirren mësimet pozitive e negative gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, duhet të ketë politikëbërje aktive për t'i dhënë fund gjendjes që ka mbretëruar deri tash. Duhet krijuar një sistem i ri që sjellë zhvillim dhe mirëqenie të vërtetë për qytetarët.

Masat shtrënguese, këto korrëse të mëdha

Një studim dhjetëvjeçar nga epidemiologu britanik Michael Marmot tregon se politikat e shkurtesave buxhetore që nga kriza e vitit 2008 kanë thelluar hendekun midis të pasurëve dhe të varfërve për sa i përket jetëgjatësisë.

NGA MICHAEL MARMOT*

Për sa i përket përparimit shoqëror, Mbretëria e Bashkuar ka humbur dhjetë vjet. Dhe kjo shihet. Matur për sa i përket jetëgjatësisë, shëndeti i britanikëve po përkeqësohet, përderisa ishin mësuar në përmirësimin e saj nga viti në vit për më shumë se një shekull.

Paralelisht, pabarazitë shëndetësore janë duke u thelluar. Dhe ajo që është e vërtetë për Anglinë është edhe më shumë për Skocinë, Uellsin dhe Irlandën Veriore. E tërë shoqëria vendnumëron, kur shëndeti i një popullate nuk përparon tutje. Të dhënat globale konfirmojnë që gjendja shëndetësore është një tregues i mirë i përparimit ekonomik dhe shoqëror. Një shoqëri gazmore ka prirje të shfaq shëndet të lulëzuar. Në të kundërt, pabarazitë e thella ekonomike dhe sociale përkthehen në pabarazi shëndetësore.

Mënyra se si financohet dhe administrohet sistemi i kujdesit shëndetësor të një vendi është padyshim thelbësor, por shëndeti i banorëve të tij nuk varet vetëm nga kjo. Ajo bazohet më gjerësisht në kushtet e jetesës dhe të punës, menaxhimin e plakjes, si dhe në pabarazitë në shpërndarjen e pushtetit dhe resurseve. Së bashku, këta faktorë përbëjnë përcaktuesit shoqëror të shëndetit.

Jetëgjatësia në Mbretërinë e Bashkuar, e cila është duke u rritur që nga fundi i shekullit të XIX, filloi të bie në mënyrë dramatike më 2011. Midis 1981 dhe 2010, jetëgjatësia zgjatej me rreth një vit në çdo pesë vjet e gjysmë për gratë, çdo katër vjet për burrat. Midis 2011 dhe 2018, ky përparim u ngadalësua në mënyrë të konsiderueshme: gratë fitojnë vetëm një vit në njëzet e tetë vjet dhe burrat në çdo pesëmbëdhjetë vjet.

Për këtë tregues, një klasifikim i rajoneve sipas indeksit të privimit të shumëfishtë i cili grumbullon të dhëna mbi të ardhurat, punësimin, arsimin, trajnimin, shëndetësinë, kushtet e jetesës... dhe i cili përafrohet me indeksin e varfërisë shumëdimensionale të përdorur, për shembull, nga Kombet e Bashkuara, zbulon ekzistencën e një shkalle shoqërore, një variacion sipas niveleve sociale, po aq i fortë sa konstantja.

Me fjalë të tjera, sa më shumë një rajon është i pazhvilluar, aq më të ulët e ka jetëgjatësinë. Gjatë periudhës 2016-2018, burrat që banonin në 10% të territorit më të zhvilluar britanik (decilja e parë) jetonin nëntë vjet e gjysmë më gjatë se ata që banonin në 10% të territorit më të pazhvilluar (decilja e fundit). Për gratë, dallimi ishte 7.7 vjet. Shkalla shoqërore

në jetëgjatësinë e shëndetshme është edhe më e theksuar. Koha e kaluar më shëndet të dobët madje u rrit në mes të viteve 2009-2011 dhe 2015-2017, duke shkuar nga 15.8 në 16.2 vjet për burrat dhe nga 18.7 në 19.4 vjet për gratë.

Pastaj, përkundër mungesës së statistikave të rregullta për këtë temë, shifrat ekzistuese mbi pasojat e pre-jardhjes etnike tregojnë se gjysma e minoriteteve - kryesisht zezakët, aziatikët etj - kanë jetëgjatësi pa paaftësi fizike dukshëm më të ulët se ajo e britanikëve të bardhë.

Ky përkeqësim i përgjithshëm nuk është ndonjë fatalitet. Në vitin 2008, të shqetësuar thellësisht nga përmasat e pabarazive shëndetësore në vend, qeveria laburiste e z.Gordon Brown kërkoi nga ne të bënim propozime për t'i zvogëluar ato. Me ekipim tim nga Instituti i ardhshëm për Barazi Shëndetësore të krijuar më vitin 2011, ne kemi trajnuar nëntë grupe të punës prej më shumë se tetëdhjetë specialistësh, që vendosen t'i rishikojnë të dhënat ekzistuese. Pastaj një komision ekspertësh u takua për t'i diskutuar këto rezultate.

KY ËSHTË SAKTËSISHT EFEKTI I POLITIKAVE TË TYRE

Kulmi i këtij hulumtimi ishte botimi në vitin 2010 i *Fair Society* i njohur më mirë si “Raporti Marmot”¹. Megjithëse ishte porositur nga laburistët, ky raport është pritur mirë nga koalicioni qeveritar i drejtuar nga konservatorët. Një sondazh i bërë nga Royal Society for Public Health me anëtarët e tij dhe një panel shkencëtarësh e renditi atë në tre rëfimet më të mira të suksesit të shek. XXI në fushën e shëndetit publik në Mbretërinë e Bashkuar, duke e ndaluar duhanpirjen në vendet publike dhe të punës, si dhe duke e futur “taksën soda”.

Megjithatë, demonstrimi i tij kryesor, sipas së cilit politikat ambicioze publike për të gjitha moshat mund të veprojnë mbi përcaktuesit social të shëndetit dhe të zvogëlojnë pabarazinë, mbeti kryesisht i shpërfillur.

Masat shtrënguese buxhetore u bënë parazgjedhja kryesore e qeverisë që erdhi në pushtet më 2010, si dhe e kabinetit konservator të zgjedhur më 2015. Shpenzimet publike u rritën nga 42% e Prodhimit të Brendshëm Bruto në 2009-2010 në 35% në 2018-2019, të gjitha nën maskën e kthimit të rritjes ekonomike.

Padyshim që udhëheqësit britanikë do të ishin kundërshtuar nëse do të tregonin se qëllimi i tyre i vërtetë



Përfundimi ynë është se kjo kurë e masave shtrënguese ka sjellur pasoja katastrofike në pothuajse të gjithë përcaktuesit shoqërorë të shëndetit, duke i përkeqësuar pabarazitë në këtë fushë

NJË POPULLATË ME SHËNDET ÇDO HERË E MË SHUMË TË DOBËT

Arkitektët e këtyre masave mendonin ndoshta se të gjitha këto ndihma ishin para të hedhura nga dritarja, por faktet i demantojnë. Në studimin e ri që po e botojmë sot, dhjetë vjet pas raportit Marmot³, ne paraqesim gjendjen ekzistuese për pesë nga gjashtë rekomandimet kryesore të bëra nga ekipi ynë më vitin 2010: t'i mundësohet çdo fëmijut ta filloi jetën në mënyrë sa më të mirë të mundshme; t'i garantohet qasje në arsim dhe në trajnim të vazhdueshëm; t'i përmirësohen kushtet për punësim dhe punë; t'i sigurohet secilit burimet e nevojshme për të jetuar me shëndet të mirë; të zhvillohen hapësirat dhe lagjet e qëndrueshme të jetesës.

Përfundimi ynë është se kjo kurë e masave shtrënguese ka sjellur pasoja katastrofike në pothuajse të gjithë përcaktuesit shoqërorë të shëndetit, duke i përkeqësuar pabarazitë në këtë fushë.

Varfëria e fëmijëve u rrit nga 28% për periudhën 2009-2012 në 31% gjatë 2015-2018, pasi përfshiu koston e strehimit. Gati një mijë çerdhe dhe qendra të kujdesit për fëmijë të përfshirë në programin Sure Start, një program qeveritar për fëmijërinë e hershme dhe mbështetjen e prindërve të zbatuar në nivelin lokal, duhej t'i mbyllnin dyert për shkak të shkurtimeve financiare në shpenzimet publike lokale.

Një humbje që përpjekja e lavdërueshme e bërë në dobi të fëmijëve parashkollorë pak më të vjetër nuk është e mjaftueshme për të kompensuar. Nuk është mister që fëmijëria e hershme është një fazë vendimtare në jetë, ku fitohen aftësitë që përcaktojnë të ardhmen - konjitive, gjuhësore, sociale, emocionale

dhe të sjelljes. Zhvillimi i kënaqshëm i fëmijëve të vegjël ndihmon mirë për performancën e mirë akademike, e cila nga ana tjetër garanton mundësi më të mira profesionale dhe kushte më të shëndetshme të jetesës në moshën e rritur.

Në anën tjetër, kriza e banimit rezultoi në një shpërthim në numrin e të pastrehëve, por edhe në një rritje të proporcionit të britanikëve që shpenzojnë më shumë se një të tretën e të ardhurave të tyre për këtë punë. Edhe pse kjo rritje prek të gjitha klasat, mund të shihet, pa ndonjë befasi të madhe, një përshkallëzim i fortë social. Më 2016-2017, 38% e familjeve në 10% më të ulëta të shkallës së të ardhurave ishin në këtë situatë, krahasuar me 28% një dekadë më parë.

Në përgjithësi, një pjesë në rritje e popullsisë nuk i ka më mundësitë për ta ruajtur shëndetin e mirë dhe duhet t'i drejtohet bankave ushqimore për t'u ushqyer. Të përjashtuarit po shumëzohen. Ata me kushte të mjerrueshme që kanë pak arsye për të shpresuar për përmirësim. Me këto efekte shkatërruese të mosangazhimit të shtetit, vështirë të thuhet se cilat kanë ndikim më të madh në pabarazitë shëndetësore, sepse të gjitha janë të lidhura.

Së paku mbeten akoma sot të vlefshme fjalët që i kemi shkruar dhjetë vjet më parë në raportin Marmot: «*Pabarazitë shëndetësore mund të shmangen dhe zvogëlohen shumë, përderisa burojnë nga pabarazitë sociale, të cilat vetë janë të shmangshme.*»

*Drejtor i Institutit për Barazi Shëndetësore në University College London (UCL). Një version i këtij teksti u shfaq në *British Medical Journal* në shkurt të vitit 2020.

1 Michael Marmot, *Fair Society, Healthy Lives – The Marmot Review. Strategic Review of Health Inequalities in England Post-2010*, Institute of Health Equity, Londër, 2010.

2 Jack Britton, Christine Farquharson, Luke Sibbels, *Annual Report on Education Spending in England*, The Institute for Fiscal Studies, Londër, 2019.

3 *Health Equity in England: The Marmot Review 10 Years On*, Institute of Health Equity, Londër, 2020, www.instituteofhealthequity.org

75 VJET PAS ÇLIRIMIT TË KAMPEVE TË PËRQENDRIMIT

Në Buchenwald, antifashistët humbën luftën e kujtesës

Një makt përfundoi dhe një histori filloi me çlirimin e kampit të përqendrimit në Buchenwald në prill 1945. Historia e të burgosurëve, shpesh komunistë, të cilët shpëtuan jetëra, duke bërë përzgjedhje të dhimbshme. Por, vepra e tyre e kremtuar nga regjimi i Gjermanisë Lindore, kontestohet ashpër prej rënies së Murit të Berlinit. Ata që e fituan Luftën e Ftohtë filluan ta rishkruajnë historinë.

NGA SONIA COMBE *

Çdo ngjarje përkujtimore është një akt politik. Mbahen fjalime monotone, frazeologjia e të cilave, shpesh konvencionale dhe përsëritëse, fsheh qëllime të caktuara. Një gjë e tillë u pa edhe sivjet në 75 vjetorin e çlirimit të kampit për shfarosje të Aushvicit. Më 27 janar, secili shtet, duke ndjekur qëllimin e vet, parashtroi (re)vizionizmin e tij të historisë. Në Izrael, historiani Zeev Sternhell u shpreh ashpër. Sivjet, përkujtimi i gjenocidit u përdor si “pretekst për pushtimin” e territoreve palestineze¹ (Haaretz, 31 janar). Të mbijetuarit, pengje të kësaj situatë u bënë personazhe dytësore, edhe pse ngjarja organizohet zyrtarisht për t’i kujtuar vuajtjet dhe luftën e tyre.

Ngjarja tjetër përkujtimore do të zhvillohet në Buchenwald, që ishte kampi i parë gjerman i përqendrimit i cili ishte çliruar. Një ceremoni nën mbikëqyrje të lartë. Memoriali ndodhet në landin e Tyingisë, ku ekstremi i djathtë i përfaqësuar nga Alternativa për Gjermaninë (AfD) zë vendin e dytë në Parlamentin Rajonal me 23.4% të votave të fituara në zgjedhjet parlamentare të tetorit të kaluar. Në vendin e parë është e majta (Die Linke) e cila fitoi 31%. Në Buchenwald, madje më shumë sesa në Dachau, Sachsenhausen ose Ravensbrück, anëtarët e AfD-së shfaqen për të mbajtur fjalime negacioniste. Drejtori i Memorialit, z.Volkhard Knigge, e përshkruan këtë situatë si «një tregues gjithnjë e më serioz të dobësimit të vetëdijes historike» (Der Spiegel, 23 janar 2020). Padyshim. Por, mbetet të kuptohet se në ç’masë ka kontribuar në këtë dobësim rishkrimi i Luftës Antifashiste pas rënies së Murit, e ku Memoriali i Buchenwald-it ishte një nga vektorët.

Në fakt, nga fillimi i Luftës së Ftohtë e deri në ditët e sotme, historia e Buchenwaldit është rishkruar vazhdimisht sipas situatës dhe kohës. Kampi ishte hapur në korrik 1937. Ka qenë njëri nga kampet e para të përqendrimit të ndërtuar nga regjimi nazist dhe ka funksionuar deri më 11 Prill 1945, ditën kur e zbuloi ushtria amerikane përgjatë rrugës për në Weimar. Aty kanë qenë të grumbulluar kundërshtarët e regjimit nazist, kryesisht komunistët dhe socialdemokratët, për t’u mbajtur larg shoqërisë. Aty u mbajtën afro 10,000 hebrenj të arrestuar gjatë ‘Natës së Kristaltë’ më 9 nëntor 1938, si dhe ciganët, dëshmitarët e Jehovahit dhe homoseksualët, si dhe të gjithë ata që regjimi i konsideronte «asocial».

Schutzstafeli («Skuadra e Mbrojtjes» - SS) ua delegoi së pari këtyre të burgosurve administrimin e brendshëm të kampit. Deri më vitin 1942, kur të burgosurit politikë i larguan ata pas një beteje për të cilën thuhet se ishte e ashpër, por shpëtimtare për mendimin e përgjithshëm.

Kur vendosën që të burgosurit e kampeve të përqendrimit duhej të kontribuonin në përpjekjet e luftës, SS-ët kuptuan që «trekëndëshat e kuq»² ishin më të përshtatshëm për funksionet menaxheriale. Të burgosurit politikë kishin fuqi vendimmarrëse, të kufizuar por reale, mbi fatin e të burgosurve. Ata ishin në pozita strategjike, si në shpërndarjen e të burgosurve nëpër pavijone të punës, ashtu edhe në organizimin e konvojëve që do të dërgoheshin në kampet në Dora, ku mesatarisht mbijetonin dy javë³, ose edhe në Aushvic për ata të burgosurit - hebrenj dhe ciganë – që duhej shfarosur.

Pas fillimit të luftës, në Buchenwald janë mbajtur luftëtarët e rezistencës nga e gjithë bota, përfshirë afro 26,000 francezë dhe ushtarët sovjetikë, 8.483 prej të cilëve u ekzekutuan nga SS-ët me një shkrepje në qafë. Fillimisht kampi ishte planifikuar për 8.000 të burgosur. Në fund të luftës ai ishte i mbingarkuar dramatikisht. Nga vjeshta e vitit 1944, për shkak të përparimit të Ushtrisë së Kuqe, u evakuuan kampet e shfarosjes të vendosur në Lindje. U grumbulluan mijëra të mbijetuar të këtyre «marshimeve të vdekjes». Në janar 1945, në Buchenwald numëroheshin 100.000 të burgosur. Kur amerikanët morën kontrollin e kampit, aty gjetën 21,000 të mbijetuarë. Rezistenca klandestine, e cila kishte mbledhur armë për një kryengritje, ua dorëzoi amerikanëve SS-ët e fundit që kishte kapur. Të burgosurit politikë gjermanë, kryesisht komunistë, ishin në krye të kësaj rezistence.

PROMOVIMI I HISTORISË HEROIKE

«Një perde e hekurt ra në kontinent prej Stettinit në detin Baltik deri në Trieste në detin Adriatik». Kur Winston Churchill tha këtë fjali më 5 Mars 1946 duke e shpallur Luftën e Ftohtë u shfaq një raport i një historiani të ushtrisë amerikane, Donald Robinson, me titull «Mizoritë komuniste të kryera në Buchenwald». Në raportin e ri të forcave që vendosej në Evropë, ky dokument e ushqente diskursin anti-sovjetik. Por është *Shteti SS*, libri i sociologut Eugen Kogon (jokomunist) të internuar në Buchenwald, botuar në vitin 1946, që do të bëhet vepra referuese⁴. Pa injoruar marrëdhëniet konfliktuale midis të arrestuarve dhe as raportin e forcave, Kogon



përpiqet të hedhë dritë mbi mënyrën sesi të burgosurit politikë gjermanë arritën ta ruanin një lloj rendi dhe ta parandalonin përhapjen e frymës «secili për veti».

Në Gjermaninë Lindore, shtet i krijuar në tetor 1949, regjimi i ri e bazon legjitimitetin e tij në luftën kundër militantëve antifashistë. Pas kthimit nga Bashkimi Sovjetik, ku kishin qenë në mërgim, ata që marrin udhëheqjen në pjesën lindore të Gjermanisë promovojnë një histori heroike të rezistencës ndaj nazizmit. Ndërkohë, ata vetëshpallen trashëgimtarë të kësaj rezistenceje të cilën do ta bëjnë religjon shtetërore. Kampi-muze i Buchenwald, inauguruar në vitin 1958, do të bëhet një lloj tempulli i saj. Çdo vjet, aty do të përkujtohet solemnisht “Betimi i Buchenwald” të 19 prillit 1945, kur të burgosurit u zotuan që do të luftojnë për paqe dhe liri. Por, edhe pse të mbijetuarit e kampeve ishin heronj zyrtarë, ata megjithatë ishin përjashtuar nga pushteti – madje disa herë qenë viktimat të spastrimeve staliniste të fillimit të viteve 1950: këto quadro komuniste të kalitura nga trembëdhjetë vjet në burgje dhe kampe tregohen më pak të dëgjueshëm se të burgosurit e kthyer nga Moskë, bindja e të cilëve ndaj BRSS ishte bërë zakon. Në vitin 1958, romani i Bruno Apitz *Nacht unter Wölfen* (Lakuriq midis ujërve) u botua në Republikën Demokratike të Gjermanisë (RDGJ). Ky roman i përkthyer në tridhjetë gjuhë do të shënoj sukses në gjithë botën⁵. Autori, një ish i burgosur i Buchenwaldit, tregon historinë e një trevjeçari polak hebre i cili shpëtohet nga të burgosurit politikë nga simpatia që ngjallë ai tek ata. Ky roman adaptohet në një film eponim nga regjisor i gjermano-lindor, Frank Beyer i cili në vitin 1963 fiton çmimin për regjinë më të mirë në festivalin e Moskës, ku garoi Federico Fellini me filmin *Tetë e gjysmë*⁶. Rolin kryesor e luan Armin Mueller-Stahl, aktori i preferuar i Rainer Werner Fassbinder. Disa aktorë të tjerë dhe statistikë ishin gjithashtu të mbijetuar të kampeve naziste dhe filmi u xhirua në vendin e ngjarjes. Në Moskë, një spektator kishte vërejtur se ishte historia e nipit të tij të quajtur deri atëherë “fëmija i Buchenwaldit”. Ishte identifikuar Stefan Jerzy Zweig.

Tregimi i Bruno Apitz i bazuar në një ngjarje të vërtetë, megjithëse i trilluar, luan rolin në RDGJ të një romani kombëtar në të cilin shpëtimi i fëmijut bëhet simbol i humanizmit të komunistëve nëpër kampe. Siç ndodh shpesh, trillimi mbizotëroi mbi historinë e vërtetë dhe skenografia e kampit-muze u frymëzua nga ky tregim, i cili do t’i lartësojë veprimet e komunistëve deri në fund të regjimit. Feja, madje edhe ajo sekulare,

nuk i pranon lehtë kundërshtitë. Në narrativën e Gjermanisë Lindore nuk përfshihet çështja e marrëdhënieve midis të burgosurve politikë dhe SS-ët, si dhe midis vetë të burgosurve. Kjo “zonë gri” e cila sipas Primo Levit, autorit të *If this is a man* (Nëse është burrë), nuk binte nën juridiksionin e asnjë gjykateje njerëzore, do të gjykohej megjithatë në Gjermaninë e ribashkuar.

Sikur të ishte gjëja më urgjente, në rend të parë u bë ridizajnimi i memorialit të Buchenwaldit në Gjermaninë epas Luftës së Ftohtë. Ndër nisimat e para ishte rizbulimi i kampit të Speziallagerit, ku sovjetikët i kishin internuar më 1945 (duke mos e falur askënd) drejtuesit e partisë së Adolf Hitlerit, Partisë Nacional-Socialiste të Punëtorëve Gjermanë (NSDAP), nga të cilët tre të katërtat vdiqen nga uria. Më 1999, autoritetet inauguruan një memorial tërësisht të “rishikuar dhe korrigjuar”. Tani është një frymë e re, edhe një perspektivë e re, dhe Volkhard Knigge, drejtori i ri i lokacionit - një historian i katapultuar nga Gjermania Perëndimore - harton një tregim ndryshe nga i vjetri. Tani merremi me viktimat e jo me heronjtë, si dhe personalizohen aktorët. Edhe pse nuk përjashtohen plotësisht komunistët, ata tani zhduken si grup shoqëror. Hiqet edhe pllaka që përkujton shpëtimin e Stefan Jerzy Zweig. Kundërshtimet e tij tashmë shtatëdhjetëvjeçar nuk patën ndikim. Kot kishte kundërshtuar edhe shkrimtarja Elfriede Jelinek, meqë ngadhënjëu mungesa e taktit dhe kokëfortësia e drejtorit të Memorialit. Hihdet poshtë «Fëmija i Buchenwaldit», figurë emblematike në historinë e Gjermanisë Lindore, sikurse Anne Frank për viktimat e Holokaustit. Në fakt, 904 fëmijë ishin shpëtuar në Buchenwald, falë rezistencës klandestine.

Duke e ç’montuar me përpikëri atë që tani quhet «miti i antifashizmit» i RDGJ, një grup historianësh përpilon në vazhden e ribashkimit një vepër që është akoma referencë. Në veprën *Der gesäuberte Antifaschismus*⁷, ata parashtrojnë tezën sipas të cilës të ashtuquajturit «kapo të kuq» kanë mbijetuar në kurriz të të tjerëve. Solidariteti ekzistonte vetëm midis tyre. Në shtypin e bulevardit, si dhe në punime të ndryshme, përhapet historia e “fëmijës së Buchenwaldit” dhe historia e “kapove të kuq”, që quhen bashkëpunëtorë SS. Përhapet edhe shprehja “komunist=nazist” që ngjall te disa ndjenjen se janë mashtruar nga diskursi i Gjermanisë Lindore. Zgjerohet teza e historianit Ernst Nolte, sipas së cilët kampet naziste të shfarosjes ishin një reagim i mbrojtjes kundër bolshevizmit (*Frankfurter Allgemeine Zeitung*, 6 qershor 1986), derisa mishërimi i të kuqëve dhe të kaftëve bëhet i zakonshëm.

Por, në librin e tij *Les Jours de notre mort* (Ditët e Vdekjes Sonë) (Éditions du Pavois, 1947), David Rousset, ish i internuar francez, ka përshkruar situatën tilla me të cilat përballeshin të burgosurit politikë për çdo ditë, duke bërë përzgjedhje në rrethana ekstreme. Stéphane Hessel, autor i *Indignez-vous*⁸!, Imre Kertész, fitues i çmimit Nobel për letërsi më 2002, si dhe Jorge Semprun, në veprën *Le Mort qu’il faut* (Gallimard, 2001), nuk fshehin faktin se ishin shpëtuar nga “kapot e kuqe”, sikurse me rastin e Stefan Jerzy Zweig, emri i të cil-it ishte hequr nga një listë e fëmijëve të dëbuar,

Libri i Rousset nuk është përkthyer kurrë në gjermanisht. Të shkruash për përditshmërinë në kampet naziste pa e lexuar këtë libër është pothuajse si kur historianët punonin mbi kampet e punës së detyrueshme sovjetike duke e injoruar *Arkipelagun e gulagut* të Alexander Solzhenitsyn. Në Buchenwald, një ekspozitë e titulluar *Leitmotiv der DDR* (“Legjendat e RDGJ”) i kushtohet madje tërësisht ç’montimit të “mitit”. Aty shfaqen “krimet” e të burgosurve politikë. Atëherë, çfarë mbetet nga ballarët-themelues të këtij shteti, të cilët ishin thirrur në emër të trashëgimisë antinaziste?

Interpretimi mbizotëruar i historisë së RDGJ që bazohet në konceptin e totalitarizmit, nënkupton barazimin midis regjimit komunist dhe sistemit nazist⁹. Politika përkujtimore e cila inkurajohet, financohet dhe përhapet, në veçanti nga Fondacioni për rivlerësimin e diktaturës së Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë (Bundesstiftung zur Aufarbeitung der SED-Diktatur) konfirmon se nëse antifashizmi ka qenë religjioni shtetëror i RDGJ, antikomunizmi ka qenë religjioni shtetëror i Republikës Federale së Gjermanisë (RFGJ).

Kjo qasje ka dërguar ujë në mullirin e AfD-së i cili po e përdor atë në çdo rrethanë. Kjo parti, produkt i së djathtës ekstreme, që erdhi nga Gjermania perëndimore, për t’u ndërtuar mbi rrënojat e RDGJ-së, mbështetet në një pasqyrim dogmatik dhe demonizues të përvojës së Gjermanisë Lindore, duke e përhapur në media, si dhe në punime shkencore. AfD keqpërdor ndjenjën e trishtit të një pjese të popullsisë së Gjermanisë Lindore, të reduktuar ose në rolin e viktimës së regjimit komunist ose të bashkëpunëtorit të një diktature.

Në Buchenwald, si masë e parë duhet të rivendosen faktet dhe meritat për ta luftuar diskursin negacionist. Ka ardhur koha të merret parasysh kjo qasje.

* Historiane. Autore e «Une vie contre une autre. Échange de victime et stratégies de survie dans le camp de Buchenwald», Fayard, Paris, 2014 dhe e «La Loyauté à tout prix: Les floués du “socialisme réel”», Le Bord de l’eau, Lormont, 2019.

1 «Plani i paqes» i paraqitur më 28 janar nga z.Donald Trump forcon kërcënimet e pushtimit të vendbanimeve që gjenden në territoret e Bregut Perëndimor të pushtuar nga Izraeli që nga lufta gjashtë ditore më 1967.
2 Çdo kategori e të burgosurve barte një trekëndësh me ngjyra të ndryshme, të kapur në gjoks. Trekëndëshi i të burgosurve politikë ishte i kuq. Trekëndëshi i ligjit të zakonshëm i gjelbër.
3 Kampi ku prodhoheshin raketat V2 në fabrikat nën-tokësore.
4 Përkthim në frëngjisht: Eugen Kogon, *L’Enfer organisé. Le système des camps de concentration allemands*, La Jeune Parake, Paris, 1947.
5 Bruno Apitz, *Nu parmi les loups*, Les Éditions français réunies, Paris, 1961.
6 Shih Bill Niven, *The Buchenwald Child: Truth, Fiction and Propaganda*, Camden House, Rochester, 2007.
7 Lutz Niethammer (nën drejtimin e), *Der gesäuberte Antifaschismus*, Akademie Verlag GmbH, Berlin, 1994.
8 Stéphane Hessel, *Indignez-vous* !, Indigène Éditions, Montpellier, 2010.
9 Shih Carola Haehnle-Mesnard, «La RDA dans le (ré)tro visuel. Plaidoyer pour une autre perception», *Symposium Culture@Kultur*, vol. 2, Berlin-Toulouse, 2020.

PUSHTIMI I OQEANEVERE POLARE

Gjeopolitika e akullthyesve

Oqeanet Arktik dhe Jugor po bëhen tërheqëse çdoherë e më shumë. Shkrirja e akujve tashmë e dukshme në Veri gjatë verës mund të hap zona gjigante detare dhe bregdetare për lundrim, si dhe për shfrytëzim të burimeve natyrore. Përmes nivelit të zhvillimit të flotave kombëtare të akullthyesve mund të maten ambiciet e vërteta të vendeve që synojnë të përfitojnë nga ngrohja globale në këto gjerësi gjeografike.

**NGA SANDRINE BACCARO*
DHE PHILIPPE DESCAMPS**



Disa orë para dorëheqjes së tij, më 15 janar, kryeministri rus Dmitri Medvedev nënshkroi një çek me vlerë 127 miliardë rubla (1.85 miliardë euro) për lansimin e projektit Lider për prodhimin e akullthyesit më të madh të ndërtuar ndonjëherë. Me gjatësi 200 metra, gjerësi 50 metra dhe fuqi 120 megavatësh, ky kolos i detit do të jetë dy herë më i fuqishëm se secili nga pesë akullthyesit bërthamorë në shfrytëzim në botë - të gjithë të ndërtuar në Shën Petersburg dhe me port të ndalesës në Murmansk. Para dorëzimit të Lider-it të parë nga tre të porositur për vitin 2027, ndërmarrja shtetërore Rosatomflot do të ketë përgaditur tri anije të tjera bërthamore të rënda, të afta për të lëvizur gjatë gjithë vitit në Oqeanin Arktik duke hapur kanale në shtresat më të trasha të akullit, i ashtuquajtur projekt 22220.

Rusia shënon kështu kthimin e saj në oqean, me dëshirën për t'i dhënë një dimension të ri Rugës detare të Veriut. Rruga *Sevmorput*, lidhja kombëtare kryesore në kohën e Bashkimit Sovjetik, çdo herë e më tepër do të shndërrohet në një rrugë ndërkombëtare.

Gjashtë muaj më parë, më 14 korrik 2019, stacioni meteorologjik kanadez në bazën Alert, 900 kilometra larg Polit të Veriut, regjistroi një temperaturë prej 21 gradë celsius. Ky rekord ishte 15 gradë mbi mesataren e matur zakonisht në korrik, në këtë bazë të banuar që gjindet në pjesën më veriore të planetit tonë. Më pak anekdotik është raporti i fundit i Grupit ndërqeveritar të ekspertëve për ndryshime klimatike (IPCC) ku është shënuar ngrohja globale në Arktik me «*vlera dy deri në tre herë më të larta se mesatarja globale*», e cila tashmë ka vlerë një gradë¹.

Pasojat: Shtresa e akullit më vështirë po riformohet gjatë dimrit dhe ka tendencë të bëhet më e hollë dhe të mbuloj një sipërfaqe çdo herë e më të vogël në fund të verës (*shiko hartën përballë*). Më 18 shtator shtrirja e akujve të detit kishte sipërfaqen e dytë më të ulët të shënuar që nga viti 1979, pas asaj të vitit 2012². Sipas parashikimeve të IPCC, «*nëse ngrohja globale ka vlerë 1.5 gradë* «mund të ngjan «*një verë arktike pa akuj deti një herë në shekull*». Kjo frekuencë do të jetë «*së paku një verë në dekadë në rast të ngrohjes globale prej 2 gradësh*»

Ndërsa rritja e temperaturave është e padiskutueshme, e ardhmja e shtresës sipërfaqësore të akullit mbetet e pasigurt. Në Oqeanin Jugor, sipërfaqja e të cilit është njëzet herë më e madhe se sipërfaqja e Detit Mesdhe³, shkrirja e akullnajave bregdetare në mënyrë paradoksale do të thotë për momentin ruajtjen e akullnajave detare që rrethojnë kontinentin e ngrirë. Dhe rritja e reshjeve të borës gjithashtu mund të kompensojë një pjesë të shkrirjes së shtresës sipërfaqësore të trashë të akullit⁴.

Në sipërfaqen e oqeanit Arktik (pesë herë sipërfaqja e Mesdheut), një studim i fundit sugjeron që gati gjysma e ngrohjes globale mund t'i atribuohet gazërave të dëmshme për shtresën e ozonit- familja e kloro-fluorokarbureve të cilat kanë efekt të fuqishëm serrë⁵. Këto gazëra janë ndaluar gradualisht që nga protokoll i Montrealit në vitin 1987 dhe pritet të zhduken ngadalë gjatë pesëdhjetë viteve të ardhshëm. Në të kundërtën, nuk mund të neglizhohen rreziqet e ç'rregullimeve klimatike, sepse zvogëlimi i zonave detare dhe tokësore të mbuluara nga ngricat dhe dëbora zvogëlon pasqyrimin e rrezatimit diellor. Kështu, toka dhe oqeanet

e thithin më shumë rrezatimin, duke u ngrohur kështu, ndërsa shkrirja e permafrostit – që është tokë e ngrirë në mënyrë të përhershme edhe nën det – lëshon gazëra me efekte serrë të reja, në veçanti gazin metan.

Si konkludim, shtresa e akullit të detit do të bëhet sigurisht më e hollë dhe me sipërfaqe më të vogël në vitet e ardhshme. Kjo nuk do të thotë që anijet do të lundrojnë në ujëra të hapura në oqeanet polare. Do të formohen shtresa të akullit përsëri gjatë një pjese të mirë të vitit. Prandaj lind ky paradoks: sa më shumë do të shkrihet akulli i detit, aq më shumë do të rritet kërkesa për akullthyesa, siç shihet që nga mesi i viteve 2000. Këto anije do të mbesin të domosdoshme për një kohë të gjatë për zhvillimin e rrugëve polare, të cilat kanë përparësinë e shkurtimit të distancave midis shumë porteve të Paqësorit dhe Atlantikut.

Një udhëtim nga Roterdami në Yokohama, për shembull, përfshin 20.700 km kah kanali i Suez-it dhe vetëm 12.700 km nga rruga e Veriut⁶. Nga Nju Jorku në Shanghai, distanca detare është 19.600 km nëpër Panama kundër 14.500 km kah veriu i Kanadasë.

Ndarja si subjekt i debateve të mëvonshme

Kurrë më shumë nuk kanë lëvizur këto anije shërbyese më parë nëpër oqean: gjatë verës i dërgojnë turistët në polin e veriut nën diellin e mesnatës, ose në ngrica të natës polare në temperaturë minus 50°C. Flota e vetme bërthamore ruse hapi rrugën për 510 anije në vitin 2019, kundër 400 mesatarisht në dy vitet e mëparshme. Të gjitha anijet që lëvizin në detëra të ftohta duhet të kenë byk të përforcuar, kurse me termin «akullthyes» Shoqata ndërkombëtare e kompanive të klasifikimit definon anijet, masa, profili dhe fuqia e të cilave mundësojnë kalimin e një shtrese akulli prej së paku 70 cm trashësi. Makineritë më të rënda mund të mposhtin me shpejtësi të ultë akullin e formuar për disa vite, trashësia e të cilit mund të jetë më e madhe se 4 metra, si dhe vlera më të mëdha të presionit midis dy pllakave të akullit mbi dhjetë metra. Duke e bërë të mundur lundrimin dhe tregtinë detare në vendet e ftohta, këto anije përmeshin në radhë të parë një mision utilitar në grykën e lumit Saint-Laurent, në detin Baltik, në

detin e Bardhë ose në detin Okhotsk... Por janë gjithashtu anije të sovranitetit detar në rajonet polare të cilët po bëhen çdoherë e më shumë tërheqëse.

Në oqeanin Jugor, traktati i vitit 1961 i ka ngrirë pretendimet territoriale dhe lejon vetëm veprimtarinë paqësore kushtuar shkencës. Tridhjetë kombe mirëmbajnë baza shkencore për t'i studiuar zhvillimet klimatike dhe rrymat kryesore globale të oqeanit që formohen në këto ujëra. Sigurisht shumë prej tyre pozicionohen aty për të pasur eventualisht një ditë qasje në burimet natyrore.

Në ujërat ndërkombëtare të Arktikut, Rusia, Norvegjia dhe Danimarka kanë depozituar pretendimet e tyre për zgjerimin e zonave të tyre ekskluzive ekonomike në rrafshnaltën kontinentale - Kanadaja së shpejti do t'i dorëzoj të vetat. Ndarja e disa zonave dhe në veçanti të kreshtës së Lomonosovit pa dyshim që do të jetë temë e debateve të ashpra juridiko-politike. Këto pretendime marrin për bazë kornizën e Konventës

së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1994, dhe e cila ende nuk është ratifikuar nga Shtetet e Bashkuara. Në parim njohja e ligjeve të reja për shfrytëzimin e burimeve të nëntokës detare dhe të ujërave nuk ka pasoja të drejtpërdrejta në lundrimin i cili mbetet i lirë në ujëra ndërkombëtare. Megjithatë, kanadezët dhe rusët pajtohen për të caktuar një «vijë fillestare» që përfshin ngushticat kryesore në ujërat e tyre të brendshme, historike, me sovranitet të plotë. Shtetet e Bashkuara, të cilat pretendojnë se janë kampionët e lirisë së lundrimit, kundërshtojnë këtë vizion dhe i konsiderojnë këto kalime si ngushtica ndërkombëtare⁷, që nuk i përkasin askujt. Kanadezët dhe rusët mbështeten gjithashtu në «klauzën arktike» të kësaj Konvente mbi rreziqet e ndotjes dhe ruajtjen e mjedisit⁸, për të refuzuar kalimin e anijeve që nuk janë konformë me normat. Që nga viti i kaluar, çdo anije që dëshiron të kalojë nëpër Rugën e Veriut duhet t'i njoftojë së paku 45 ditë përpara autoritetet ruse, të cilat kërkojnë praninë e një piloti në bord ose edhe përcjelljen e një akullthyesi kur vlerësojnë se nevojitet për shkak të kushteve.

Kalimi i vështirë në Veri-Perëndim

Pesha e Rusisë në flotën botërore shpjegohet në radhë të parë nga historia, gjeologjia dhe klima. Erërat dhe rrymat e oqeanit, veçanërisht ujërat e ngrohta të atlantikut të veriut, kanë prirje të hapin më rregullisht kalimin verilindor, përtej Siberisë. Në mes të labirinthit të ishujve borealë të Kanadasë, kalimi Northwest do të mbetet i vështirë për t'u kaluar për një kohë të gjatë. Në atë vend kanë ndodhur disa drama para suksesit të norvegjezit Roald Amundsen (midis viteve 1903 dhe 1906), dhe kjo rrugë është shfrytëzuar shumë rrallë para viteve 2000. Nga ana tjetër, suedezi Otto Nordenskjöld kaloi tërësisht rrugën detare të Veriut (nga Norvegjia deri në ngushticën e Beringut) qysh në vitin 1878 dhe 1879.

Epika të shumta sovjetike - dhe disa aksidente – ndodhën në rrugën *Sevmorput*, një front pionier për zhvillimin e pjesës aziatike të vendit. Në vitin 1932, akullthyesi Sibiriakov realizoi lidhjen e parë në një sezon të vetëm midis Arkhangelsk dhe Yokohama (Japoni). Nga mesi i viteve 1930, bregu i veriut priti vizitorë rregullisht gjatë verës. Rruga detare

Edhe Arktiku pëson nga pohimet e sovranitetit në një klimë të mosbesimit në rritje. Në muajin gusht të vitit 2007, një nëndetëse ruse u zhyt në Polin e Veriut, në thellësi 4,261 m, për të ngulur një flamur me ngjyrë bardhë-kaltër-kuq nga materiali titan i inoksidueshëm. Aeroplanët luftarak *Mig* rregullisht patrollojnë mbi Polin e Veriut. Ishulli Kotelný, i braktisur në vitin 1993, tani mirëpret një bazë të re, kurse ishulli Nagurskoye, në territorin François-Joseph, u zgjerua. Në muajin shtator të vitit 2018, manovrat më të mëdha në historinë post-sovjetike kanë mobilizuar në lindjen e largët të Rusisë 300,000 burra, përfshirë burrat e flotës veriore, me pjesëmarrjen e Kinës dhe të Mongolisë. Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara mobilizuan 50,000 njerëz me aleatët e tyre të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) për të organizuar operacionin «*Trident Juncture*» në veri të Norvegjisë në tetor 2018. Dhe, në fund, kur më 18 gusht Presidenti Donald Trump propozoi të blinte Groenlandën, ai shprehu, me vulgaritetin e tij të zakonshëm, një interes në rritje dhe gjerësisht të ndarë për burimet e mundshme minerale të rajonit.

Lindje-Perëndim i plotëson rrugët lumore Jug-Veri të lumenjve kryesorë të Siberisë, Obi, Yenisei, Lena dhe Kolyma, ku nuk ka akull gjatë verës. Për të siguruar eksploatimin e burimeve të minierave të Siberisë dhe të Lindjes së Largët me një autonomi të pakrahasueshme prej disa muajsh, një akullthyes i parë bërthamor, *Lenini*, doli në det në vitin 1959, ku mbeti në shërbim deri në vitin 1989. Më 14 gusht 1977, njëri nga pasardhësit e tij, *Arktika*, u bë anija e parë sipërfaqësore që arriti në Polin e Veriut. Një vit më vonë, pjesa perëndimore ishte hapur gjatë tërë vitit deri në Dikson, afër grykës së Jeniseit. «*Në fillim të viteve 1970, BRSS kishte 138 anije ngarkese të klasës «akull» në pellgun e Arktikut*», thotë historiani Pierre Thorez. «*Në fund të periudhës sovjetike [kjo shifër] ishte afër 350, të cilave duhej shtuar 16 akullthyesë për udhëtime të gjata, përfshirë 8 me energji bërthamore*».

Trafiku kulminoi gjithashtu në fund të viteve 1980 me 7 milion tonelata, kryesisht thëngjill, naftë, lëndë druri dhe minerale. Ai u minimizua pas rënies së BRSS-së për të arritur një

* Gazetare.

prag prej 1.5 milion tonelata në vitin 1998. Numri i banorëve në këto rajone jomikëpritëse përcjell këtë rënie marramendëse. “Doktrina detare” e paraqitur në vitin 2001 nga presidenti Vladimir Putin synon të ndërroj kahjen e këtij zhvillimi. Pas një ngritjeje të ngadaltë, vëllimi i mallrave të transportuara e kaloi nivelin e vitit 1989 vetëm në vitin 2017, para se të arrinte gati 20 milion tonelata në vitin 2018 dhe më shumë se 31 milion tonelata në vitin 2019¹⁰. Kjo rritje e papritur mund të shpjegohet para së gjithash me eksploatimin e fushave gjigande të gazit në gadishullin Iamal, në grykën e lumit Ob. Rreth pesëmdhjetë transportues të metanit të klasit «akull» sapo kanë filluar transportin e këtij gazi të lëngëzuar në Evropë veriore dhe në Azi. Valorizimi i këtij burimi të konsiderueshëm¹¹ ka qenë i mundur vetëm me ndihmën teknike dhe financiare të perëndimit dhe të kinezëve. Ndërmarrja joint venture Yamal LNG, e cila operon në vend dhe furnizon anijet me pajisje dhe personel, ka si aksionarë në 20% francezin Total, 20% PetroChina dhe 9.9% Fondin e Rugës së Mëndafshit, një fond sovran kinez. Megjithatë, pjesa më e madhe e kapitalit (50.1%) mbetet nën kontrollin e kompanisë ruse Novatek.

Rregullisht, lajmërohen investime massive: rinovime ose zgjerime të porteve, aeroporteve, hekurudhave, etj. Akullthyesit figurojnë në toplistë me projektet *Lider* dhe 22220. Akullthyesi i ri *Arktika*, si dhe *Urali* dhe *Sibiri* do të dalin në det respektivisht në vitin 2020, 2021 dhe 2022. Përveç fuqisë së tyre të pakrahasueshme, dizajni i tyre original u mundëson ta rregullojnë lartësinë e pjesës së zhytur të anijes me anë të ballastëve për të qarkulluar në grykëderdhjet e lumenjve me ujëra më të cekëta. Pas lansimit të një plani zhvillimor për Rugën detare të Veriut në fund të vitit 2019, Kryeministri i ri Mikhaïl Mishustin njoftoi më 30 janar votimin e një ligji për stimulime fiskale për investimet përtej rrethit arktik. Objektivi i deklaruar kalon 200 miliardë euro deri në vitin 2030¹², me ambicien për të arritur trafikun prej 80 milion tonelata në vitin 2024, dhe dyfishin një dekadë më vonë. Një plan shumë i guximshëm, derisa sot rruga Sevморput “*ka interes vetëm për trafikun e mallrave refuz që lidhen me eksploatimin e hidrokarbureve dhe burimeve minerale*” specifikon z. Hervé Baudu, profesor i shkencave detare në Shkollën e lartë kombëtare detare të Marsejës¹³. Edhe pse udhëtimi i anijes kontenjerëshe Vanta Maersk, e ngarkuar me peshk rus dhe komponente elektronike koreane u mediatizua gjerësisht në shtator 2018, në fakt shkëmbimet në këtë rrugë përbëjnë kryesisht transportin e lëndëve të para në mes Rusisë dhe vendeve tjera, ose midis porteve ruse. Ka shumë pak tranzit të mallrave, më pak se 30 anije në vit në tre vitet e kaluara. Në vëllim, kjo përfaqëson më pak se 3% të trafikut në Rugën e Veriut dhe tre mijë herë më pak sesa tranziti përmes Kanalit të Suezit.

Në anën tjetër të oqeanit arktik, nuk shfaqet asnjë perspektivë e zhvillimit madhor në planin afatmesëm: “*Kanada, sikurse Shtetet e Bashkuara, vështirë gjejnë fonde dhe ambicie politike për të zhvilluar një flotë akullthyesëshe në nivel të pretendimeve të tyre detare*”, analizon Hervé Baudu¹⁴.

Flota kanadeze ka rreth pesëmbëdhjetë anije, por e vetmja që konsiderohet “e rëndë”, anija *Louis Saint-Laurent*, lundron që nga viti 1969, dhe ka për mision kërkimin shkencor dhe furnizimin e komuniteteve autoktone inuite. Nuk mund të krahasohet me anijet ruse: nuk ka autonomi të mjaftueshme as infrastrukturë për të qëndruar në oqeanin arktik. Paaftësia e këtij vendi të madh verior për të siguruar sovranitetin në detërat e ngrira shpesh ceket si shqetësim në parlament ose në media. Në gusht 2008, kryeministri Stephen Harper gjatë një vizite në Inuvik njoftoi se në vitin 2017 do të fillonte ndërtimi i një anijeje të fuqishme, të emërtuar *John Diefenbaker*. Sipas lajmeve të fundit, ende nuk është gjetur buxheti prej 1.3 miliardë dollarësh kanadezë (900 milion euro)... Prioritet iu dha anijeve më të vogla për mirëmbajtjen e rrugës detare të lumit Saint-Laurent. Proqesi i shkrirjes së akullit të liqenit Lac Supérieur deri te Ishujt e Atlantikut mobilizon shumë akullthyesë të lehta në dimër. Inauguruar në vitin 1959, ky rreshtim i kanaleve dhe ekluzave gjigande luan një rol ekonomik të pakrahasueshëm me rajonet arktike. Megjithëse në rënie që nga vitet 1970, trafiku në pjesën e lumit përfshinte ende 41 milion tonelata në vitin 2018.

Edhe pse dy fqinjët e Amerikës Veriore bashkëpunojnë në Liqenet e Mëdha, liria e qarkullimit mbetet burim mosmarrëveshjeje. Pas zbulimit të naftës në Alaskë, Uashingtoni testoi qysh në vitin 1969 lundrueshmërinë e

rrugës me anijen *Manhattan*, një anije cisterne e përforcuar me gjatësi 300 metra dhe 100,000 ton zhvendosje. Një vit më vonë në Otava miratohet një ligj për parandalimin e ndotjes në Arktik, i cili përcakton standardet për anijet që mund të kalojnë nëpër këto ujëra. Një incident diplomatik gati është shënuar kur *Polar Sea*, një akullthyes i rëndë i gardës bregdetare të Shteteve të Bashkuara (tani jashtë përdorimit), nisi rrugëtimin në vitin 1985. Në pamundësi për ta ndaluar, Kanada e autorizoi të kaloj, por kup-toi dobësinë e flotës së saj vetanake. Përballë shtimit të inkursioneve nga nëndetëset e huaja, ministria e mbrojtjes në vitin 1987 planifikoi gjithashtu blerjen e një nëndetëseje sulmuese bërthamore në Francë ose në Britani të Madhe. Vitin tjetër, Uashingtoni angazhohet me një traktat që “*të gjitha lëvizjet e akullthyesve amerikane nëpër ujërat që Kanada i rivendikon si ujëra të saj të brendshme do të bëhen me pëlqimin e Qeverisë së Kanadasë*”¹⁵. Por teksti saktëson se “*asgjë në këtë marrëveshje bashkëpunimi midis miqve dhe fqinjëve*” nuk ndikon në pozicionet përkatëse “*për ligjin e detit në lidhje me këtë zonë ose me ndonjë zonë detare*”. Njoftimi për blerjen e një nëndetëseje nuk u sendërtua, siç ishte rasti për njoftimin e vitit 2007 për ndërtimin e një porti në ujërat e thellë në Nanisivik për të lehtësuar patrullimet e rojes bregdetare në atë zonë. Dhe përfundimisht, vetëm një stacion i thjeshtë karburanti planifikohet të hapet verën e ardhshme në veri të ishullit Baffin.

Kërcënime të rënda peshojnë mbi këtë ekosistem të brishtë

Flota amerikane duket edhe më e dobët se flota kanadeze. Anija më e fuqishme, *Polar Star*, doli në det 44 vjet më parë! Sistemi shtytës mikst me naftë dhe gaz nuk mundëson autonomi të njëjtë sikurse motorët bërthamor. Anija *Healy*, e lansuar në vitin 1999 për kërkime shkencore, ka qenë anija e parë sipërfaqësore amerikane që arriti në polin e veriut në vitin 2015, tridhjetë e tetë vjet pas rusëve. Por, në shkurtin e kaluar, komandanti i rojes bregdetare zbuloi se kjo anije po lundronte në Arktik “*pa komunikime të besueshme gjatë një pjese të madhe të patrullimit të saj disa muajshe*” për shkak të mungesës të releve tokësore dhe të mbulimit të mirëfilltë satelitor në këto gjerësi gjeografike¹⁶. Admirali Karl Schultz ishte optimist, megjithatë, kur deklaroi se ishte në rrugën e duhur financimi i tre akullthyesëve të rinj të rëndë, që do të mund të lundrojnë në Oqeanin Arktik në çdo stinë, të cilët ishin pritur për shumë kohë. Por vetëm njëri projekt është buxhetuar, dhe ende nuk është votuar në Kongres...

Nuk duket se shfaqja e Kinës në skenën e Arktikut po i përshpejton gjërat. Më 14 gusht 1999, kur *Xue Long* (Dragoi i borës), një akullthyesë që Pekini e ka blerë nga Ukraina, ndaloi në portin e vogël të Tuktoyaktuk, u shqetësuan banorët e këtij fshati inuit në Territorët Veriperëndimore. Megjithëse administrata kanadeze ishte paralajmëruar, ajo nuk e kishte komunikuar si duhet informatën¹⁷. Kur kjo akullthyesë lundroi në kalimin Verilindor, në verën e vitit 2012, ishte

e shoqëruar nga njëra anije ruse me energji bërthamore, *Vaygach*... Shtatorin e kaluar, *Xue Long II*, i prodhuar në Shanghai, i është shtuar kësaj floteje. Edhe pse paraqitet si një anije për hulumtime shkencore, ajo simbolizon projektin “Rruga polare e mëndafshët” e cila ishte paralajmëruar nga Kina në librin e saj të bardhë mbi Arktikun në janar 2018.

Importuesi më i madh në botë i lëndëve të para po tregon interes në rritje për burimet e hidrokarburëve të Rusisë, si dhe për potencialin minerar të Kanadasë, Groenlandës dhe Islandës. Disa projekte të anijeve u diskutuan në Pekin dhe, në qershor 2018, Kompania Kineze Bërthamore bëri një thirrje për tenderim për ndërtimin e një akullthyesi bërthamor prej 30 000 ton¹⁸, anije të ngjajshme ka vetëm në Rusi. Një anije e tillë do të ishte gjithashtu një platëformë testuese për ndërtimin e një transportuesi aeroplanësh me energji bërthamore, fushë në të cilën Shtetet e Bashkuara kanë një avantazh të thellë me njëmbëdhjetë anije – anija e vetme tjetër në botë është anija franceze *Charles-de-Gaulle*.

Më në fund, në vitin 2002, Bashkimi Evropian shprehi ambicien e madhe për rajonet polare me projektin *Aurora Boréalis*, “*akullthyesin më i madh i të gjitha kohërave*”. Tetëmbëdhjetë vjet më vonë, projekti nuk ka përparuar asnjë grimë... Shumë vende të tjera janë të pajisura, por me ambicie shumë më modeste, sikurse vendet



e Gjirit të Finlandës dhe të Botnisë (Suedia, Finlanda, Estonia), që kanë sipërfaqe të mbuluara me një shtresë të hollë akulli çdo dimër. Edhe Norvegjia dhe Danimarka kanë nevojë për anije mbështetëse për lidhjet e tyre përkatëse me Svalbardin dhe Groenlandën. Shumica e anijeve të tjera përdoren për hulumtime dhe për lidhjet me kontinentin antarktik, siç janë anijet e reja të Kilisë, Afrikës së Jugut dhe Australisë. Përtej kontinentit të ngrirë, shihet gjithashtu rregullisht e vetmja anije argentinase dhe homologët e saj nga Evropa (Italia, Spanja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar) ose Azia (Japonia, Koreja e Jugut, India). Franca aktualisht pajisë një akullthyesë të vetme, *Astrolaben*, e cila prej vitit 2017 siguron komunikimin dhe furnizimin e pronave franceze në Oqeanin Indian (ishujt Kerguelen, Saint-Paul, arkipelagun Crozet) dhe bazave polare Dumont d’Urville dhe Concordia. Sidoqoftë, turistët mund të rezervojnë udhëtimet e tyre të ardhshme në anijen *Commander Charcot*. Kjo anije me gjatësi 150 metrash, me turbina me gaz dhe motorë elektrikë, do të jetë në gjendje të transportojë 270 pasagjerë në Veriun e Largët gjatë verës dhe në Jugun e Largët në dimër. Punimet do të përfundojnë vetëm në vitin 2021 (në Rumania, pastaj në Norvegji), por ndërmarrja Ponant tashmë është duke “*imagjinuar udhëtimin e së nesërmës*” me “*luksin diskret francez*”.

Në një fjalim të famshëm në Murmansk më 1 tetor 1987, sekretari i përgjithshëm i fundit i partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, Mihail Gorbacovi, kishte propozuar një rrugë paqësore të bashkëpunimit në Veriun e Largët bazuar në besimin e ndërsjellë. Sipas tij, siguria nuk mund të sigurohet vetëm me mjete ushtarake dhe në këtë rajon armët bërthamore duhet të jenë të ndaluara. Në vitin 1996 krijimi i Këshillit të Arktikut për mbrojtjen e këtij mjedisi veçanërisht të brishtë iu përgjigj pjesërisht këtij vizioni. Ky forum diskutimesh në mes të gjitha vendeve që zotojnë toka në veri të rrethit arktik u hap më pas për komunitetet autoktone dhe për vendet e mëdha evropiane dhe aziatike, në cilësinë e vëzhguesve.

Përkundër tensioneve të kohëpas-kohshme, Norvegjia dhe Rusia e kanë treguar shembullin duke nënshkruar në prill 2010 një marrëveshje për ndarjen e zonave të diskutueshme në Detin Baren. Këshilli i Arktikut ka mundësuar disa marrëveshje të rëndësishme, sidomos në vitin 2013 për kërkimin dhe shpëtimin e anijeve dhe aeronefëve. Një shembull tjetër është marrëveshja ndërkombëtare që ndalon çdo veprimtari tregtare të peshkimit në ujërat ndërkombëtare në Oqeanin Arktik qendror, nga 15 marsi 2019 dhe për të paktën 16 vjet. Nënshkruesit nga i gjithë rajoni - vendet bregdetare plus Bashkimi Evropian, Kina dhe Japonia - angazhohen në një program të përbashkët të monitorimit dhe të kërkimit për të përcaktuar nëse

peshkimi i qëndrueshëm do të jetë i mundur ndonjëherë. Por ende jemi larg një traktati Arktik i cili do të ishte ekuivalent me traktatin Antarktik. Kërcënimet e mëdha ndaj ekosistemit gjithsesi duhet të na bëjnë të reflektojmë. Por Këshilli i fundit i Arktikut i cili u mbajt në Finlandë në maj 2019 nuk ishte në atë frymë. Takimi nuk përfundoi me një deklaratë të përbashkët, pasi që Shtetet e Bashkuara refuzuan që ngrohja globale të ceket si një “*kërcënim serioz*” për rajonin dhe prania kineze në atë takim ishte për ta e dyshimtë.

Shkrija e akullnajave të polit, në pikën e konvergencës së drejtimeve kardinale, ngjallë një ëndërr të vjetër të Rilindjes: përafrimi midis Lindjes dhe Perëndimit, i simbolizuar nga projeksioni polar i botës i paraqitur në flamurin e Kombeve të Bashkuara. Në aspektin praktik, shumë pengesa do të frenojnë ende zhvillimin e këtyre rrugëve: numri i vogël i porteve strehuese, thellësia e vogël e ngushticave, hidrografia jo e plotë, asistenca për lundrimin e pasaktë në këto gjerësi gjeografike, mbrojtja e ngarkesave dhe pajisjeve kundër të ftohtit, shpenzimet shoqëruese dhe të sigurimëve... Në këtë kontekst blerja e një floteje të shtrenjtë akullthyesish efektiv është një bast për të ardhmen. Kina synon mbi të gjitha diversifikimin e rrugëve tregtare dhe të furnizimit energjetik. Është prioritet kombëtar për Rusinë, e cila kërkon të garantojë eksportin e lëndëve të para të saj. Në rrugë për t’u bërë prodhuesi kryesor i gazit në botë, tani ky vend garon me Shtetet e Bashkuara në këtë treg ndërsa kundërshton hegjemoninë e tij detare, së paku në detërat e ftohta.

1 «Raporti special i GIEC mbi pasojat e ngrohjes globale me 1,5°C sipas niveleve paraindustriale», Organizata Meteorologjike Botërore, Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, 2019.

2 Arctic report card 2019, Agjencia Qeveritare Meteorologjike e Shteteve të Bashkuara, www.arctic.noaa.gov

3 Sipas konventës, oqeani Austral bashkon ujërat e jugut të gjerësisë gjeografike 60° , dmth një sipërfaqe prej 20 milion km², përkundër 12 milion km² për oqeanin Arktik.

4 Cf. «L’Antarctique, un équilibre fragile», Météo France, 2020.

5 L. Polvani (coll.) “Substantial twentieth-century Arctic warming caused by ozone-depleting substances”, *Nature Climate Change* n° 10, shkurt 2020.

6 Distancia të llogaritura në webfaqjen https://app.aqua-plot.com

7 Hélène de Pooter, *L’emprise des États côtiers sur l’Arctique*, éd. Pedone, Paris, 2009.

8 Artikulli 234 mbi «zonat e mbuluara me akuj».

9 Pierre Thorez, «La Route maritime du Nord, Les promesses d’une seconde vie», *Le Courrier des pays de l’Est*, n° 1066, mars-prill 2008.

10 “NSR Shipping traffic-transits in 2019”, Centre for high north logistics, arctic-lia.com

11 Lexo «Iamal, un océan de gaz dans la Russie arctique», *Le Monde diplomatique*, korrik 2016.

12 Atle Staalesen, “Moscow outlines a €210 billion incentive plan for Arctic oil”, *The Independant Barents Observer*, 5 shkurt 2020.

13 Hervé Baudu, «La Route maritime du Nord, réalité et perspectives», *Regards géopolitiques*, n° 5, vjeshta 2019, Këshilli i kuebëkut të studimeve gjeopolitike, Univerziteti Laval, Québec.

14 Hervé Baudu, «La Flotte mondiale de navires brise-glaces», *Regards géopolitiques*, n° 4, dimri 2018.

15 Marrëveshja në mes qeverisë së Kanadasë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara mbi bashkëpunimin në Artik, 11 janar 1988.

16 Arctic Today, 21 shkurt 2020.

17 Sébastien Pelletier dhe Frédéric Lasserre, «Interesi i Kinës për Arktikun: analiza e incidentit mbi kalimin e akullthyesit Xue Long në vitin 1999 në Tuktoyaktuk, Territorët e Veri –Perëndimit», *Monde chinois*, 2015.

18 “Why is China building a 30,000-ton nuclear-powered icebreaker?”, China Military online (site de l’Armée populaire de libération), 2 korrik 2018.

MARRËVESHJA (JO)PAQËSORE

Tatëpjeta amerikane në Afganistan

Marrëveshje e çuditshme midis talibanëve dhe Uashingtonit, që konfirmon tërheqjen e trupave amerikane, me pak ose aspak kundërvlerë për të parët. Sa i përket pushtetit të Kabulit, ai është në qorrrokak. As sekretari i Shtetit Mike Pompeo, me vizitën e tij të shkurtër më 23 mars, nuk arriti ta nxjerrte nga kriza. Pasojat: Shtetet e Bashkuara shkurtuan ndihmën në 1 miliard dollarë (nga 5).

NGA GEORGES LEFEUVRE *

Më 29 shkurt, z.Zalmay Khalilzad për Shtetet e Bashkuara dhe mullahu Abdul Ghani Baradar për talebanët, nënshkruan më në fund në Doha, marrëveshjen të cilën e negocionin që nga shtatori 2018. Marrëveshje e paqes? Larg prej saj. Keqpërdorimi i fjalës «paqe» që nga fillimi i procesit ka shtrembëruar analizën dhe ka krijuar shpresa false. Kur u njoftua nënshkrimi, shumë afganë vallëzuan nga gëzimi, për t'u zhgënjyer të nesërmën kur talebanët rifilluan luftimet...

Në të vërtetë, asnjëherë nuk ishte çështje e negociimit të paqes - një ushtrim i pamundur pasi që qeveria afgane ishte e përjashtuar nga negociatat - por për gjetjen e kushteve për tërheqjen e forcave amerikane, pa shumë ndershmëri dhe në një mënyrë imperative, pasi që ishte një premtim fushate, që Presidenti Donald Trump e kishte ripohuar me zë të lartë në dhjetor 2018.

Qëllimi ishte gjithashtu që talibanët të pranojnë katër lëshime: armëpushimin, negociata me qeverinë e Kabulit, zotim që kurrë asnjë sulm nuk do të nxitej kundër Shtetit e Bashkuara nga toka afgane dhe garanci sigurie për tërheqjen graduale të trupave amerikane.

Nëse z.Khalilzad, me prejardhje afgane, nuk kurseu asnjë përpjekje, ai nuk mori pothuajse asgjë nga delegacioni i talibanëve, që nga bllokada e parë në janar 2019. Duke e përmbytur rendin e gjërave, mullahu Baradar kishte refuzuar gjithnjë një armëpushim, para tërheqjes së trupave amerikane dhe çfarëdo dialogu me një qeveri të quajtur «kukull». Talibanët pranuan vetëm ta garantojnë sigurinë e largimit të trupave amerikane dhe zotimin për ta ndërprerë mbështetjen për grupet terroriste. Natyrisht, deklarata e dhjetorit 2018 kishte ndryshuar raportin e forcave në dëm të delegacionit të tij, pasi që Presidenti Trump atëherë shfaqti dëshirën e tij për t'i dhënë fund kësaj çështje, para se të hynte në fushatën për rizgjedhjen e tij në nëntorin e ardhshëm

LËSHIME SHUMË TË VOGLA

Në rrugët e Kabulit, ngazëllimi (modest) popullor nuk zgjati shumë. Talibanët nuk ndaluan ta shprehnin ndjenjën e tyre të fitores. Armëpushimi që duhej të ishte parakusht u zëvendësua me një javë të shkurtër të «uljes së dhunës» (sic) para nënshkrimit, ndërsa dialogu i brendshëm afgan nuk u bë realitet. Modalitetet praktike të marrëveshjes tregojnë se lëshimet e bëra nga amerikanët zënë më shumë

hapësirë në tekst, sesa ato të pranuar nga kundërshtarët e tyre, të cilat nuk janë shumë të detyrueshme dhe janë të pasaktësuar.

Propozimi fillestar i z.Trump ishte të tërhiqte shpejt gjysmën e trupave të tij, gjysmën tjetër në katër ose pesë vjet e ardhshme; trupat e anëtarëve të tjerë të koalicionit ndërkombëtar - më shumë se tetë mijë ushtarë - duhej të mbeteshin për aq kohë sa ishte e nevojshme, për ta siguruar trajnimin e ushtrisë afgane.

Mirëpo, në marrëveshjen përfundimtare, Uashingtoni premtonte të tërheq të gjithë ushtarët për katërm-bëdhjetë muaj, si dhe të gjithë civilët jodiplomatikë, agjentët privatë të sigurimit, këshilltarët, trajnuesit etj., sipas një orari të ngushtë: një qind e tridhjetë e pesë ditë për të larguar pesë baza ushtarake dhe për ta zvogëluar stafin e tyre për një të tretën. Çuditërisht, marrëveshja e nënshkruar vetëm nga Shtetet e Bashkuara detyron edhe vendet e tjera të koalicionit ta bëjnë të njëjtën gjë dhe në të njëjtin proporcion. Pjesa tjetër e trupave duhet të largohet brenda nëntë muaj e gjysmë të ardhshëm.

Amerikanët u zotuan gjithashtu - në emër të qeverisë afgane e cila nuk u konsultua - të lirojnë 5,000 të burgosur talebanë «para 10 marsit», të heqin sanksionet para 27 gushtit dhe ta pastrojnë listën e talebanëve, koka e të cilëve është vënë në çmim. Asnjë nga këto pika nuk është realizuar deri më tani.

Në këmbim të angazhimeve shumë kufizuese amerikane, lëshimet e talebanëve duken shumë të lehta dhe shumë të paqarta. Ata pranojnë të negociojnë me «palët afgane» («Afghan sides»), por teksti nuk saktëson se cilat janë ato «palë», pasi që talebanët nuk e njohin qeverinë e Kabulit. Sa i përket armëpushimit, ai do të jetë vetëm një element në kalendarin për negociatat në fjalë. Garantimi i sigurisë së tërheqjes së trupave është në interesin e tyre, pasi që është në zemër të asaj që ata e quajnë fitore të tyre.

Nga ana tjetër, zotimi i tyre për t'u prishur me Al-Qaida është shumë më i dyshimtë, pasi që numri dy i kryesisë ekzekutive së talibanëve nuk është askush tjetër se z.Seraj Haqqani, djali i Jallaluddin Haqqani, ish-kreu i rrjetit terrorist me të njëjtin emër. Ai e luan rolin e ndërlihdhësit të Al-Qaidës brenda kësaj kryesie, si trashëgimtari familjar i mullah Omarit: ky i kishte ofruar Osama bin Ladenit mundësinë e vendosjes së bazës së tij të parë që në vitin 1986 në Djadi, një nga çifligjet Haqqani. Pastaj e kishte mundësuar zhvillimin e Al-Qaida, kur të ardhurit nga Çeçenia, Uzbekistani dhe Xinjiang (Kina) ishin vendosur në zonat e tij të ndikimit (Paktya në Afganistan dhe Waziristan në Pakistan). Por e tërë



kjo ndoshta nuk është shqetësuese në sytë e talibanëve. Gjatë negociatave në Doha dhe përmes faqes së tyre zyrtare, Voice of Jihad, ata pohuan gjithashtu se tani ishin të angazhuar në luftën kundër terrorizmit, pasi që luftojnë pa kompromis kundër Organizatës së Shtetit Islamik.

Ekziston një hendek i tillë midis realitetit pa zgjidhje të kësaj marrëveshje dhe entuziazmit të mediave që e shfaqëruan atë - disa tituj mediatik garojnë midis tyre për të theksuar se «Afganistani nuk ka qenë kurrë aq afër paqes» - sa «bashkësia ndërkombëtare» dhe të njëjtat media u stepën kur talebanët rifilluan luftimet që me 1 mars.

Portali amerikan Long War Journal flet për 147 sulme në 27 nga 35 krahinat midis 1 dhe 10 marsit. Por, sipas marrëveshjes, sulmet kursyen ushtarët e huaj, sepse ishin zotuar për këtë! Në versionin pashtun të Voice of Jihad, një fetva (shpallje fetare) rikujton se «talibanët do ta vazhdojnë xhihadin deri në krijimin e miratit të tyre Islamik të Afganistanit».

Në ndërkohë, Presidenti afgan z.Ashraf Ghani i tërbuar nga moskonsumimi i tij, refuzoi fillimisht t'i liroj 5.000 të burgosurit. Pastaj vendosi t'i liroj disa prej tyre, por gradualisht: 1.500 në masën e 100 lirimeve në ditë nga 7 Marsi, pastaj 3.500 në masën 500 lirimeve çdo ditë javë, pas fillimit të negociatave për të cilat janë zotuar talibanët. Këta të fundit refuzojnë dhe pohojnë se nuk do të ketë negociata me regjimin e Kabulit para lirim të të gjithë të burgosurve.

Tri javë pas nënshkrimit, marrëveshja e Doha mbetej e bllokua në një qorrrokak tjetër, të ngjashëm me atë të vitit 2014. Kjo përsëritje e historisë hedh dritë mbi të keqen që pllakosin Afganistanin. Asokohe bëhej fjalë për tërheqjen e trupave nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), e cila duhej të paraprihej nga një «marrëveshje bilaterale e sigurisë» (BSA). Një situatë pak a shumë e krahasueshme me të sotmen për tërheqjen e forcave të mbetura të armatosura. Atëbotë ajo marrëveshje ishte në mes të zgjedhjeve presidenciale shumë kaotike. Sipas Kushtetutës, Presidenti në largim, z.Hamid Karzai, nuk mund të rizgjedhej për një mandat të tretë. Për këtë arsye, ai pati refuzuar ta nënshkruajë BSA, që të mos ia ngarkonte këtë përgjegjësi pasardhësit të tij. Por, procesi zgjedhor kishte zgjatur tetë muaj dhe z.Ghani dhe z.Abdullah Abdullah luftonin ashpër për fitoren zgjedhore. Tetë muaj, gjatë së cilit pushteti ekzekutiv afgan ishte në përplasje totale, duke privuar amerikanët nga çdo bashkëbisedues.

Në kohën kur po shkruhet ky shkrim, të njëjtët njerëz po luftojnë për rezultatet e zgjedhjeve të 28 shtatorit 2019, duke rezultuar në një pafuqi të mëtejshme ekzekutive. Përdërisa negociatori amerikan, z.Khalilzad, po angazhohet për ta

zgjidhur krizën; talebanët po ngazëlleshën: ata nuk kanë bashkëbisedues për negociatat e planifikuara të cilat duhej të fillonin më 10 mars. Dhjetë ditë më vonë, loja mbetet e bllokua.

TËRHEQJA PA LAVDI

Si gjithmonë, një zgjidhje qoftë edhe e brishtë do të gjindet. Por këto dy qorrrokaqe shprehin dy thyerjet që pllakosin Afganistanin. Ajo e zonave pashtune që ushqejnë kryengritjet me të cilat ushqehen talebanët; mosmarrëveshja e përsëritur midis z.Ghani dhe z.Abdullah reflekton çarjen

territoriale: Veriu jopashtun i vendit është çerdhja elektorale e z.Abdullah, ish-shoqëruesit të komandantit Ahmed Chah Massoud, përkrahësit e të cilit janë lodhur nga pesha e tepërt politike pashtune për më shumë se dy shekuj; si dhe çerdhja elektorale e z.Ghani, edhe nëse i tejkalon ndarjet etnike, natyrisht se është në zonën fisnore pashtune, prej nga edhe buron fisi i tij Ahmadzai.

Këto janë realitete të historisë dhe antropologjisë politike, të cilat si të tilla shpjegojnë rezistencën e kryengritësve. Strategët amerikanë i kushtuan shumë pak vëmendje. E z.Trump edhe më hiq. Një qasje antropologjike për pajtimin e kombit afgan, nëse jo magjik, të paktën do të pengonte kthimin e madh të talebanëve.

Por kjo është çështje e kryer: marrëveshja e Doha nuk është marrëveshje paqeje. Ajo vetëm përcakton tërheqjen e palavdishme nga një vend që ka derdhur shumë gjak, si dhe mundëson kthimin në fuqi të atyre që ushtritë më të fuqishme të botës - me Shtetet e Bashkuara në krye të një koalicioni prej tridhjetë e tetë vendeve - duhej të gjunjëzonin.

Rrëmujë, gënjeshtëri, paaftësi...

Më 9 dhjetor 2019, Washington Post zbulonte «Afghanistan Papers», mijëra faqe intervista me zyrtarë të lartë amerikanë, të cilët u intervistuan në mes të 2014 dhe 2018, nga Zyra e Inspektorit Special të Përgjithshëm për Rindërtimin e Afganistanit. Ato zbulonin prapaskenat e luftës së zhvilluar në këtë vend që nga viti 2001.

«Për sa i përket pajisjeve dhe shpenzimeve, Kongresi na jepte ato që kërkonte administrata... Ideja ishte që nëse nuk do të shpenzonim, Government Accountability Office [Zyra e Auditorit të Kongresit] ose një komitet tjetër i Kongresit do të na pengonte të siguronim më shumë fonde. Kjo bëri të shpenzojmë, shpenzojmë, shpenzojmë (...)Ne investonim në projekte të mëdha infrastrukturore, vetëm për të treguar se mund t'i shpenzonim paratë që na ishin ndarë. Dhe po ndërtonim një infrastrukturë që afganët nuk mund ta mbanin kurrë, madje as ta përdorin.» Z.Douglas Lute, Zv.Këshilltar i Sigurisë Kombëtare për Irakun dhe Afganistanin gjatë kushteve të Presidentëve George W. Bush dhe Barack Obama: «Kur shkuam në Afganistan [më 2009], kishte vetëm një oficer i Forcës së Ndihmës Ndërkombëtare të Sigurisë që dinte të fliste në dialektin dar... por ai qëndroi vetëm për një kohë të shkurtër. Forcat Ajrore e Shteteve të Bashkuara e zhvendosen në Japoni përgjatë korrikut... Kjo ishte qesharake sepse ilustronte se sa i çmendur është sistemi. (...) Edhe sot, ne jemi në Afganistan dhe më tregoni se sa ushtarë, politikanë ose diplomatë dijnë të flasin në dialektet dari ose pashto? Është e turpshme dhe ky është një vendim politik.»

-Michael Flynn, ish-drejtor i shërbimit të intelligence të NATO-së në Afganistan.

“Mjerisht, projekti ynë më i madh dhe natyrisht fatkeqësisht, mund të ketë qenë zhvillimi i korrupsionit masiv. Fenomeni ka arritur përmasa të tilla, sa që është jashtëzakonisht e vështirë, nëse jo e pamundur, të ndalet sot.”

-Ryan Crocker, ish-ambasadori amerikan në Afganistan (2009-2012).

“Në fund, çfarë kemi marrë pasi shpenzuam 1000 miliardë dollarë? A e vlen?”

-Jeffrey Eggers, oficer që punoi nën administratat Bush dhe Obama

“Nuk kemi rreshtur së gënjeri amerikanët.”

-John F. Sopko, Inspektor i Përgjithshëm Special për Rindërtimin e Afganistanit.

LIDHJET QË NA ÇLIROJNË

Të rishpikësh njerëzimin...

E ndikuar nga shkatërrimet ekologjike dhe qorrsokaqet e «sistemit», një ndjeshmëri e re po shfaqet: refuzimi i dominimit njerëzor mbi natyrën. Duke kundërshtuar nganjëherë provat e supozuar të një egoizmi të mirëfilltë të species dhe duke i kremtuar përkundrazi kapacitetet e gjallesave për ndihmë të ndërsjellë, a mundet kjo nismë e rithemelimit antropologjik të bëhet një ndërmarrje politike për emancipim kolektiv?

NGA EVELYNE PIEILLER

Në shfaqjen e saj të fundit, G 5, Rocio Berenguer propozon «legjislacionin e parë botëror ndërmjet specieve» për ta siguruar të ardhmen e jetës. E bindur se «ekziston një arrogancë në modelin njerëzor i cili po shkatërrohet detyrueshëm», ajo synon kështu hapjen e «një fushe të re të mundësive». Në frymë të njëjtë programohet Skena Kombëtare e Besançon-së me shfaqje, filma dhe konferenca. Në program shtrohet pyetja: «Po sikur të ketë zgjatur tepër lufta midis atyre që janë të vetëdijshëm se i përkasin Tokës dhe atyre që imagjinojnë se planeti është pronë e tyre? Po sikur arti të mundësonte që këto lidhje të shkëputura të ribashkohen dhe të përvetësohet një e ardhme e përbashkët?» Shkrimtari i romaneve fantastiko-shkencore Alain Damasio këmbëngul gjithashtu: «Çështja no 1: lidhjet». Pastaj, thekson rëndësinë e “gërshetimit të jashtëm me shtazët, bimët dhe natyrën”.

Duke i pasur parasysh këto aspirata, këto pikëtytje mbi tjetërsinë, barazinë, shkëputjen midis njeriut me pjesën tjetër të botës, si dhe duke u bazuar në mënyrat për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve, kuptohet se gjindemi në antropocenën që po i shfaq këto çështje kaq fuqishëm.

Koncepti është i ri, rreth njëzet vjet, por esenca e tij është popullarizuar shumë: tregon se ka filluar një epokë e re gjeologjike - epoka jonë - ku njerëzit dhe aktivitetet e tyre janë bërë shtytësit kryesorë të ndryshimeve që ndikojnë në ekosistemet e planetit. Në një kohë kur shqetësimet

klimatike dhe mjedisore janë në rritje, kjo analizë zbulon një ndjeshmëri të re: njeriu nuk apostrofohet si dikur, “si zotërues dhe pronar i Natyrës”, por tani shpesh i referohemi për nga potenciali i tij shkatërrues. Kjo analizë ka ngjallur nevojën për ta ndryshuar mënyrën e të qenit në botë dhe për të jetuar në “mënyrë të mirëfilltë”.

Shumë lëvizje kombinojnë, në shkallë të ndryshme, refuzimin e sistemit antropocentrik me kërkimin e një morali aktiv. Sistemi antropocentrik shpesh konsiderohet veçori e Perëndimit dhe i konceptit të tij të modernizmit që identifikohet me kapitalizmin. Kurse morali aktiv e kundërshton dominimin e kodeve kaq të ngulitura nga pesha e ideologjisë shekullore sa që ato duken... krejt të natyrshme. Ekzistojnë qasje të shumta, të cilat nganjëherë kryqëzohen, nga zadistët deri tek mbështetësit e “care”, nga antispecistët që refuzojnë mbizotërimin e species njerëzore ndaj specieve tjera, deri tek ekofeministët që ndërlidhin shkatërrimin e natyrës me shtypjen ndaj grave, etj. Këto lëvizje theksojnë rëndësinë e lidhjeve brenda botës së gjallë dhe pyesin se në çfarë kushte mund të ketë një të ardhme të përbashkët. Duhet të rivendosen këto lidhje me një marrëdhënie krejtësisht ndryshe, që do të jetë çliruese, e drejtë, vëllazërore. Tani jo vetëm grupet e aktivistëve anojnë kah një bote ku mbizotëron dashamirësia - një term në trend -, hapja ndaj të tjerëve, solidariteti. Kjo ndodh padyshim në shoqëritë e shqetësuara, të ekspozuara ndaj pabarazive dhe të senzibilizuara ndaj sfidave mjedisore dhe sociale.

Në kundërshtim me darvinizmin social

Shumë intelektualë, antropologë, filozofë, shkencëtarë - nga feministja amerikane Donna Haraway, historiane e shkencës, e deri tek kolapsologu Pablo Servigne, inxhinier i bujqësisë, si dhe nga antropologu Philippe Descola e deri te sociologu Alain Caillé ose te filozofi Bruno Latour – tani japin një përcëptim të njeriut që e mbështet këtë kërkesë të hapur.

Në këtë ndërmarrje të rikrijimit ideologjik nuk mjafton ta fajësojmë *homo economicus-in*, por duhet ta rishqyrtojmë aftësinë e specieve për ta krijuar një konstelacion të ri vlerash. Një ontologji e re afirmohet duke u bazuar në konstatimin e “ndërvarësisë”. Sipas filozofit australian Glenn Albrecht, biologjia përcakton se jeta bazohet në “ndërlidhjet,

diversitetin, bashkëpunimin, homeostazisin dhe simbiozën”, si dhe jeta e njeriut është e mundur falë krejt botës së gjallë, nga bakteriet tek bimët. Me pak fjalë, “jeta është një ndërmarrje bashkëpunuese”. Kjo ndërvarësi, kjo “ndërlidhje” që po pranohet më në fund, na fton “t’i rregullojmë dhe të shpikim aleanca”, në “një lloj angazhimi ndaj krijesave dhe organizmave tjera (bimët, kafshët, mikrobet)” për “t’i forcuar në mënyrë të ndërsjellë mundësitë për të ardhmen e secilit”. Por a ka mundësi të ndryshon në mënyrë radikale njeriu “promethean” i mbyllur në egon e tij, krenar për singularitetin e tij, për epërsinë e tij në botën e gjallesave, i mësuar ta shoh botën si një arenë lufte, ku fiton ai që ka më shumë asete? Këtu promovohet aftësia për t’i ndihmuar njëri-tjetrit dhe



Lufta kundër padrejtësive shoqërore, kundër shfrytëzimit, kundër tjetërsimit, zhduket në kremtimin e ndërmarrëdhënieve. Dhe kjo thirrje për ngritjen e shpirtit dhe refuzimin e «aksiomatikut të interesit», me fjalë të Alain Caillé, mund t’i gëzoj ithtarët e të kaluarës që e kundërshtojnë përparimin, duke i trajtuar ata si utopistë sentimentalë

për të bashkëpunuar. Një koncept i vjetër dhe i kundërt me klisenë “njeriu për njeriun është ujë”. Kjo aftësi e nënvlerësuar, madje edhe e injoruar nga ideologjia kapitaliste, nuk është vetëm një karakteristikë e “tokësorëve të tjerë”, por edhe e species njeri.

Kjo doktrinë e kundërshton “darwinizmin social” me përkthimin e teorisë së seleksionimit natyror duke e rivlerësuar fuqinë bashkëpunuese të njeriut, një njeriut që e justifikon ligjin e më të fortit dhe që ka prirje për gara. Shpesh kjo doktrinë mbështetet në të dhëna shkencore: Pablo Servigne dhe Gauthier Chapelle në veçanti bazohen në zbulime të shkencave konjitive dhe të biologjisë, për të vërtetuar kështu se ekziston, nga rrënjësia biologjike “ndihma spontane e ndërsjellë në mes të njerëzve”. Alain Caillé bazohet në teorinë e antropologut Marcel Mauss për të parashtruar se të gjitha shoqëritë qeverisen jo nga tregu ose kontratat, por nga një detyrim i trefishtë: jep, merr, kthe. Propozohet një modelim i “natyrës njerëzore”, në të cilin ajo nuk definohet më si e mirë apo e keqe, por si një tërësi potencialesh në mes tjerash gjenetike, që aktivizohet nga rendi dhe ideologjitë shoqërore. Ky modelim e kundërshton fuqishëm “gjinin egoist” që pëlqehet nga disa biologë si Richard Dawkins.

Këto nuk janë ide plotësisht të reja. Qysh në shekullin e XIX, ndërvarësia dhe solidariteti ishin mjaft të përhapura, edhe këtu falë zhvillimit të shkencave natyrore (9). Claude-Henri de Rouvroy, konti i Saint-Simon (1760-1825), frymëzues i rrymës reformiste, e cila ka marrur emrin

e tij, kishte propozuar t’i aplikonte, duke përfshirë edhe solidaritetin, në një shoqëri si një “trup i organizuar”. Që të ushtrohen të drejtat, që të krijohet një raport i ekuivalencës dhe jo vetëm një raport i barazisë, Bourgeois përcaktoi parimet e mbrojtjes sociale nga shteti dhe kërkoi krijimin e organizimit të pensioneve të punëtorëve.

Por, Pierre Kropotkin (1842-1921), aktivist dhe teoricien anarkist, mendimtar i rëndësishëm i vetëqeverisjes, është pa dyshim më afër shqetësimeve dhe vlerave të sotme. Ai konsideron se, brenda secilës specie, “ndihma e ndërsjellë është rregulli i përgjithshëm” dhe “kjo ndihmë e ndërsjellë mbizotëron në natyrë”. Ai pohon se “ndjenja e mirësisë dhe ndjenja e identifikimit të pjesshëm të vetvetes me grupin” lind nga një “instinkt i simpatisë së ndërsjellë”. Pastaj zhvillohet në një ndjenjë të drejtësisë, barabarësisë, vetëmohimit. Duke u referuar në vëzhgimin e natyrës, ai thotë: “Nuk është garë! (...) Kështu na udhëzojnë shkurret, pylli, lumi, oqeani. Bashkohuni! Ndihmoheni njëri-tjetrit! Është mënyra më e sigurt për t’i garantuar secilit dhe për t’i siguruar të gjithëve siguri më të madhe, si dhe ekzistencë dhe përparim fizik, intelektual dhe moral më të mirë”. Kropotkin ishte shumë kritik ndaj qytetërimit modern dhe i vëmendshëm ndaj pasurisë të shoqërive fisnore: sipas tij mesjeta është shembull i arritjes kur mbretëronte vëllazërimi edhe falë shoqateve të tregtarëve borgjezë.

Aktualisht të gjitha këto tema ndërlidhen në mënyra të ndryshme me nevojën e përhapjes së këtij koncepti në të gjithë botën e gjallë. Por,

ndërlidhjet konsiderohen madhore, edhe më shumë se ndihma e ndërsjellë dhe bashkëpunimi. Ky është një projekt shpirtëror dhe moral i cili dëshiron t’i rikonfigurojë normat bazë të hierarkive, të cilat llogariten si përrjashtime të ushqyera nga arroganca. Atëherë duhet t’iu ikim kundërshtimeve të vjetra, unë-tjetri, racional-iracional, individi-grupi, shoqëri moderne-fis arkaik, etj., për t’i marrë parasysh lidhjet që zbatoheshin te të përcmuarit e Iluminizmit, sikurse për shembull kolektivi animist, ose Toka, trualli i saj, për të cilat sipas Bruno Latour duhen identifikuar “fuqitë e veprimit”.

Vështirë kuptohet sesi ky interes i ri për lidhjet midis gjithçkaje ndryshon rrënjësisht nga qasja poetike, vitaliste, që kishte të bëjë me lëvizjen hipike. Aty shpesh afirmohet fuqishëm refuzimi i botës neoliberale “të globalizuar”. Por, sikur që e rikujton ekonomisti Karl Polanyi, në ‘Transformimin e Madh’, ky pozicion nuk është i veçantë: “fashizmi, sikurse socializmi, ishte i rrënjësor në një shoqëri të tregut që refuzonte të funksiononte (16).”

Si të transformohen këto konstatime dhe zbulime në forcë kolektive politike? Çfarë propozime për një emancipim të lumtur? Duket se për ata që e duan shkëputjen me kapitalizmin, duhen zëvendësuar «aktivitetet produktive me ruajtjen e formave të jetesës të përcaktuara lirshëm në hapësira të çliuara», ku i është lënë hapësirë «unë»-it i cili kupton që është i «thurrur me penjë të shumtë që i kalojnë përmbi».

Natyrisht se njëherësh duhet në nivel lokal dhe në komunitete të vogla, që të bëhet një mënyrë tjetër e të jetuarit së bashku «në mënyrë hezituese», konvergencë kjo midis kapacitetit bashkëpunues dhe zhvillimit të singulariteteve.

Nuk është fjala këtu për një program politik, por për një program të ri imagjinar, spiritualist, kuazi-panteist, ndonjëherë edhe nën pretekst të shkencëzimit dhe thellësisht lirik. Por është akoma e vështirë të mos pyesim: si dhe për çka, respektimi i të gjitha formave të jetës dhe të ndërlidhjeve është konkretisht emancipues? «Po sikur ky ndryshim jonjerëzor, me optimizmin e tij magjik, të jetë vetëm simptoma e pafuqisë politike për ta shndërruar situatën e përcaktuar nga kapitalizmi?», pyesin dy eseistë që janë të ndjeshëm ndaj këtij ndryshimi.

Sigurisht. Lufta kundër padrejtësive shoqërore, kundër shfrytëzimit, kundër tjetërsimit, zhduket në kremtimin e ndërmarrëdhënieve. Dhe kjo thirrje për ngritjen e shpirtit dhe refuzimin e «aksiomatikut të interesit», me fjalë të Alain Caillé, mund t’i gëzoj ithtarët e të kaluarës që e kundërshtojnë përparimin, duke i trajtuar ata si utopistë sentimentalë, entuziastë të përkatësisë në komunitetin e të gjallëve, ku do të treteshin konfliktet e interesave. Me jehonë të fuqishme dhe e pasur për nga dëshira e shkëmbimit, kjo thirrje mundet gjithashtu të kontribuojë pjesërisht në ripërtëritjen e forcave progresive, nga një perspektivë kritike të pikëpamjeve materialiste.

KUNDËRTHËNIET E AKSIONIT HUMANITAR

Të kapësh botën pa e ndryshuar pushtetin



Thelbësor për mbijetesën e miliona njerëzve gjithandej botës, për refugjatët, të zhvendosurit, të uriturit, të sëmurët, etj.; aksioni humanitar menaxhon çdo vjet miliarda dollarë. Përballë shteteve, shoqatave dhe individëve, ai zotëron shpesh pushtet të vërtetë për t'i imponuar përzgjedhjet dhe normat e tij. Por, jo gjithëherë për llogari të viktimave.

NGA FRÉDÉRIC THOMAS*

Gjatë dekadës së kaluar, shumica e shpenzuar për ndihmë humanitare në të gjithë botën është pesëfishuar. Ajo kap tani vlerën prej 28.9 miliardë dollarë (26.3 miliardë €) në vit (1). Kjo rritje financiare shoqërohet me një zgjerim strukturash: prej shoqatave lokale të krijuara nga disa vullnetarë në organizata ndërkombëtare jo-qeveritare (INGO), duke kaluar nëpër agjencitë dhe programet e Kombeve të Bashkuara (KB) ose në Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Megjithatë, hendeuku midis fondeve të disponueshme dhe nevojave vazhdon të thellohet, veçanërisht për shkak të ringjalljes së krizave: konfliktet e armatosura, katastrofat për shkak të ndryshimeve klimatike ose urbanizimit të përsheptuar, prekin më shumë njerëz, por edhe më gjatë. Vlerësohet se ishin 206 milionë viktima të faktkeqësive më vitin 2018.

Por dallimi shkaktohet gjithashtu nga mos-funkcionimi specifik i ndihmës ndërkombëtare, që pengon arritjen e qëllimeve: mungon koordinimi, nuk ka njohuri të mjaftueshme për vendet ku ndërhyhet, anashkalohen akterët lokalë. Edhe pse këto anomalitë janë të njohura dhe të identifikuar për një kohë të gjatë (2), ato përsëriten në mënyrë sistematike, operacion pas operacioni. Arsyetimet janë të zakonshme: duhet të veprohet shpejtë, stafi duhet të ndërrohet vazhdimisht, mungon kujtesa institucionale. Maskohen shkaqet strukturore, ku ndër të parët është asimetria e marrëdhënieve midis akterëve.

Kështu, në vitin 2017, dy të tretat e fondeve humanitare botërore u ndanë për vetëm dymbëdhjetë INGO (në veçanti Save the Children, International Rescue Committee, Médecins sans frontières, Oxfam, World Vision) dhe për institucionet e Kombeve të Bashkuara (3), domethënë njëzet e dy herë më shumë se për operatorët shtetëror dhe vendor (4). Pra disa organizata ndërkombëtare tërheqin ndihmat e koncentruara në Veri, pasi që deri tani Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe disa shtete të Kontinentit të Vjetër janë donatorët kryesorë. Në vitet e fundit, megjithatë, Turqia, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe janë bërë kontribues të rëndësishëm, duke u bashkuar në listën e njëzet vendeve të para që kontribuojnë më së shumti. Kjo është pjesë e strategjisë së ripozicionimit të këtyre vendeve në skenën rajonale

dhe ndërkombëtare, në një kontekst të shënuar nga lufta në Siri dhe në Jemen.

MITI I VIKTIMËS SË PAFUQISHME

Ndihma humanitare ndërtohet nga "lartë", nga dhuruesit dhe donatorët, të cilëve duhet t'u ipet llogari dhe të cilët i vendosin në praktikë prioritetet dhe i caktojnë vendet ku intervenohet me ndihmat (5). Rrjedha e ndërhyrjes, ku mbi zotëron urgjenca, zotërimi i gjuhës angleze, konvergjenca e profileve shoqërore dhe të kodeve kulturore të stafit të saj "pa kufij", përforcon këtë dinamikë e cila lulëzon në kurriz të akterëve lokalë dhe përmes tyre edhe të viktimave.

Organizatat joqeveritare (OJQ) dhe Qeveria e Haitit pranuan drejtpërdrejt vetëm një pjesë të vogël të shumës prej 2.4 miliardë dollarësh të siguruar nga Kombet e Bashkuara pas tërmetit në vitin 2010: 0.4% përkatesisht 1%. Kështu, roli i tyre u kufizua në nënkontraktimin e thjeshtë të rindërtimit të udhëhequr nga distanca në nivel botëror. Ky është një rast ekstrem, por jo një rast i veçantë, meqë shtetet veriore financojnë së pari projektet e tyre përmes OJQ-ve të tyre. Nën-vlerësohen, madje edhe përçmohen, kapacitetet lokale që konsiderohen të pamjaftueshme për t'i plotësuar kërkesat e kontabilitetit dhe burokratike, të caktuara nga institucionet veriore (6). Vetëm 3% e ndihmës direkte i kushtohet këtyre organizatave.

Duke e kuptuar këtë asimetri, donatorët kryesorë dhe organizatat, në Samitin e parë Ndërkombëtar Humanitar në Stamboll më 23 dhe 24 maj 2016, u angazhuan se duke filluar nga viti 2020, do ta rezervojnë një të katërtën e fondeve për strukturat lokale dhe shtetërore, të cilat do t'i marrin subvencionet "në mënyrë sa më drejtpërdrejt të mundur" (parimi i "lokalizimit"). Ky vendim shpjegohet pjesërisht nga të dhënat e anketës së kryer paraprakisht, prej muajit maj 2014 deri në muajin shkurt 2015, në pesë vende të Lindjes së Afërt dhe Afrikës së Veriut, ku morën pjesë 1.231 persona "përfitues" të ndihmës ndërkombëtare (7). Atyre iu kërkuar të japin vlerësimin e tyre në një shkallë prej 1 deri në 10; përgjigjja mesatare ishte më pak se 3. Një vlerësim i konfirmuar në vitin 2018 nga një tjetër studim i rreth 5.000 personave në shtatë vende: më shumë se 80% e të të anketuarve në Irak dhe Liban nuk mendonin se mbështetja që kishin marrë do t'ua

mundësonte të bëhen të pavarur dhe shumica e tyre mendonin se opinioni i tyre mirret pak parasysh, apo edhe fare (8).

Një verdikt i tillë rrëzon të pamenduarën e aksionit humanitar: figurën e viktimës. Kjo viktimë perceptohet në mënyrë të qartë si e pafuqishme dhe pasive. Edhe pse në njëzet e katër orët e para, para se të arrijnë organizatat e huaja (dhe media), ajo shpëton më së shumti jetëra përreth saj. Qysh në vitin 2004, Z. Markku Niskala, Sekretari i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, bëri thirrje për «largimin e mitit të viktimës së pafuqishme dhe të humanistit të pagabueshëm», duke kërkuar që "njerëzit e prekur nga fatkeqësitë, si dhe aftësitë e tyre, të vendosen në qendër të punës sonë (9)". Nëse miti qëndron pesëmbëdhjetë vjet më vonë, arsyeja është se ky mit është në zemrën e vetëpasqyrimin dominues të sektorit dhe ky mit gjithësesi i shërben atij.

Imazhet e kaosit, të viktimave apatike dhe të shteteve jugore të paafta, të korruptuara, apo totalitare (ose njëkohësisht të trijat), përforcojnë nevojën për të vepruar nga jashtë. Zhgënjimi politik dhe siguria e përkatësisë në kampin e së mirës konfirmojnë legjitimitetin dhe zëvendësojnë analizën. Edhe pse nuk janë pa fjalë, viktimat shpesh detyrohen të heshtin nga shtetet e tyre, nga pretendimet e sektorit humanitar për vetërregullim dhe nga shumëzimi i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Historia zyrtare e ndihmës humanitare mund të përmbledhet në një aksion të pastër që është keqpërdorur vazhdimisht, por që gjithnjë është rehabilituar në emër të pastërtisë së qëllimeve të saj dhe mbi të gjitha për ruajtjen e domosdoshme të pavarësisë së saj. Ky tregim fsheh marrëdhënie tjera të pushtetit që ngajjnë në operacionet humanitare.

Shembulli i parë i këtij lloji: vlerësimi i ndihmës emergjente në Ruanda gjatë gjenocidit të tutsive në vitin 1994. Stafi i huaj humanitar dhe gazetarët që sapo kishin arritur, duke e ngatërruar vizibilitetin dhe efikasitetin, ndërtuan bashkërisht një qasje "humanitare" të ngjarjeve, e cila mund të kuptohej menjëherë nga spektatorët në Veri. Duke vepruar kështu, ata e errësuan logjikën ushtarake, diplomatike dhe politike, që qëndronte pas lëvizjeve të refugjatëve, si dhe fshehën mungesën e analizave paraprake dhe të koordinimit të aktorëve ndërkombëtarë (10).

Intervenimi humanitar shërbeu si një mbulesë për verbërinë dhe mosveprimin perëndimor, kur problemi ishte i një lloji tjetër dhe kërkonte një zgjidhje politike. Në fund, shumica e viktimave nuk vdiqën nga mungesa e ndihmave, por sepse u masakruan.

I njëjti tregim vazhdon njëzet e pesë vjet më vonë. Ai riformulon situatat e padrejtësisë dhe pabarazisë, si rezultat i zgjedhjeve politike, shkaqeve natyrore, apo ndoshta i mallkimeve. Në janar 2006, një studim mbi përpunimin e informacionit nga rreth gjashtëdhjetë gazeta dhe revista javore në nëntë vende perëndimore konkludoi se nuk kishte asnjë lidhje midis shkallës së fatkeqësisë dhe mbulimit të saj mediatic. Mbulimi mediatic lidhet me konsideratat ekonomike dhe strategjike të shteteve të Veriut (11). Kështu, në vitin 2004 pasojat e cunamit në Oqeanin Indian për industrinë e turizmit zunë një vend të stërmadhuar në media. Përkundrazi, sa më shumë mediatizohet një katastrofë, aq më shumë i tërheq organizatat dhe aq më shumë këto organizata fillojnë garën për vizibilitet, garë e cila rrezikon çdo përpjekje për koordinim. Të shkosh në vendin e ngjarjes do të thotë të jesh i dukshëm (pra i besueshëm), të sigurosh fonde (pra qëndrueshmëri), të forcosh natyrën urgjente të veprimit tend (pra legjitimitetin tënd). Arsyeshmëria e aksionit pak ka peshë kundër asaj që është shndërruar në treg.

Me qasje të privilegjuar në grante, media dhe te akterët vendimmarrës, organizatat humanitare

ushtrojnë pushtet. Dhe ky pushtet peshon edhe më shumë nga fakti që nuk njihet (12). Sidoqoftë, lokalizimi i ndihmës i miratuar në samitin e Stambollit nuk mund të jetë efektiv, nëse është «i ndarë nga çështjet e padrejtësisë, pabarazisë, asimetrisë së pushtetit», shpjegon znj.Regina Salvador-Antequisa, drejtore e Ecosystems Work for Essential Benefits, Inc. (Ecoweb), një organizatë joqeveritare e Filipineve (13).

Paratë dhe koha e investuar në ndërtimin e infrastrukturës, në mbrojtjen civile, shërbimet publike dhe organizimin paraprak ndaj katastrofave, po tregohen më efektive se përgjigjet ndaj këtyre katastrofave, sado të shpejta të jenë. Në vitin 2015, OJQ-ja e Amerikës së Veriut Mercy Corps dërgoi një ekip të vogël për t'i vlerësuar nevojat pas ciklonit Pam i cili goditi ishullin Vanuatu. Ajo pati guximin të hiqte dorë nga intervenimi i saj kur kuptoi se qeveria dhe agjencitë ishin mjaft mirë të pajisura dhe të organizuara. Vendet evropiane nuk ishin kaq të vëmendshme, kur pas tërmetit të vitit 2015 në Nepal dërguan pesëmbëdhjetë ekipe në Kathmandu, pa asnjë koordinim dhe në kundërshtim me realitetet rajonale: Kina, India dhe Pakistani, vendet më të afërta gjeografikisht kishin arritur atje. Rezultati: logjistika dhe koordinimi ishin të stërngarkuara dhe aeroporti ishte i ngulftatur, gjë që vonoi ardhjen e aeroplaneve të Francës, Belgjikës, dhe të Zelandës së Re për disa ditë, duke e bërë veprimin e tyre të kotë.

Këto sjellje fyese shpjegojnë ndoshta vendimin e qeverisë indoneziane, pas tërmetit në nëntor 2018, për të kanalizuar dhe kufizuar përfshirjen e akterëve të huaj. Vetorganizimi i "përfituesve" është edhe më stimulues. Në nëntor 2018, Mo-hib Ullah, organizator i një greve të shoqatave lokale në kampet e refugjatëve rohingya në Bangladesh, tha: "Nëse dëshirojmë t'i zgjidhim problemet tona, duhet ta bëjmë vetë. Organizatat ndërkombëtare janë thjesht ndihmëse (14)".

Si mund t'u bëjmë thirrje akterëve vendimmarrës politik, kur në të njëjtën kohë po kontribuojmë në depolitizimin e marrëdhënieve shoqërore dhe po promovojmë efikasitetin që shfaq pafuqinë publike? Paralelisht, humanitarja ka prirje të bëhet emri i fshehur i politikës: politika institucionale nuk shfaqet më me emrin e saj dhe po merr kahjen e saj, shumë më tërheqëse dhe legjitime, për ta kompensuar mosveprimin e saj - Palestina është një rast emblematic - ose, përkundrazi, për ta katalizuar veprimin e saj. Mund të flasim për privatizimin me mjete humanitare, siç e thoshte gjeografi David Harvey. Në vendet përkatëse, a nuk jemi dëshmitarë të një "OJQ-izimi" të shërbimeve sociale? Pra, ekziston tendenca që ndihma ndërkombëtare të zëvendësojë sistemet e shëndetit public, të cilat mbeten mënyra më efektive për të shpëtuar jetë. E kundërta e politikës nuk është humanitarja: është një politikë tjetër.

(1) Të gjitha të dhënat janë marrë në "The global humanitarian assistance report 2019", Development Initiative, 30 shtator 2019, <http://devinit.org>
(2) "Raporti për bilancin e aksioneve të muaj pas Mitch", grupi Urgence Réhabilitation Développement (URD), Plaisians (France), 9 janar 2000; Rebecca Barber, «One size doesn't fit all. Tailoring the international response to the national need following Vanuatu's cyclone Pam», Save the Children - Care - Oxfam - World Vision, Victoria (Australie), qershor 2015.
(3) Komisarati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (HCR), Programi botëror i ushqimit (PAM), Fondet e Kombeve të Bashkuara për fëmijët (Unicef).
(4) Shih Ben Parker, «Six aid policy priorities to watch in 2019», The New Humanitarian, 3 janar 2019, www.thenewhumanitarian.org
(5) Lexo Léon Koungou, «Désoccidentaliser l'aide», supplément «Quelle solidarité internationale?», Le Monde diplomatique, maj 2013.
(6) Lexo «Haïti, l'imposture humanitaire», Le Monde diplomatique, nëntor 2016.
(7) "Preparatory stakeholder analysis. World Humanitarian Summit regional consultation for the Middle East and North Africa", World Humanitarian Summit, New York, 2015.
(8) "Grand Bargain: field perspectives 2018", Ground Truth Solutions, Vjenë, maj 2019, www.earthshakesolutions.org
(9) "World disasters report 2004", Federata Ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmë Hënës së Kuqe (IFRC), Gjenevë, 2004.
(10) "The joint evaluation of emergency assistance to Rwanda, Study III. Principal findings and recommendations", Relief and Rehabilitation Network - Overseas Development Institute, Londër, Qershor 1996.
(11) "Western media coverage of humanitarian disasters", Carma International, Londres, janar 2006.
(12) Shih Michael Barnett, Empire of Humanity: A History of Humanitarianism, Cornell University Press, New York, 2011.
(13) "Roundtable: Going local", The New Humanitarian, 9 april 2019. (14) Kaamil Ahmed, «In Bangladesh, a Rohingya strike highlights growing refugee activism», The New Humanitarian, 27 nëntor 2018.

* Politolog, studiues në Centre tricontinental (Cetri) dhe ligjërues në Fakultetin e shkencave sociale të Universitetit të Liège (Belgjikë).

NJË URREJTJE E PASTËR, 40 VITE PAS VDEKJES SË FILOZOFIT

Mohimi i Sartrit

Më 19 Prill 1980, varrimi i Jean-Paul Sartre mobilizoi turmën, si ai i Victor Hugo më pak se një shekull më parë. Me shuarjen e Sartrit dukej se po mbylllej një epokë e angazhimit dhe e refuzimit të korseteve të mirësjelljes. Ekzibicionizmi mediatik ose mbyllja akademike karakterizuan pastaj dy pole të botës intelektuale. Që të dytë po aq larg nga modeli sartrian.

NGA ANNE MATHIEU*



Ekziston një paradoks i Sartrit. Ai që simbolizon «intelektualin e plotë, të pranishëm në të gjitha frontet e mendimit, si filozof, kritik, romancier, njeri i teatrit» lufton për ta gjetur një vend pas vdekjes të denjë për emrin në vendin e tij. Paradoksi është theksuar nga rrezatimi ende aktiv i mendimit dhe shkrimeve të tij jashtë vendit. Fakti është që Franca tani po ndriçohet nga fenerët e konformizmit konsensual, për të cilin (pseudo)debatet televizive apo të radiove nuk arrijnë të japin as iluzionin e një fryme destabilizuese. Mediokriteti dhe mirësjellja janë larguar nga ai që, pas Luftës së Dytë Botërore, nuk pushoi së luftuari, për të hyrë në betejë dhe për të marrë rrezeqe.

Një lloj *intelejensie* nuk ia njeh Sartrit statusin e përfaqësuesit të intelektualit të angazhuar «à la française». Vepra e vetme që vlera i njihet nga të gjithë: *Les Mots* (Fjalët) e botuar më 1961.

Komentimet nuk mbarojnë mbi «veprën e madhe të shkrimtarit» dhe kjo nuk është rastësi: kjo autobiografi që tregon fëmijërinë dhe rininë e tij, nuk shqetëson njeri. Mendimi unik i së djathtës dhe të majtës ka ditur ta identifikoj veprën që i lejon të heq dorë nga urrejtja e njëanshme e intelektualit dhe njëkohësisht ta ruajë atë në «dyqanin e aksesorëve» të datuar e të vjetëruar.

Të tejkaluar dhe të grisur deri në thelb të gabimit. Sepse, na u thanë mjaft, Sartre paska qenë gjithmonë gabim. Përpos nëse kjo akuzë nuk kthehet kundër vetë akuzuesve.

Le t'i përvetësojmë këto fjalë tërheqëse të Guy Hocquenghem disa vjet pas vdekjes së autorit të *Chemins de la liberté* (Rrugët e lirisë): «Shpirtërat e juaj të babëzitur dhe të varfër, puritanë dhe teoristë, kanë dashur ta vrasin Sartrin një qind herë. Por sa më shumë e mohoni, aq më shumë e ringjallni. Sa më shumë e hedhni poshtë, aq më shumë ju ndrydh, ju merr me vete në vdekjen. Sartri i vërtetë ikën nga varri i respektit renegat dhe të tradhtisë, ku deshët ta mbyllni».

Që nga vdekja e tij në 1980, pak gjëra janë kursyer kundër atij me të cilin do të kishin druajtur të përballimi përderisa ishte gjallë. Sartre na paska qenë një filozof që shkruan keq letërsi... Bankat e studentëve kanë shijuar për një kohë të gjatë këso shaka kalamajsh – madje edhe radhët e universitarëve - duke i dhënë madje edhe legjitimitet shkencor. Sartri mbetet pak i studiuar saktësisht në letërsi. Le të rilexojmë romanin e tij të parë *La Nausée* (Neveria) – 1938, përmbledhjen e tregimeve *Le Mur* (Muri) - 1939, si dhe trilogjinë e tij padrejtësisht të anashkaluar dhe të

nënvlerësuar *Les Chemins de la Liberté* (Rrugët e Lirisë) - 1945-1949.

Është vepër e pasur. E larmishme stilistikisht dhe narrativisht. Vepër që «flet» për të gjithë, duke e përshkuar përgjithmonë aftësimin intelektual dhe personal: shenjë e veprave të mëdha.

Teatri i tij? Divers, gjithashtu edhe shpikës dhe...aktual. Përveç *Huis clos* (Me dyer të mbyllura) -1944, *Les Mains sales* (Duar të ndyra) - 1948, shfaqjet e tij më të njohura dhe më të aktruara sot: fuqia e denoncimit me *Nekrassov* (Nekrasov) -1955 dhe *Séquestrés d'Altona* (Të dënuarit e Altonës) -1959, mbeten të paprekura: e para me mistifikimin e informacionit dhe rekrutimit, si dhe e dyta, me qëllimin dhe mjetet në periudhat e dhunshme të historisë.

Më në fund, natyrisht, ekzistojnë tekstet e tij politike. Aty ku dhemb: Sartri shqetëson akoma sepse ai ishte «në situatë». Ai e deklaroi këtë në *Les Temps modernes* më 1945: «Shkrimtari është në një situatë në kohën e tij: çdo fjalë ka jehonat e saj. Si çdo heshtje po ashtu. Unë i mbaj përgjegjës Flaubert dhe Goncourt për shtypjen që pasoi me (lëvizjen kryengritëse të) La Commune, sepse ata nuk e shkruajtën një rresht për ta parandaluar atë. U tha se nuk ishte çështje e tyre. Por a ishte gjykimi i Calas një çështje e Voltair-it? A ishte dënimi i Dreyfus-it çështje për Zola? A ishte administrimi i Kongos çështje e Gide? Secili nga këta autorë, në një rrethanë të veçantë të jetës së tyre, përballeshin me përgjegjësinë e tyre si shkrimtar».

Lufta do të jetë shkasi i angazhimit të Sartrit. I mobilizuar në shtator 1939 dhe i burgosur në qershor 1940, ai u transferua në një kamp në Trier. Atje, ai njezh shoqërinë, vëllazërinë. Sartre e bëri skenarin dhe regjinë e një shfaqje për krishtlindje, *Bariona* ose *Fils du tonnerre* (Biri i gjëmimit). I liruar në mars 1941 duke u paraqitur si civil, Sartre u kthye në Paris. Edhe më i vendosur për të vepruar. Ai e themeloi me Maurice Merleau-Ponty grupin jetëshkurtër «Socialisme et liberté» (Socializëm dhe liri), me dëshirën për ta organizuar një lëvizje të rezistencës, duke shkruar për ta parë André Gide dhe André Malraux në zonën e lirë.

Shfaqja e tij *Les Mouches* (Mizat) mbart një frymë rezistence në Parisin e pushtuar. Më 1943-1944, ai bashkëpunoi me *Les Lettres Françaises* (Letrat franceze), organi i Komitetit Kombëtar të Shkrimtarëve, të themeluar në ilegalitet nga Jacques Decour dhe Jean Paulhan.

Por kjo do të jetë e tëra...Sartre nuk ishte as Georges Politzer, as Claude Bourdet. Para Luftës së Dytë Botërore, ajo që bie në sy ishte

mungesa e ndonjë horizonti politik.

Pavarësisht ç'thoshte Simone de Beauvoir dhe pavarësisht tregimeve në «*Le Mur*» (Muri), Sartre mbeti larg zhvillimeve që ndodhin në Spanjë. Kjo distancë politike midis dy luftërave do ta shpie gjatë jetës së tij të rrugëtoj përkrah fantazmës së Nizanit, mikut të tij të fëmijërisë i cili vetë u angazhua plotësisht në fund të viteve 1920.

Kur e lexon letërkëmbimin e tij me Beauvoir, «Castor» (Kastor), mahnitëse është të vërehet një përmendje të parë politike, vetëm se në korrik 1938, dy muaj para Mynihut. Edhe pse ata nuk kuptojnë shumë nga Fronti Popullor.

ANTI-KOLONIALIZMI

Sartre i bashkohet komitetit drejtues të 'Rassemblement démocratique révolutionnaire' (Bashkimit Demokratik Revolucionar) – RDR, në shkurt 1948, projekti i së cilit ishte hartuar paraprakisht nga gazetarë dhe intelektualë të së majtës dhe së majtë ekstreme, duke përfshirë David Rousset.

RDR do të shuhet me largimin e Sartrit (tetor 1949). Ky ishte angazhimi i vetëm i Sartre në një parti politike. Nga mesi i vitit 1952 deri në fund të vitit 1956, ai bashkudhëtoi me Partinë Komuniste Franceze (PCF), i motivuar kryesisht nga shtypja poliore dhe gjyqësore kundër saj, edhe pse kjo parti e kishte sulmuar atë mjaft ashpër deri atëherë.

Madje kryetari i Unionit të Shkrimtarëve Sovjetikë e quajti atë në vitin 1948 një «hijënë daktilografë». Sartre do të shkëputet përgjatë shtypjes së kryengritjes hungareze në nëntor 1956 nga ana e Moskës.

Si në secilin rast, frymëzimi i tij gazetaresk plotësohej nga temat dhe leksiku i shokëve që ai zgjodhi. Të tilla si tekstet e tij të botuara në France-U.R.S.S. më 1955, të cilët nuk është për t'ia pasur zili frazeologjia e komunistëve ortodoksë.

Sidoqoftë, artikujt sartrianë të kësaj periudhe japin një reflektim gjithmonë aktual mbi mistifikimin e liderëve dhe shtypit: «*Të gjithë lexuesit tanë e dinë që ne e konsiderojmë politikën e qeverisë si të dëmshme dhe përbuzëse ndaj njerëzve burrave që e frymëzojnë atë: por detyra jonë është ta shpërfaqim atë pa pushim. Vetëm duke shpërfaqur, ne mund të shpresojmë të shërbejmë. Ne do të vazhdojmë: nëse është e ndaluar ta quajmë Bidault një kriminel, ne do të themi se ai është një fajtor i madh; nëse na është mohuar e drejta të flasim për gjakun në duart e tij, ne do të flasim për leskërat që ka në sytë e tij. Është thjesht çështje terminologjie.*»

Muajt e fundit të bashkërrugëtimit me PCF mbivendosen me angazhimin e Sartre kundër luftës në Algjeri. Kjo ishte beteja e tij e madhe. Dhe kjo është çështja që disa njerëz nuk ia falin ende: anti-kolonializmin e tij të bindur, pamëshirshmërinë e diskutit të tij duke i vendosur francezët para përgjegjësive së tyre historike, intelektuale dhe morale: «*Dëlirësi e rreme, shmangie, dredhi, vetmi, nemi, bashkëfajësi e mohuar dhe, të gjithë së bashku, e pranuar. Kjo është ajo që ne e quajmë, më 1945, përgjegjësi kolektive. Populli gjerman në atë kohë nuk duhej të pretendonte se kishte injoruar kampet. «Aiii! thoshim ne. Ata dinin gjithçka!» Kishim të drejtë, ata dinin gjithçka dhe vetëm sot mund ta kuptojmë: sepse edhe ne dimë gjithçka. (...) A guxojmë t'i dënojmë ende? A guxojmë të shfajësohemi ende?*»

Disa, shpesh të njëjtët, nuk e mirëpresin miqësinë e Sartre me psikiatrin dhe eseistin martinikez, Frantz Fanon, atëherë pothuajse i izoluar. Sartre e shkroi parathënien e veprës së Fanon: *Les Damnés de la terre* (Të mallkuarit e botës) më 1961, një ese kyç për botën e tretë.

Një parathënie ku ai poshtëron gënjeshtrën e një kombi mendjemadh që është vetëm hijja e vetvetes: «*Ç'dërdëllisje: liri, barazi, vëllazëri, dashuri, nderë, atdhe, e çka tjetër? Kjo nuk na pengoi të zhvillonim njëkohësisht fjalime raciste, zezakë të ndyrë, çifut të ndyrë, miush të ndyrë.*»

Radikalizmi dhe përmbysjë e Sartrit matet nga masa e urrejtjes që ai frymëzon tek pronarët e dyqaneve letrare dhe gazetareske. Nuk shfrenohen aq ndaj Céline, që shpëton nga kritika me pretekstin e stilit të tij.

Se përpos që paska qenë antisemit, Sarte paska bërë gabimin e pafalshëm të solidarizohet me ata që revoltoshin kundër shtypësit francez.

Shpifjet ecin mirë. Një prej këtyre shpatarëve të oborrit nuk kursehet nga marrëzia duke e akuzuar Sartrin për «tentim vrasje të Camus».

E tërë kjo natyrisht nën sfondin e luftës së Algjerisë, ku trumbetohet për «filozofin [Camus] që nuk gaboi kurrë».

Në emër të kompleksitetit të situatës së tij personale, justifikohet pozicioni i gabuar i autorit të *L'étranger* (I huaji) në lidhje me sfidat e momentit historik. Përbuzet lufta e tij e guximshme dhe e rrezikshme: shtëpia e Sartre u bë shënjestër e një atentati nga e djathta e ekstreme.

Dhe mediat do ta shfrytëzojnë mundësinë për t'u tallur me Sartre në Billancourt, për kohën e bashkërrugëtimit të tij me maoistët e së majtës proletare më vitin 1970.

Disa muaj më parë, në të përditshmen *Le Figaro*, Jacques

Julliard, anëtar i Akademisë Franceze, mishërues shembullor i intelektualit zyrtar, institucional dhe konsensual, jep verdiktin e tij për Sartre: «*Romancier i dobët, dramaturg i pashfaqëm, filozof fjalëshumë por pa origjinalitet, një libertarian që lavdëroi të gjitha diktaturat, një shpirt i madh që justifikoi të gjitha masakrat, me kusht që promovojnë socializmin (...). Ai ishte një mashtrues me mirëbesim që kujdesej për ashpërsinë e tij, nganjëherë tërbimin e tij për regjimet liberale dhe që bëri shfaqjen e ndërgjegjes së keqe të shkrimtarit alibinë e rehatisë së tij intelektuale. Kjo është fusha e vetme ku prodhoi dishepuj deri më sot.*»

Për ta bërë «mbrojtjen politike të Sartrit», më e mira është të merret parasysh vepra e tij në situatë, duke i matur gabimet, teprinë, dobësitë e tij, si dhe madhështinë, kompetencën dhe aktualitetin. Aktualitetin ? Nëse ky model i intelektualit të angazhuar është i demoduar sot, nuk ka asnjë arsye për të qenë i lumtur për këtë.

Në vitin 1983, tre vjet pas vdekjes së Sartrit, Pierre Bourdieu shpjegoi se: «*kushitet konjunkturale, por edhe ato strukturore, të cilat (...) bënë të mundur [intelektualin par excellence], sot janë specie në zhdukje e sipër: presionet e burokracisë së Shtetit dhe shohjet e shtypit dhe tregut të mirave kulturore, të cilat kombinohen për ta zvogëluar autonominë e fushës intelektuale dhe institucionet e veta të riprodhimit dhe të shugurimit kërcënojnë atë që ishte më e rallë dhe më e çmuar në modelin sartrian të intelektualit dhe më me të vërtetë antitetik ndaj disponimeve «borgjeze»: mohimi i pushteteve dhe privilegjeve mondane (ndoshta edhe të çmimit Nobel) dhe pohimi i pushtetit dhe të privilegjit të mirëfillt intelektual për t'i thënë jo të gjitha pushteteve të përkohshëm.*»

Mohimi i Sartrit të cilin po e përrjetojmë është e kundërta logjike e medaljes.

Si ndërgjegje e keqe e intelektualëve të oborrit dhe ekranit, mohimi i tillë është ai që na kujton se një intelektual bëhet vërtetë i denjë me mendimin, punimet, veprat, vendosmërinë e tij dhe jo me paraqitjet e tij në media dhe me miqtë e tij të fuqishëm.

Për praktikuesit e mendimit të gatshëm që përsërisin se kanë ndryshuar kohërat, që betejat dhe kërkesat janë të pranueshme vetëm brenda kufijve të ngushtë, ne mund t'i kundërshtojmë me faktin se asnjë ndryshim për të mirën e përbashkët nuk ka filluar duke pëshpëritur: «po», por duke ngritur zërin:»jo».

Në fillimin e luftës, gjithmonë ka mohim. Këtë e dinë intelektualët dhe gazetarët që e kundërshtojnë Sartrin, ndryshe nga ato që supozojnë diskutet e tyre. Shtrembërimi dhe ngulfimi me turp të fjalës sartriane është të kufizosh lirinë tonë për ta kundërshtuar kapjen e autoriteteve dhe pushteteve. Është të bësh të besosh se të gjitha fjalët vlejnë njësoj dhe ndihmojnë në degradimin e tyre, edhe pse përgjegjësia e intelektualit është ndonjëherë t'i përdorë ato, sipas fjalëve të vetë Sartrit, si një «pushkë e mbushur».

1 Lexo « Jean-Paul Sartre et la guerre d'Algérie », Le Monde diplomatique, nëntor 2004.

2 Pierre Bourdieu, « Sartre, l'invention de l'intellectuel total », art. cit.

EPIDEMITË E SË KALUARËS

Gripi i Honk Kongut në Shqipërinë e mbyllur hoxhiste

Ishte gjysëm shekulli më parë. Në dimrin e viteve 1968-69, Shqipëria komuniste përjetoi epideminë më të madhe në historinë e saj. I importuar nga teknicienët kinezë të dërguar nga Mao, gripi i Hong Kongut mori jetën e më shumë se 300 njerëzve për dy muaj.

NGA KATERINA SULA

Pandemia e Covid-19 zgjon kujtime të dhimbshme në Shqipëri. Në vitin 1968, në mes të revolucionit kulturor, gripi i Hong Kongut e pati goditur fuqishëm diktaturën komuniste të Enver Hoxhës, pothuajse të shpëputur nga pjesa tjetër e botës. «Epidemia H3N2 mori jetën e 300 personave në Tiranë për dy muaj», kujton profesori Mentor Petrela, drejtues i shërbimit të neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës (QSUT). «Familjarët nuk u mbajtën të informuar për vdekjen e të dashurve të tyre dhe varrimet fillonin

në orën 10 të mëngjesit, gjë që nuk ishte zakon.»

Afërsisht një milion njerëz vdiqën nga gripi i Hong Kongut jashtë Kinës përgjatë dimrit të vitit 1968-1969. Vlerësohet se epidemia kishte marrë deri në dy milion jetë në Perandorinë e Mesme.

Kishte një atmosferë ngulfatëse në Tiranë. Përsëritej nevoja për vigjilencë të vazhdueshme dhe populli ishte mësuar të jetonte nën presion. Regjimi i Enver Hoxhës

kishte imponuar mekanizma efikas të vetëkontrollit të bazuar në frikë. Por shtresat e varfëra dhe militantët komunistë besonin në singjeritetin e liderëve dhe në aftësinë e tyre për ta menaxhuar krizat. Familjet me një anëtar të sëmurë izoloheshin shpejtë dhe vëzhgoheshin nga policia.

SHUARJA E SKANDALIT

«Kam një kujtim të pashlyeshëm fëmijërie nga gripi i Hong Kongut, pandemia e fundit e shekullit XX», rrëfen gazetari Eduard Zaloshnja. «Në rrugën Fortuzi në Tiranë, jo larg shkollës sime fillore, oficerët policor ishin të stacionuar 24 orë në ditë, përpara derës së një familje që dyshohej se e kishte një anëtar të infektuar. Të trembur, njerëzit kalonin rrugën për të ecur në trotuarin tjetër, ndërsa në fëmijët vëzhgonim nga larg, me frikën se mos virusi vdekjeprurës ‘do të kalonte’ muret e shtëpisë dhe do të hynte në mushkëritë tona të brishta...»



Dyshohet se sëmundja u importua në Shqipëri nga mijëra teknicienë kinezë të dërguar nga Pekini në vitet 1960 dhe 1970 për ta ndihmuar zhvillimin e vendit. Një nga simbolet e këtij bashkëpunimi ishte Kombinati metalurgjik në Elbasan. Duke e refuzuar destalinizimin, regjimi i Enver Hoxhës ishte përafër në atë kohë me Kinën popullore, duke mos hezituar t'i kritikonte «revizionistët sovjetikë».

Atëbotë, 70% e tregtisë shqiptare bëhej me Kinën dhe Partia e Punës e Shqipërisë ishte e vetmja parti në pushtet në botë që mbështeste Revolucionin Kulturor. Partia Komuniste Kineze krenohej me këtë «miqësi të pathyeshme militante» me Tiranën. Në këtë kontekst, regjimi komunist shqiptar kishte bërë gjithçka për ta shuar skandalin shëndetësor të shkaktuar nga epidemia.(COURRIER DES BALKANS)

Lufta e Parë Botërore : Malaria në Frontin e Selanikut

Në Frontin e Orientit, ushtritë e Paktit të Trefishtë ishin mposhtur nga trupat e Perandorive Qendrore, por ishin përballur gjithashtu me një kundërshtar të tmerrshëm: malaria. Një mision anti-malarial ishte formuar shpejt, për ta frenuar përhapjen e sëmundjes te ushtarët dhe te popullata lokale. Duke hedhur kështu themelet e luftës moderne. Histori.

NGA LAURENT ROUY

Kur gjenerali Sarraill zbarkoi me trupat e tij në Selanik, ai nuk e dinte se do të përballej me një tjetër armik, edhe më të frikshëm se ushtarët e Perandorive Qendrore: mushkonjat, të cilat bartnin ethe të kënetës, ose malaria. Kjo sëmundje infektive tani është zhdukur në Evropë, por vazhdon të bëjë kërdi në zonat tropikale të Afrikës, Amerikës së Jugut dhe Azisë, duke shkaktuar çdo vjet vdekjen e afërsisht gjysëm-milioni njerëz nëpër botë. Simptomat kryesore janë: të dridhura të forta, kokëdhimbje dhe ethe deri në mbi 40°C.

Kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, Greqia ishte vendi evropian më i prekur nga malaria. Në veriu e vendit, kënetat në grykëderdhjet e lumenjve Galiko dhe Vardar, në periferi të Selanikut, por edhe lugina e Strumës, në veri-lindje, ishin ligatina ku malaria ishte endemike.

Në fillim të konfliktit, Athina ishte neutrale. Vendi ishte i përçarë nga ndjenja të kundërta: popullata ndihej më e afërt me Serbinë, aleate e dikurshme në luftërat balkanike, dhe kundërshtonte bullgarët. Kryeministri Eleftherios Venizelos favorizonte Paktin e Trefishtë (Francë, Mbretëri e Bashkuar, Rusi; por mbreti Kostandini, dhëndri i perandorit gjerman William II ishte gjermanofil. Zbarkimin e trupave franceze e kup-toi si sulm ndaj neutralitetit. Në anën tjetër, ushtria greke përpiquej me të gjitha mjetet t'ua veshitësojë punën

Aleatëve. Kështu kur Aleatët kërkuar një vend për ta vendosur kampin e tyre tranzit, ata ua caktuan në Zeitenlik, që ishte pjesërisht kënetore dhe mbushur me mushkonja.

“Të ngacmuar nga mushkonjat, ushtarët e mjerë të rinj të ushtrisë së Orientit, ecnin, luftonin nën diellin e zjarrtë” 30.000 refugjatë të luftërave ballkanike tashmë mbijetonin në atë vend. Disa prej tyre ishin të sëmurë kronikë nga malaria. I vetëdijshëm për rrezikun që i kanosej, Departamenti Shëndetësor i Ushtrisë konsultohet me njërin nga ish-mjekët e tij, doktorin Alphonse Laveran, i cili në vitin 1880 kishte identifikuar parazitin që shkaktonte malarian. Doktorin pranon se “ka frikë se [ushtria franceze] të jetë prekur nga kjo sëmundje e tmerrshme.” Një fushatë e parandalimit organizohet, me shpërndarjen e të vetmës barnë anti-malariale në atë kohë, kininën, si dhe me rrjeta kundër mushkonjave. Ushtarët francezë ‘Les Poilus’ (*Leshataket*) nuk e marrin seriozisht rrezikun: ata bëjnë shaka me shijën veçanërisht të hithur të kininës, gjejnë arsye të ndryshme për të mos e marrë atë, kurse rrjetët kundër mushkonjave i çajnë në mes për të kaluar më lehtë përmes tyre.

Gjatë verës, numri i rasteve të infektuar me malaria shpërthen në ushtrinë e Orientit. Gjysma e 120.000 ushtarëve të pranishëm në kampin e Selanikut janë bartës të parazitit. Vetëm në vitin 1916, 30.000 ushtarë duhet të

shtrihen në spital. 20.000 evakohen në Francë dhe 630 vdesin nga sëmundja. Por lufta vazhdon dhe vetëm 20.000 ushtarë francez janë në vijën e frontit. “Ka pasur mesatarisht 250 deri 300 evakuime çdo ditë, vetëm në Selanik, 13 deri 15 vdekje çdo ditë”, tregon oficeri ndërlidhës Jean-José Frappa në memoarët e tij. “Të ngacmuar nga mushkonjat, ushtarët e mjerë të rinj të ushtrisë së Orientit ecnin, luftonin nën diellin e zjarrtë. Kishin ethe, të vjella biliare dhe papritmas, anemikë, me fytyrë të prerë, sy të verdhë, rrëzoheshin duke u dridhur nga të ftohti, dhe pastaj u mbuloheshin nga djersa depresive.”

“USHTRIA IME ËSHTË E IMOBILIZUAR NËPËR SPITALE...”

Në këto kushte, bullgarët i shtyejnë francezët dhe aleatët e tyre gjatë verës së vitit 1916. Por ata ngriten përsëri: serbët pushtojnë majën e Kajmakalanit, francezët qytetin e Manastirit. “Gjenerali Sarraill ka drejtuar operacionet e tij me batalione ushtarësh të sëmurë nga malaria, të cilët mund të ecnin dhe të luftonin vetëm në intervalet kohore kur nuk kishin kriza (...) këto operacione e kanë sjellur ushtrinë e tij fitimtare deri përtej Manastirit, diku në fund të muajit nëntor në vitin 1916”, shkruante Gjenerali Régnauld, komandanti i Ushtrisë franceze të Orientit.

“Ushtria ime është e imobilizuar nëpër spitale”, shkruan gjenerali Sarraill në një telegram dërguar Ministrisë së Luftës. Në Paris, ndihmës-sekretari i Shtetit kërkon një zgjidhje. I cakton dy shkencëtarë për një mision, vëllezërit Edmond dhe Etienne Sergeant, të cilët zbarkojnë në Selanik më 19 dhjetor.

Të lindur në Algjer, vëllezërit Sergeant kanë shumë njohuri mbi malarian. Në vitin 1900, ata kishin filluar kërkimet e tyre kundër kësaj sëmundje në kënetat e Afrikës veriore. Në vitin 1904, Etienne emërohet udhëheqës i luftës kundër

malariae në Algjeri, dhe në vitin 1912, vëllau i tij Edmond inauguroi Institutin Pasteur në Algjer, ku emërohet drejtor. Në Selanik, ata gjejnë injorancë në mesin e trupave, por gjithashtu te oficerët dhe te mjekët ushtarakë. Edmond Sergeant i paralajmëron: “Nëse nuk dalim prej rutinës për të organizuar fushata moderne anti-malaria, plumbat e armikut do të shkaktojnë më pak vdekje në Selanik se malaria”.

Të dy vëllezërit lëvizin në tërë frontin. Brenda një muaji, ata hedhin themelet e “Planit të luftës kundër malariae” i cili përmban gjashtë pika. Fillimisht, hartojnë zonat e rrezikut, ku nuk do të qëndrojnë ushtarët, dhe për të caktuar vende të sigurtë për kampet. Duhet gjithashtu t'i detyrojnë ushtarët ta marrin kininën. Për këtë qëllim, e karakterizojnë refuzimin për të marrë barnën si “refuzim të bindjes para armikut” i cili teorikisht mund të denohet me vdekje. Misioni anti-malarial do të kryejë kontrolla të urinës të paparlajmëruara dhe ushtarët shpejt do ta quajnë stafin e këtij misioni “Maskaranjët e Urinuarës së Madhe”.

Në rast të shkeljes së urdhërave, sanksionoheshin ushtari, por edhe mjeku dhe shefat e tij. Bëhet një luftë kundër mushkonjave, me shpërndarjen e rrjetave kundër mushkonjave, tharjen ose vajtjen e pellgjeve të vogla dhe të prockave, dhe vendosjen e rrjeteve kundër-mushkonjeve në dritarët e godinave ushtarake. Paralelisht kryhet një “propagandë moderne”, në formën e “bisedeve me trupat” dhe me shpërndarje të trakteve. Ushtarët shkruajnë letra në anën e pasme të traktave ... atëherë vendoset t'u shpërndahen kartolina. Dhe, në fund, krijohet protokoli i kujdesit ndaj të sëmurëve dhe organizohet “ç'parazitimi i popullatës civile”.

Nga shkurti i vitit 1917 deri në shtator 1918, 20 mjekë dhe 368 infirmierë të misionit do të shpërndajnë mbi 32 tonë kininë, do të vizitojnë 469 fshatra, në 161 prej të cilëve do të “kinizohet” popullata. 7600 rrafsh ujorë

do të mbushën, sanohen ose vajohen. Shumë shpejt do të vërehen rezultatet: në mes të muajit shtator 1916 dhe shtator 1917, shkalla e incidencës së malariae ishte përgjysmuar (nga 148.4 në 78.1%). Midis vitit 1917 dhe vitit 1918, përsëri përgjysmohet (39.2 % në shtator 1918). Numri i rasteve të rënda pjesëtohet për dhjetë.

“KUR ATA ECIN, KËMBËT DHE KRAHËT I KANË TË ZHVESHUR. KËNAQEN MUSHKONJAT”

Edhe aleatët e Francës luftuan kundër malariae, por me më pak sukses. Për shembull, britanikët e ushtrisë *British Salonica Army* bënë gabime të mëdha në fillimin e fushatës, kur i shpërndanë ushtarëve pantallone të shkurtëra, përmbi gjunj. “Kur ata ecin, këmbët dhe krahët i kanë të zhveshur. Kënaqen mushkonjat. Brigadat zvogëlohen në numër, bëhen batalione”, thotë oficeri ndërlidhës Frappa. Në fushën maqedone të Manastirit, edhe italianët kanë shumë të infektuar. Në fillim të fushatës, shkalla e incidencës së malarjes ishte e njëjtë tek francezët dhe britanikët, kurse në shtator 1918, ky raport ishte pesë herë më i ultë në radhët e francezëve, falë punës së misionit anti-malarial.

Në frontin e Selanikut, malaria ka prekur 82 000 francezë, 162.000 britanikë, 49.700 italianë dhe 50.600 serbë. Së paku 6000 francezë, serbë dhe rusë kanë vdekur prej kësaj sëmundje. Te britanikët, më shumë se gjysma e vdekjeve (57%), dmth 5.500 burra, janë shkaktuar nga sëmundjet. Malaria në radhë të parë. Epidemia tingëllon si një mësim i hidhur për Aleatët në Selanik, por përvoja e fituar nga ushtria franceze do të ketë hedhur themelet e luftës kundër malariae, siç praktikohet ende sot. (COURRIER DES BALKANS)

NË SHENJË HOMAZHI PËR VDEKJEN E ARTISTËVE RIKARD LJARJA DHE GËZIM KRUJA

Humbja e korifejve dhe shoqëria e konsumit në kohë pandemie

“U përmbysën kanune e vlera morale. U morën jetë, e pasuri të gjithfarëllojshme ranë në duar të paskrupullta grykësish”, ka shkruajtur dikur Rikard Ljarja teksa i bën një homazh kolegut të tij Ndrek Luca. Dhe, i druhej vetes. Gabimit. Nga mosbërja dhe nga koha e mbrapa, që tani do e ketë pafund.

NGA BEN ANDONI

Rikard Ljarja, aktori dhe regjisor i filmave klasikë shqiptarë, ka ndërruar jetë pak ditë më parë. Kortezi i tij përbëhej nga makina e shërbimit funeral dhe dy makina shoqëruese. E diktuar nga kushtet, por më shumë dhe nga amaneti i të ndjerit, trupi u vendos të prehet në Shkodër, qytetin e lindjes. Kjo ishte zgjidhja më e mirë e mundshme në masat e marra për të frenuar Covid-19, që tashmë qëndrojnë të ngulura në të gjithë hapësirën e vendit për të bllokuar përhapjen e një pandemie, për të cilën askush nuk di më si të sillte.

Pak ditë para tij, Gëzim Kruja, një nga legjendat e humorit shkodran, mbylli jetën tokësore. Trupi i tij u përcoll në masa më liberale drejt banesës së fundit. Për ta sfiduar Covid-19 dhe për t'i nxjerrë inatin kësaj gjendje, dhjetëra qytetarë shkodranë vendosën ta përcjellin live kortezhin e të ndjerit. Të tjerë personalitete më pak të njohura kanë mbyllur jetën në këto ditë të rënda përcjellë nga një kortezh gati simbolik. Sfida më e madhe në këto ditë pa njerëz dhe plot cinizëm ka qenë gjetja e mbartësve, njerëzve të punësuar enkas për të mbartur trupat...

Kjo është e dukshmja. Se çfarë ndodh pastaj të gjithë e dimë. Një luzmë e tërë dashamirësh të të ndjerit, që u vishen grupe patetikësh derdhin kujtime, ese të ndjera ku indirekt revokohen vetë ata me aureolën e të ndjerit dhe thirrje ndaj vdekjes. Edhe Rikard Ljarja nuk i ka shpëtuar këtij rituali, që e tallte paq kur ishte i gjallë.


Prej vitesh Rikardi ishte krejtësisht i tërhequr. Shoqëria e konsumit material e kishte velur me makutërinë dhe epshin publik të të vetëndjerit. I ndjeri që e kishte ndërjet këtë prej dekadash nuk është se i kishte prishur shumë punë, përveç se një elementi të thjeshtë: I duhej të përshtatej me jetën e re në kohë të reja. Dhe, Rikardi



Gëzim Kruja

pikturonte, shkruante dhe planifikonte. Nuk mundi të ekranizonte një nga librat e tij, ngritur mbi një metaforë shumë universale, që e mbante prej kohësh. Nuk mundi të sillte disa shkrime të tjera, që i flinin në mendje dhe donte shumë t'i shpaloste. Dikur thoshte se ‘arratisej’ në Shkodër. “Shkoj në Shkodër, tek shtëpia ime, dhe mbjell qepë, hudhëra, tulipanë, trëndafila etj. Në kopshtin tim punoj nga katër-pesë orë, pasi më merr malli të shkel në tokë zbatuar”. “Pse nuk e rrëfen Shkodrën me një audicion të hapur, si Benigni që tregon Firencen?”. Të shikonte, por përgjigjet e Rikardit gjysmë me shaka, por brenda me një seriozitet të thartë të kundërshtonin këndshëm. “Ai asht i ri dhe i fortë. Nuk dua të turpnohem tash. Nuk kam ma mosh me i ndreq gjanat”. Po çfarë duhej vallë të ndreqte? A mund një njeri të shndërroj një sistem ekonomiko-shoqëror? “Jo, por mundet me e ba sistemin me kuptu vetiu se shkon keq? Duke ditur me e sulmu! A është e mundur në shoqërinë që jetojmë? Po fare do pak njerëz i ndryshojnë gjanat! Të tjerët janë thjesht rekuizitë”. Po pse nuk kujtohen vallë për korifejtë?! E cili i vendos se cilët janë korifejtë, e mbushte me zërin e vet. Pse nuk zë vend fjala e të diturve?

Varfëria, tërmeti dhe pandemia e fundit tregoi se ata për të cilët kishim neglizhuar, ata ishin njerëzit që duhet të dëgjonim më së shumti. Jo se Rikardi mund të thoshte ndonjë gjë më shumë në këto kohë. Për ditë, ai e thoshte sipas mënyrës së tij, me pak njerëzit e tij, por duke u falur tek metafora e shkrimit. Në qendër është njeriu i thjeshtë, i cili i mbijeton sistemit. Për të ndryshuar, ai rrekej t'i tregonte në ato pak krijime të vetat se edhe fabulat më të vërteta nuk shkojnë me realitetin dhe si mund të jetohej. Gati njëzetë vjet më parë, një ditë të vitit 2002, nuk i dhanë më rrogën në TVSH, ku punonte si Drejtor Artistik. U largua pa u ankuar, sepse të gjithë jetën kish respektuar Autoritetin. Tre vjet më vonë, të 1000 kopjet e romanit të parë të tij: “Në një Humbëritë këtë rrotull”, u zhdukën menjëherë. Më në fund, një copëz e panjohur nga artisti, ishte zbërthyer për publikun e gjerë.



Rikard Ljarja

“Koha kishte vënë në vend gjithçka. E keqja, nëqoftëse kishte enë ndonjëherë në këto anë, ishte mënjanuar e harruar. E mira kishte zënë vend kudo”. (pjesë nga Në një humbëritë...)

Artistë sot cilësohen shumë persona dhe këtë ndjesi e merr, kur shikon malin me emërtesa dhe njerëzit që na shfaqen ngado. Në qoftë se do i drejtoshesh të vërtetëve “ata janë shumë pak, duke përfshirë këtu edhe një pjesë të atyre që e kanë mbushur gjoksin me tituj. Këta artistë të vërtetë, në qoftë se e bëjnë punën e tyre ashtu siç dinë ata, të jeni të bindur se janë shumë më të angazhuar se shumë prej atyre që lehin (më falni për fjalën e rëndë) në TV, apo në forume, apo ndoshta edhe në parlament”, rrëfente dhe e mbyste trishtimi i heshtur.

Duhet me e kuptu se po nuk dite të përdorësh dhe të dish sesi të blishesh atëherë prano dhembët e përbindshave që të qëndrojnë dhe janë gati të të gëlltisnin me çdo gjë, fliste mes miqsh. E megjithatë, kudo u mundua të gjejë një mundësi për të treguar se vendi i tij mund të ndryshonte. “Rrethanat e përbotshme na kanë zhytur, na kanë bërë t'i hamë kokën njëri –tjetrit, shpeshherë. Kurse sot, për fat, jetojmë të lirë, në një shoqëri që po përpiaqet të kapë kohën e humbur, që nuk është e pakët. Në një shoqëri që po përpiaqet të mbyllë plagët e shumëvjeçarëve, që po kërkon të emancipohet. Jemi pak, por po fryn një erë e mirë. Po na ndihmojnë. Nga ana tjetër, të tjerë prapë përpiaqen të na futin stërkëmbësia. E ndjej fort që po bashkohemi, në të gjithë kuptimet, po bëhemi më me dinjitet, si individë dhe si komb. Sepse, siç duket, nuk paskemi qenë pak”, do të përgjigjet në një intervistë për MAPO dikur..

Rikardi ruante një qasje të sikletshme me rrugën, teksa çapitej me hapin e madh, aspak skenik. Shpesh e fshihte vështrimin e tij që e kërkojnë shumë njerëz. “Më respektojnë por shumë edhe më lodhin”, të thoshte singlerisht. Kuptohet, kur i gjeje momentin e tij. Dhe, bash në atë moment në një thjeshtësi, jo të zakonshme, do të përziente një referim, që fillonte

nga Besëlidhja e Vjetër ngërthehej natyrshëm me eposin shqiptar, me para-popullatën ilire...të gjitha brenda një shpjegimi, shoqëruar me gjestikulationin potent, që ndiqte vokali i tij bas.

Që kur ishte fëmijë ëndërronte të bënte gjëra, gjithnjë lidhur me artin. Në një shtëpi intelektualësh, prindërit i japin mundësi në muzikë. Luan në piano. Veçse, përfundoi në fagot në orkestrën simfonike të Prenk Jakovës. Në ato mote, Shkodra, gëlonte nga kultura. Në kujtimet e shpalosura tregohet natyrshëm kujtimi familjar për Dom Mjedën, Mati Logorecin e shumë të tjerë...Por një ditë ai do t'i kalonte personazhet e tij idilikë, pasi drejtimi i Rikardit nuk është te fjala e shkruar, por bash tek e folura. Në shkollën e aktorëve fiton lehtësisht. “Dritan Shkaba”, roli i parë i tij, përcillet me interes. Mes 15 konkurreseve, arrin të kapë rolin kryesor. Që atëherë ylli i tij vetëm shkëlqen në periudhën e parë të kinematografisë shqiptare të pas luftës. Bëhet një nga personazhet më të dashura për shqiptarët në rolin e intelektualit. Inxhinier, mësues...Role dogmatike, që ai u jep në thelb dyshimin. Sa mundet?! Zbërthen rolin falë intelektit të tij dhe një pune që zgjat deri më 10 orë...Bën një galeri të tërë personazhesh në kinematografi. 30 role të realizuar në film u shtohen 30 roleve të tjera, që ka realizuar më parë në teatrin “Migjeni”. Zbret në Tiranë. Është aktor dhe regjisor në Kinostudio. E gjithë jeta artistike përshkon tashmë vetëm një vektor, Shtëpi-Kinostudio. Por, është një Rikard tjetër. Në një film ku luan aktorin kryesor dhe është regjisor, pas fasadës së lumturisë socialiste në mes të malit, (ku një grua lind me vështirësi pa fund në mes të maleve), ai bën me dije se deri ku arrin çmenduria e sistemit. Kurse Petrit Malajt, në rolin e doktorit kur udhëton i kërkon thjesht në një dialog, kur ta pyesin të thotë se: Ai nuk po vjen me qejf në fshat. Vjen sepse është detyrë dhe kaq”.

Rikardi nuk luajti me kartën e disidencës, jo vetëm se nuk ishte i tillë, por edhe se nuk i është dashur. Ai ishte dhe mbeti artist. Edhe me amanetin e Shkodrës i gjeti vetes një shteg nderimi të përgjeshëm.

Dhe, sot?! “U përmbysën kanune e vlera morale. U morën jetë, e pasuri të gjithfarëllojshme ranë në duar të paskrupullta grykësish”, ka shkruajtur dikur, teksa i bën një homazh kolegut të tij Ndrek Luca. Dhe, i druhej vetes. Gabimit. Nga mosbërja dhe nga koha e mbrapa, që tani do e ketë pafund. Mbase tani do të shkruajë sërish, duke mos shkruar. Këto ishte pak rreshta në kohë pandemie për artistët, që nuk i morën dot duartrokitjen e fundit masive, por që do të kujtohen gjatë në kujtesa shqiptarësh.

LE MONDE diplomatique

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti “Musine Kokalari” - Prishtinë (Kosovë)
Drejtor: Belgzim Kamberi
Kryeredaktor: Ardit Rada
Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti
Përkthimi: Lemanë Muriqi
Layout design: Dritan Lleshi
Tirazhi: 1000
Email: botadiplomatike@gmail.com

Botimi i “Le Monde Diplomatique” në gjuhën shqipe mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë- SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde,
Association Gunter Holzmann,
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI,
président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales:
Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale:
Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints:
Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS,
Evelyne PIEILLER, Hélène RICHARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique:
Maria IERARDI, Boris SÉMÉNIAKO
(avec la collaboration
de Delphine LACROIX pour l'iconographie)
Rédacteur documentaliste: Olivier PRONET
Mise en pages et photographie:
Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial,
chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaita SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621),
Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication
et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs:
François HONTI, Claude JULIEN, Ignazio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUEDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET

Relations marchands de journaux (numéro vert):
0805-050-147

Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles,
sauf accord avec l'administration

© ADAGP, Paris, 2019,
pour les œuvres de ses adhérents

Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée:
France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

PËRMBAJTJA PRILL 2020	FAQE 2-3 Kur qytetet e mëdha vendosin të ndahen, NGA BENOIT BRÉVILLE	FAQE 8-9 Mos u trembni, kapitalizmi kaq i dashur do të fitojë, NGA ANDI KANANAJ / Që tanil, NGA SERGE HALIMI	FAQE 14-15 Masat shtrënguese, këto korrëse të mëdha, NGA MICHAEL MARMOT / Në Buchenwald, antifashistët humbën luftën e kujtesës, NGA SONIA COMBE	FAQE 20-21 Të kapësh botën pa e ndryshuar pushtetin, NGA FRÉDÉRIC THOMAS / Mohimi i Sartrit, NGA ANNE MATHIEU
	FAQE 4-5 Deri në fundin e radhës së botës..., NGA RENAUD LAMBERT DHE PIERRE RIMBERT	FAQE 10-11 Koha për rihapje, NGA ALBAN YLLI	FAQE 16-17 Gjeopolitika e akullthyesve, NGA SANDRINE BACCARO DHE PHILIPPE DESCAMPS	FAQE 22 Gripi i Honk Kongut në Shqipërinë e mbyllur hoxhiste, NGA KATERINA SULA / Lufta e Parë Botërore : Malaria në Frontin e Selanikut, NGA LAURENT ROUY
	FAQE 6-7 Artan Mustafa: Njëjtë, por ndryshe, NGA SHKODRAN HOTI	FAQE 12-13 Marrëdhëniet e çuditshme gjermano-izraelite, NGA DANIEL MARWECKI / Nami, NGA SEB BYTYÇI	FAQE 18-19 Tatëpjeta amerikane në Afganistan, NGA GEORGES LEFEUVRE / Të rishpikësh njerëzimin..., NGA EVELYNE PIEILLER	FAQE 23 Humbja e korifejve dhe shoqëria e konsumit në kohë pandemie, NGA BEN ANDONI